

# RAPORTI I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË PZSEK 2022-2025

---

Strategjia e energjisë së Republikës së Kosovës 2022-2031

---



# RAPORTI I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË PZSEK 2022-2025

---

Strategjia e energjisë së Republikës së Kosovës 2022-2031

---



## **PËRMBAJTJA**

Lista e shkurtesave	7
Lista e definimeve shtesë	8
Lista e tabelave	9
Lista e grafikëve	10
<b>KREU I</b>	11
1. Hyrje	12
2. Metodologjia e raportit	14
2.1 Qasja analitike	14
2.2 Burimet e informacionit dhe analiza plotësuese	16
3. Pasqyrë e përgjithshme dhe të gjeturat kryesore	17
<b>KREU II</b>	21
<b>Objektivi Strategjik I: Përmirësimi i besueshmërisë së sistemit</b>	22
1. Objektivi Strategjik I: Përmirësimi i besueshmërisë së sistemit	23
1.1. Komentim mbi përmbushjen e objektivave specifike	25
1.2. Përmbushja e veprimeve të objektivave specifike	27
1.2.1 Rritja e fleksibilitetit të sistemit	27
1.2.2 Modernizimi i rrjeteve dhe reduktimi i humbjeve në rrjet	30
1.2.3 Rehabilitimi i kapaciteteve ekzistuese të prodhimit të energjisë elektrike	35
1.2.4 Garantimi i sigurisë kibernetike të sektorit të energjisë	38
1.3 Sfidat dhe rekomandimet e përgjithshme	40
<b>Objektivi Strategjik II: Dekarbonizimi dhe promovimi i energjisë së ripërtëritshme</b>	42
2. Objektivi Strategjik II: Dekarbonizimi dhe promovimi i energjisë së ripërtëritshme	43
2.1. Komentim mbi përmbushjen e objektivave specifike	46
2.2. Përmbushja e veprimeve të objektivave specifike	48
2.2.1 Zbatimi gradual i çmimit të karbonit	48
2.2.2. Promovimi i energjisë së ripërtëritshme në konsumin e energjisë elektrike	50
2.2.3 Promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të energjisë së ripërtëritshme për ngrohje	58
2.3 Sfidat dhe rekomandimet e përgjithshme	60
<b>Objektivi Strategjik III: Rritja e efijencës së energjisë</b>	62
3. Objektivi Strategjik III: Rritja e Efijencës së Energjisë	63
3.1. Komentim mbi përmbushjen e objektivave specifike	65
3.2. Përmbushja e veprimeve të objektivave specifike	67
3.2.1 Përmirësimi i efijencës së energjisë në ndërtesa	67

3.2.2. Promovimi i kogjenerimit efikas dhe sistemeve eficiente të ngrohjes qëndrore	78
3.3. Sfidat dhe rekomandimet e përgjithshme	81
<b>Objektivi Strategjik IV: Forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe funksionimi i tregut</b>	<b>84</b>
4. Objektivi Strategjik IV: Forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe funksionimi i tregut	85
4.1. Komentim mbi përmbushjen e objektivave specifike	87
4.2. Përmbushja e veprimeve të objektivave specifike	89
4.2.1 Forcimi i bashkëpunimit rajonal	89
4.2.2 Heqja e barrierave për funksionimin efektiv të tregut	91
4.2.3 Aftësimi në fushat e lidhura me energjinë dhe përfshirja e grave	95
4.3. Sfidat dhe rekomandimet e përgjithshme	97
<b>Objektivi Strategjik V: Mbrojtja dhe fuqizimi i konsumatorëve</b>	<b>98</b>
5. Objektivi Strategjik V: Mbrojtja dhe fuqizimi i konsumatorëve	99
5.1. Komentim mbi përmbushjen e objektivave specifike	101
5.2. Përmbushja e veprimeve të objektivave specifike	103
5.2.1 Mbrojtja e konsumatorëve në nevojë	103
5.2.2. Fuqizimi i konsumatorëve	107
5.2.3. Ruajtja e shëndetit të njeriut dhe mjedisit	109
5.3. Sfidat dhe rekomandimet e përgjithshme	110
<b>KREU III</b>	<b>112</b>
1. Përfundime dhe rekomandime	113
2. Referencat	116

## LISTA E SHKURTESAVE

QRK – Qeveria e Republikës së Kosovës  
ME – Ministria e Ekonomisë  
MMPHI – Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës  
MINT – Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe tregtisë  
FKEE – Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë  
FMN – Fondi Monetar Ndërkombëtar  
ZRRë – Zyra e Rregullatorit të Energjisë  
KEK – Korporata Energjetike e Kosovës  
KOSTT – Kosovo Operation System Transmission and Trade  
KEDS – Kosovo Energy Distribution System  
KESCO – Kosovo Energy Supply Company  
PZSEK – Plani i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës  
BE – Bashkimi Evropian  
SS – Substation  
TS – Trafo Stacion  
NS – Nënstacion  
MW – Mega Vat  
kV – kiloVolt  
ktoe – kilo ton oil equivalent (ekuivalent i kilo tonit të naftës)  
SAIDI - Indeksi mesatar i kohëzgjatjes së ndërprerjes së sistemit (shprehur në orë për konsumatorë)  
SAIFI - Indeksi mesatar i frekuencës së ndërprerjeve të sistemit (numri mesatar i ndërprerjeve)  
BRE - Burimet e Ripërtërishme të Energjisë  
BESS - Battery Energy Storage System (Sistemi i ruajtjes së energjisë me bateri)  
eCert - Computer Emergency Response Team (Ekipi i Energjisë për Reagim ndaj Emergjencave Kompjuterike)  
GIS - Geographic Information System (Sistem për informacione gjeografike)  
SCADA - Supervisory Control and Data Acquisition (Sistem për monitorimin dhe kontrollin e rrjetit)  
MFSH - Marrëveshje për Furnizim me Shumicë  
VNM - Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor  
IPF9 - Instrument për përgatitjen e projekteve, faza 9 (brenda programit të WBIF)

## LISTA E DEFINIMEVE SHITESË

Prosumator - Konsumator i cili konsumon energji, por edhe prodhon energji për përdorim personal ose për shkëmbim me rrjetin (prodhues + konsumator).

Dekarbonizim - Procesi i reduktimit të emetimeve të karbonit (CO<sub>2</sub>) në atmosferë.

Energjia e ripërtëritshme - Energjia që prodhohet nga burime që ripërtëriten natyrshëm (energjia e diellit, e erës, hidroenergjia, etj.).

Rehabilitim i njësive - Riparimi ose përmirësimi i termocentraleve apo njësive ekzistuese të prodhimit për të rritur jetëgjatësinë dhe rendimentin e prodhimit.

Akt nënligjor - Dokument që përcakton rregullat praktike për zbatimin e një ligji.

Emetime të gazrave serrë - Lirimi i gazrave që kontribuojnë në ngrohjen globale (CO<sub>2</sub>, metan, etj.)

Analizë/Studim i fizibilitetit - Studim që vlerëson realizueshmërinë e një projekti nga aspekti teknik, financiar dhe mjedisor.

## LISTA E TABELAVE<sup>1</sup>

Tabela 1. Niveli i përmbushjes së objektivave strategjike të PZSEK 2022-2025.

Tabela 2. Objektiv i kufinjëve të vlerave SAIDI dhe SAIFI.

Tabela 3. Përqindja totale e realizuar për objektivin strategjik për vitet 2022-2024.

Tabela 4. Niveli i përmbushjes së objektivave specifike deri në vitin 2024.

Tabela 5. Caqet për reduktimin e emetimit të GS në sektorin e energjisë dhe pjeësmarrjes së burimeve të ripërtëritshme në konsumin e sektorit të energjisë elektrike.

Tabela 6. Përqindja totale e realizuar për objektivin strategjik për vitet 2022-2024

Tabela7. Niveli i përmbushjes së objektivave specifike deri në vitin 2024.

Tabela 8. Caqet e strategjisë së energjisë për efiçencën e energjisë dhe rritjen e performancës energjetike në ndërtesa.

Tabela 9. Përqindja totale e realizuar për objektivin strategjik për vitet 2022-2024.

Tabela 10. Niveli i përmbushjes së objektivave specifike deri në vitin 2024.

Tabela 11. Indikatorët dhe caqet për forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe funksionimit të tregut.

Tabela 12. Përqindja totale e realizuar për objektivin strategjik për vitet 2022-2024.

Tabela 13. Niveli i përmbushjes së objektivave specifike deri në vitin 2024.

Tabela 14. Indikatorët dhe caqet për mbrojtjen dhe fuqizimin e konsumatorëve.

Tabela 15. Përqindja totale e realizuar për objektivin strategjik për vitet 2022-2024.

Tabela 16. Niveli i përmbushjes së objektivave specifike deri në vitin 2024.

Tabela 17. Niveli i veprimeve të përfunduara deri në vitin 2024.

---

<sup>1</sup> Tabelat në këtë listë nuk përfshijnë tabelat e veprimeve për objektivat specifike, pasi që ato janë të emërtuara në bazë të numrit të veprimit specifik sipas PZSEK.

## **LISTA E GRAFIKËVE**

Grafiku 1. Realizimi i objektivave specifike dhe krahasimi me realizimin sipas raportit të ME.

Grafiku 2. Realizimi i objektivave specifike për përmirësimin e besueshmërisë së rrjetit.

Grafiku 3. Realizimi i objektivave specifike për dekarbonizimin dhe promovimin e energjisë së ripërtëritshme.

Grafiku 4. Realizimi i objektivave specifike për rritjen e efikasitetit të energjisë.

Grafiku 5. Realizimi i objektivave specifike për forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe funksionimit të tregut.

Grafiku 6. Realizimi i objektivave specifike për mbrojtjen dhe fuqizimin e konsumatorëve.

---

## KREU I

Kreu I përfshin:

- Hyrjen;
- Nivelin e përmbushjes së objektivave specifike për secilin objektiv strategjik të PZSEK;
- Metodologjinë e raportit.

## 1. Hyrje

Ky raport është hartuar nga Balkan Green Foundation në rolin e saj si organizatë e shoqërisë civile me mandat për monitorim të pavarur të politikave publike në sektorin e energjisë. Analiza e paraqitur nuk synon zëvendësimin e raportimit institucional, por plotësimin e tij përmes një vlerësimi kritik, të bazuar në të dhëna dhe në analizë cilësore të progresit dhe ndikimit të zbatimit të Strategjisë së Energjisë.

Raporti monitorues ka për synim të ofrojë një pasqyrë, e cila reflekton arritjen e objektivave strategjike dhe specifike gjatë viteve 2022, 2023 dhe 2024 (me fokus në këtë të fundit). Përveç veprimeve të përfshira në PZSEK, raporti referon në mënyrë të kufizuar edhe veprime të institucioneve shtetërore që nuk janë formalisht pjesë e Planit të Zbatimit, vetëm në ato raste kur ato kanë ndikim të drejtpërdrejtë në arritjen e objektivave strategjike të Strategjisë së Energjisë.

Përtej funksionit teknik, ky raport paraqet një përpjekje për të rritur transparencën dhe llogaridhënien institucionale në sektorin e energjisë në Kosovë. Gjithashtu shërben edhe si një mjet qytetar, me qëllim fuqizimin e rolit të shoqërisë civile në zhvillimin e politikave të energjisë, si dhe nxit ndërgjegjësimin publik për sektorin e energjisë.

Në këtë mënyrë, raporti synon ndërveprimin e vazhdueshëm midis institucioneve shtetërore, qytetarëve dhe aktorëve të tjerë për një zhvillim të mirëfilltë të sektorit të energjisë.

Sektori i energjisë mbetet një nga shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit, me ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë e furnizimit, përballueshmërinë e çmimeve dhe reduktimin e ndikimit mjedisor. Strategjia e Energjisë 2022–2031 është hartuar në përputhje me zhvillimet rajonale dhe evropiane dhe është e sinkronizuar me draft-Planin Kombëtar për Energji dhe Klimë (PKEK), i cili pritet të shërbejë si dokument udhëheqës për politikat energjetike dhe klimatike në vitet e ardhshme. Ky kuadër e pozicionon tranzicionin energjetik të Kosovës brenda një procesi më të gjerë dekarbonizimi dhe integrimi rajonal, duke kërkuar balancim ndërmjet besueshmërisë së sistemit, përballueshmërisë dhe objektivave klimatike.

Për të përmbushur caqet për vitin 2031, janë vendosur pesë objektiva strategjike që udhëheqin reformat e dekadës së ardhshme:

1. Përmirësimi i besueshmërisë së sistemit;
2. Dekarbonizimi dhe promovimi i energjisë së ripërtëritshme;
3. Rritja e efikasitetit të energjisë;

Forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe funksionimi i tregut;  
Mbrojtja dhe fuqizimi i konsumatorëve.

Për arritjen e këtyre objektivave, Ministria e Ekonomisë drafton Planin e Zbatimit të Strategjisë së Energjisë për miratim, i cili në mënyrë më të detajuar tregon indikatorët dhe veprimet përmes të cilave synohet të arrihen targetet e objektivave strategjike. Programi i parë i zbatimit të Strategjisë së Energjisë për periudhën 2022-2025 është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me datë 5 shtator 2023, në bazë të të cilit rrjedh raporti ynë monitories nga këndi i shoqërisë civile.

## 2. Metodologjia e raportit

Ky raport paraqet një pasqyrë gjithëpërfshirëse mbi progresin dhe sfidat e zbatimit të Planit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës (PZSEK) për periudhën 2022–2024. Vlerësimi është realizuar në nivelin e objektivave strategjike dhe specifike, duke u mbështetur në analizën e përqindjes së realizimit të veprimeve, të dhënave sasiore dhe komenteve të institucioneve përkatëse, si dhe në identifikimin e sfidave të hasura gjatë procesit.

Që në fillim është e rëndësishme të theksohet se edhe raportet vjetore të Ministrisë së Ekonomisë për zbatimin e PZSEK e matin progresin kryesisht përmes përqindjes së veprimeve të realizuara, duke i trajtuar të gjitha veprimet me peshë të barabartë. Kjo qasje administrative është e dobishme për evidentimin e dinamikës institucionale, por nuk pasqyron domosdoshmërisht ndikimin real të këtyre veprimeve në arritjen e objektivave strategjike të Strategjisë së Energjisë. Në shumë raste, veprimet përgatitore ose dokumentuese kontribuojnë në një përqindje relativisht të lartë progresi, ndërsa veprimet kapitale dhe strukturore, të cilat janë vendimtare për transformimin e sektorit – mbeten të pazbatuara ose me progres minimal. Për këtë arsye, ky raport përdor metodologjinë zyrtare për qëllime krahasimi, por e shoqëron atë me analizë kritike dhe interpretim të peshës reale të veprimeve, me qëllim që të ofrojë një vlerësim më të saktë dhe më të balancuar të progresit drejt objektivave strategjike.

Ky raport nuk vë në dyshim vlefshmërinë e metodologjisë zyrtare të raportimit, por synon të evidentojë kufizimet e saj në kontekstin e vlerësimit të ndikimit real të politikave publike. Qasja e përdorur nga Ministria e Ekonomisë ofron një pasqyrë të rëndësishme të progresit procedural dhe të përmbushjes formale të veprimeve, ndërsa analiza e këtij raporti e plotëson atë duke shqyrtuar nëse ky progres procedural përkthehet në ndryshime substanciale në sektorin e energjisë.

### 2.1 Qasja analitike

Secili objektivi strategjik është analizuar individualisht, përmes ndarjes në objektiva specifike dhe veprime konkrete që janë paraparë për realizimin e tyre. Matja e përmbushjes është bërë në dy nivele:

- për objektivat specifike: mesatarja e përqindjeve të realizimit të veprimeve përkatëse;
- për objektivat strategjike: mesatarja e përqindjeve të objektivave specifike.

Në këtë fazë të raportimit, të gjitha veprimet janë peshuar në mënyrë të barabartë, pavarësisht madhësisë, kompleksitetit apo ndikimit të tyre real në arritjen e objektivave strategjike. Kjo qasje është e njëjtë me metodologjinë e përdorur edhe në raportet zyrtare të Ministrisë së Ekonomisë për PZSEK, duke mundësuar krahasim të drejtpërdrejtë me progresin institucion al.

Megjithatë, trajtimi i barabartë i të gjitha veprimeve krijon kufizime të rëndësishme metodologjike. Veprimet përgatitore ose administrative (si hartimi i dokumenteve ose përgatitja e analizave) kontribuojnë në përqindjen totale të progresit në të njëjtën mënyrë si veprimet kapitale apo strukturore, të cilat janë vendimtare për arritjen e objektivave strategjike. Kjo mund të çojë në paraqitjen e një niveli progresi relativisht të lartë, edhe në ato raste kur rezultatet substanciale në sektor, si rritja e kapaciteteve të reja, përmirësimi i besueshmërisë së sistemit apo avancimi i efijencës energjetike nuk kanë qenë të dukshme.

Kjo metodë e matjes mbështetet në supozimin se realizimi i veprimeve të listuara kontribuon drejtpërdrejt në arritjen e objektivave përkatës, mirëpo nga analiza e periudhës 2022-2024 nuk rezulton gjithmonë kështu. Në disa objektiva, ndonëse progresi i raportuar në nivel veprimesh është i konsiderueshëm, veprimet me peshën më të madhe strategjike nuk janë përmbushur ose janë në faza të hershme të zbatimit, duke kufizuar ndikimin real në sektor.

Në këtë raport, për të ruajtur krahasueshmërinë institucionale, përdoret e njëjta metodë e llogaritjes, por analiza plotësohet me vlerësim interpretativ për të theksuar peshën dhe relevancën e ndryshme të veprimeve, si dhe për të identifikuar dallimet midis progresit procedural dhe progresit drejt objektivave strategjike.

Veprimet që nuk kanë arritur afatin final për përfundim nuk janë përfshirë në llogaritje, përveç rasteve kur janë përfunduar përpara afatit. Në rastet kur institucionet kanë deklaruar se një veprim nuk mund të vlerësohet me përqindje, ai veprim është përjashtuar nga llogaritja.

Për qëllime të këtij raporti, bëhet dallim ndërmjet progresit procedural, i cili lidhet me realizimin formalisht të veprimeve të planifikuara, dhe progresit strategjik, i cili reflekton ndikimin real të këtyre veprimeve në transformimin e sektorit dhe në arritjen e objektivave afatgjata të Strategjisë së Energjisë.

## 2.2 Burimet e informacionit dhe analiza plotësuese (për secilin objektiv)

- Tabelat për të dhënat për çdo veprim brenda objektivave;
- Vlerësimi i realizimit për vitet 2022, 2023 dhe 2024;
- Afati i fundit për përfundimin e veprimit;
- Përqindja e realizimit të veprimeve për vitet përkatëse;
- Identifikimi i sfidave dhe mangësive për çdo veprim, dhe rekomandimet, të cilat konsiderohen nga institucionet përkatëse.

Për secilin objektiv strategjik janë përcaktuar sfidat e përgjithshme dhe rekomandimet për tejkalimin e barrierave dhe arritjen e objektivave strategjike. Kjo qasje ka mundësuar krijimin e një pasqyre të qartë mbi progresin e arritur dhe pengesat strukturore, teknike apo administrative që ndikojnë në zbatimin efektiv të strategjisë.

Për trajtim të këtij raporti monitorues janë konsultuar aktorët e sektorit të energjisë dhe gjithashtu janë shqyrtuar dokumente të cilat janë publikuar nga institucionet shtetërore dhe rregullative për këtë sektor.

Të dhënat, janë marrë kryesisht nga:

- Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës<sup>2</sup>;
- Plani i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës 2022-2025<sup>3</sup>
- Raporti i progresit për vitin 2022&2023 i PZSEK 2022-2025 nga Ministria e Ekonomisë<sup>4</sup>
- Raporti i progresit për vitin 2024 i PZSEK 2022-2025 nga Ministria e Ekonomisë<sup>5</sup>;
- Raportet vjetore të ZRrE<sup>6</sup>;
- Komunikimi direkt me institucionet dhe aktorët e tregut të sektorit të energjisë, ku një pjesë e institucioneve ka adresuar marrjen e informacioneve në Ministrinë e Ekonomisë, si drejtuese e Grupit Koordinues Ndërinstitucional për hartimin e Raportit Vjetor mbi progresin e PZSEK dhe nivelin e zbatimit të Strategjisë së Ekonomisë;
- Hulumtimet “desk based” mbi zhvillimet e sektorit të energjisë në Republikën e Kosovës.

---

<sup>2</sup> <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/03/Strategjia-e-Energjise-e-Republikes-se-Kosoves-2022-2031.pdf>

<sup>3</sup> [https://me.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/10/PZSEK-2022-2025\\_SHQ.pdf](https://me.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/10/PZSEK-2022-2025_SHQ.pdf)

<sup>4</sup> <https://me.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/05/Raporti-i-progresit-te-Zbatimit-te-PZSEK-se-2022-2023.pdf>

<sup>5</sup> <https://me.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/04/Raporti-i-progresit-te-Zbatimit-te-PZSEK-se-per-vitin-2024-Final.pdf>

<sup>6</sup> <https://www.ero-ks.org/zrre/sq/publikimet/raportet-vjetore>

### 3. Pasqyrë e përgjithshme dhe të gjeturat kryesore

Të gjeturat kryesore të këtij raporti pasqyrojnë gjendjen aktuale të zbatimit të PZSEK në fund të vitit 2024, duke kombinuar analizën sasiore të përqindjes së realizimit të veprimeve me interpretim cilësor të ndikimit të tyre në sektorin e energjisë.

Nga gjithsej 90 veprime të PZSEK 2022–2025, deri në vitin 2024 kemi këto rezultate:

- në total janë përmbyllur vetëm 26 veprime;
- ndërsa 20 veprime kanë arritur nivel zbatimi mbi 50%;
- 14 veprime janë në fazë nën 50% të zbatimit;
- 30 veprime nuk kanë nisur ende zbatimin .

Duhet theksuar se një pjesë e këtyre veprimeve kanë si afat përfundimtar vitin 2025, ndaj progresi i tyre i plotë pritet të evidentohet në periudhën e ardhshme të zbatimit. Megjithatë, edhe kur merret parasysh afati i mbetur, niveli aktual i zbatimit flet për ritme të ngadalta, veçanërisht në objektivat ku veprimet kapitale dhe strukturore janë ende në fazat më të hershme.

Niveli i përmbushjes për secilin objektiv strategjik paraqitet në tabelën e mëposhtme.

*Tabela 1. Niveli i përmbushjes së objektivave strategjike të PZSEK 2022-2025.*

Nr.	Objektivi Strategjik I deri në V	Veprime të pazbatuara	Veprimet e realizuara nën 50%	Veprimet e realizuara mbi 50%	Veprimet e realizuara 100%	Gjithsej veprimet 2022-2025
1	Përmirësimi i besueshmërisë së sistemit	7	5	5	4	21
2	Dekarbonizimi dhe promovimi i energjisë së ripërtëritshme	4	6	2	8	20
3	Rritja e efijencës së energjisë	10	3	7	6	26
4	Forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe funksionimi i tregut	7	0	3	3	13
5	Mbrojtja dhe fuqizimi i konsumatorëve	2	0	3	5	10
	Gjithsej veprimet e PZEK 2022-2025	30	14	20	26	90

Sipas metodologjisë zyrtare, përqindja e progresit rritet me realizimin e veprimeve të planifikuara, por nga një këndvështrim analitik rezulton se kjo përqindje duhet interpretuar me kujdes.

Të dhënat tregojnë disa prirje që kanë rëndësi për vlerësimin real të ecurisë së Strategjisë:

- Objektivat ku dominojnë veprimet përgatitore ose administrative shfaqin nivel më të lartë progresi, gjë që reflekton një angazhim aktiv institucional, por jo domosdoshmërisht transformim të menjëhershëm në sektor. Këto veprime janë të rëndësishme për të krijuar bazën e duhur të zbatimit, por ndikimi i tyre shfaqet zakonisht në periudha afatmesme.
- Objektivat që përmbajnë veprime kapitale apo reforma strukturore natyrshëm kërkojnë më shumë kohë për t'u realizuar, për shkak të kompleksitetit teknik, procedurave të tenderimit dhe mobilizimit të investimeve. Për këtë arsye, niveli më i ulët i progresit në këto veprime nuk është domosdoshmërisht tregues i ngecjes, por sinjal i rëndësisë së ndjekjes së afateve dhe koordinimit ndërinstitutional, me qëllim që dinamika të përputhet me objektivat strategjike deri në vitin 2025.
- Fakti që 30 veprime nuk kanë nisur ende sugjeron se një pjesë e rëndësishme e planit të zbatimit mbetet për t'u aktivizuar. Kjo kërkon vëmendje të shtuar në fazën e ardhshme, duke analizuar nëse vonesat lidhen me mungesë kapacitetesh, prioritizim të pamjaftueshëm, apo procedura të zgjatura.
- Në këtë kuadër, përqindjet e progresit duhen lexuar si sinjal i dinamikës së zbatimit, por jo si tregues i peshës apo ndikimit real të secilit veprim në arritjen e objektivave strategjike. Kjo e bën të domosdoshëm interpretimin cilësor të të dhënave, përtej numrit të veprimeve të realizuara.

### Sfidat e identifikuara

Një çështje që del nga analiza është shkalla e kufizuar e përfshirjes së nivelit lokal në zbatimin e Strategjisë së Energjisë. Strategjia është një dokument qendror, ndaj është e pritshme që përgjegjësitë kryesore të kenë karakter nacional. Megjithatë, fusha të rëndësishme të tranzicionit energjetik – si eficientia e energjisë në ndërtesa, energjia e shpërndarë, komunitetet energjetike, shërbimet e ngrohjes dhe ndërgjegjësimi publik kërkojnë veprime dhe koordinim të drejtpërdrejtë në nivel lokal. Nga gjithsej 90 veprime të PZSEK, vetëm 3 janë të përcaktuara formalisht me përgjegjësi direkte në nivel komunal, çka tregon se dimensionin lokal i tranzicionit

energjetik është i reflektuar në mënyrë të kufizuar në Planin e Zbatimit. Kjo nuk lidhet me mungesë kapacitetesh në nivel lokal, por me mënyrën e dizajnit të instrumenteve të zbatimit, të cilat aktualisht mbeten të përqendruara kryesisht në nivel qendror.

Roli i shoqërisë civile në zbatim dhe monitorim institucional gjithashtu ka qenë i kufizuar, duke reduktuar mundësinë për monitorim të pavarur dhe për të krijuar një pasqyrë më gjithëpërfshirëse të realitetit në terren. Përfshirja më e strukturuar e aktorëve jopublikë do të mundësonte rritje të transparencës dhe reflektim më të mirë të nevojave të qytetarëve.

Sa i përket ritmit të zbatimit, është e pritshme që veprimet administrative të përfundojnë më shpejt sesa ato kapitale apo strukturore. Megjithatë, analiza tregon pabarazi të theksuar në dinamikë, e cila mund të krijojë perceptim më të lartë progresi sesa ndikimi real. Kjo kërkon balancim më të mirë të fokusit ndërmjet veprimeve procedurale dhe atyre me ndikim të madh.

#### Implikimet kryesore

- Pavarësisht progresit të arritur, pabarazia në nivelin e zbatimit midis veprimeve sugjeron një nevojë për rishikim të prioriteteve dhe për alokim më të balancuar të burimeve.
- Mungesa e angazhimit lokal dhe e shoqërisë civile paraqet rrezik për qëndrueshmërinë e rezultateve, pasi strategjitë që mbështeten vetëm në nivel qendror kanë më pak gjasa të përkthehen në ndikim të drejtpërdrejtë në terren.
- Për të rritur efektivitetin, procesi i zbatimit duhet të shoqërohet me mekanizma më të fortë të koordinimit ndërinstytucional, si dhe me nxitjen e partneriteteve mes qeverisë qendrore, komunave dhe shoqërisë civile.

#### Rekomandime të përgjithshme

Rekomandimet e mëposhtme bazohen në të gjeturat e monitorimit dhe synojnë të adresojnë pengesat strukturore dhe institucionale të identifikuara gjatë zbatimit të PZSEK, duke respektuar rolet dhe kompetencat e institucioneve përgjegjëse.

Në fazën e ardhshme, përveç fokusit të përmbyllja e veprimeve të mbetura, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet:

1. Përfshirjes më të strukturuar të nivelit lokal në fusha ku roli i tyre është vendimtar (efiçienca, ndërtesat publike, energjia e shpërndarë, komunitetet energjetike), për të rritur ndikimin në terren.

2. Rritjes së rolit të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë në rritjen e transparencës dhe raportimit publik, me qëllim të rritjes së besueshmërisë në proces dhe për të mobilizuar mbështetje më të gjerë shoqërore.
3. Fokus i shtuar tek veprimet kapitale dhe me ndikim të lartë, në mënyrë që dinamika e zbatimit të jetë e përputhshme me objektivat dhe afatet e Strategjisë.
4. Përmirësimi i metodës së raportimit të progresit, duke dalluar mes veprimeve procedurale dhe atyre strukturore, në mënyrë që raportet të reflektojnë më qartë ndikimin real në sektor.
5. Prioritizimit të veprimeve të pazbatuara, duke analizuar arsyet e vonesave dhe duke përcaktuar masa korigjuese në mënyrë që objektivat të arrihen deri në vitin 2025.

## KREU II

Kreu II paraqet vlerësimin e përmbushjes së objektivave strategjike të PZSEK 2022–2025, përmes një analize të detajuar të objektivave specifike dhe veprimeve të parashikuara për zbatimin e tyre. Për secilin objektiv strategjik, raporti kombinon (i) të dhënat mbi progresin e veprimeve dhe (ii) komentimin analitik mbi rëndësinë dhe ndikimin e tyre në besueshmërinë, dekarbonizimin, eficientësinë, tregun dhe mbrojtjen e konsumatorëve. Secili objektiv ka nga një ngjyrë identifikuese, me qëllim të lehtësimin të leximit dhe përcjelljes së dokumentit, si më poshtë:

- 1. Objektiv strategjik I: Përmirësimi i besueshmërisë së sistemit**
- 2. Objektiv strategjik II: Dekarbonizimi dhe promovimi i energjisë së ripërtëritshme**
- 3. Objektiv strategjik III: Rritja e eficientësisë së energjisë**
- 4. Objektiv Strategjik IV: Forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe funksionimi i tregut**
- 5. Objektiv Strategjik V: Mbrojtja dhe fuqizimi i konsumatorëve**

---

**Objektivi Strategjik I:  
Përmirësimi i besueshmërisë së sistemit**

## 1. Objektivi Strategjik I: Përmirësimi i besueshmërisë së sistemit

Objektivi strategjik I për përmirësimin e besueshmërisë së sistemit vlerësohet përmes vlerave:

- SAIDI: Indeksi mesatar i kohëzgjatjes së ndërprerjes së sistemit;
- SAIFI: Indeksi mesatar i frekuencës së ndërprerjeve të sistemit.

Këto vlera duhet të minimizohen maksimalisht në mënyrë që të rritet siguria e furnizimit me energji elektrike. Në tabelën vijuese është shfaqur objektivi i kufinjëve të këtyre vlerave sipas strategjisë së energjisë:

*Tabela 2. Objektivi i kufinjëve të vlerave SAIDI dhe SAIFI.*

Nr.	Objektivat strategjike dhe specifike, treguesit dhe veprimet	Vlera bazë	Objektivi afatshkurtër 2025	Objektivi i vitit të fundit 2031
<b>I</b>	<b>OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: PËRMIRËSIMI I BESUESHMËRISË SË SISTEMIT</b>			
1	Indikatori: Indeksi mesatar i kohëzgjatjes së ndërprerjes së sistemit (SAIDI)	SAIDI: 80.83 orë/vit (2021)	SAIDI: 63 orë/vit	SAIDI: 51.84 orë/vit
2	Indikatori: Indeksi mesatar i frekuencës së	SAIFI: 58.27 (2021)	SAIFI: 49	SAIFI: 40.86

Për të përmirësuar indekset SAIDI dhe SAIFI, PZSEK 2022-2025 përfshin 4 objektiva specifike:


1. Rritja e fleksibilitetit të sistemit;
2. Modernizimi i rrjeteve dhe reduktimi i humbjeve në rrjet;
3. Rehabilitimi i kapaciteteve ekzistuese të prodhimit të energjisë elektrike;
4. Garantimi i sigurisë kibernetike të sektorit të energjisë.

Secili prej këtyre objektivave ka të caktuar veprimet e ndërmarra për përmbushjen e tyre. Në tabelën dhe grafën e mëposhtëm është paraqitur përmbushja e secilit objektiv specifik, dhe po ashtu, mesatarja e përmbushjes së objektivit strategjik duke u bazuar në përmbushjen e objektivave specifike.

**Tabela 3. Përqindja totale e realizuar për objektivin strategjik për vitet 2022-2024.**

Nr.	Objektivi Specifik	% e realizimit
1	Rritja e fleksibilitetit të sistemit	100%
2	Modernizimi i rrjeteve dhe reduktimi i humbjeve në rrjet	70.5%
3	Rehabilitimi i kapaciteteve ekzistuese të prodhimit të energjisë elektrike	2.66%
4	Garantimi i sigurisë kibernetike të sektorit të energjisë	100%
<b>Përqindja mesatare e realizimit të objektivit strategjik</b>		<b>68.29%</b>

**Grafiku 2. Realizimi i objektivave specifike për përmirësimin e besueshmërisë së rrjetit.**



Nga të dhënat në tabelë dhe grafik vërehet mospërputhje e theksuar ndërmjet progresit të objektivave specifike, ku rehabilitimi i kapaciteteve ekzistuese të prodhimit shfaq progres minimal (2.66%) krahasuar me objektivat e tjera. Kjo mospërputhje sugjeron nevojë për vëmendje të shtuar dhe adresim të pengesave kryesore të zbatimit. Kurse modernizimi i rrjeteve dhe reduktimi i humbjeve, ku rol kryesor kanë KEDS dhe KOSTT, ka pasur progres prej 70.5% në krahasim me caqet për vitin 2024. Rezultat të plotë ka pasur në aspektet e rritjes së fleksibilitetit të sistemit dhe garantimin e sigurisë kibernetike në sektorin e energjisë. Më poshtë gjendet komentimi i realizimit të objektivave specifike duke marrë parasysh rrethanat dhe peshën e tyre në sektorin e energjisë në Kosovë.

Poashtu në tabelën e mëposhtme është paraqitur niveli i përmbushjes së veprimeve, përfshirë ato të përfunduara tërësisht dhe ato që janë përfunduar mbi 50% për vitin 2024:

**Tabela 4. Niveli i përmbushjes së veprimeve të objektivave specifike deri në vitin 2024.**

Nr.	Objektivi Specifik	Veprime të pazbatuara deri në 2024	Veprimet e realizuara nën 50% deri në 2024	Veprimet e realizuara mbi 50% deri në 2024	Veprime të realizuara 100% deri në 2024	Veprime të planifikuara pas vitit 2024	Gjithsej veprimet 2022-2025
1	Rritja e fleksibilitetit të sistemit	0	0	0	2	3	5
2	Modernizimi i rrjeteve dhe reduktimi i humbjeve në rrjet	0	3	5	1	0 <sup>7</sup>	9
3	Rehabilitimi i kapaciteteve ekzistuese të prodhimit të energjisë elektrike	2	1	0	0	1	4
4	Garantimi i sigurisë kibernetike të sektorit të energjisë	0	0	0	1	2	3
	<b>Gjithsej veprimet e objektivit strategjik I</b>	<b>2</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>4</b>	<b>6</b>	<b>21</b>

## 1.2 Komentim mbi përmbushjen e objektivave specifike

Objektivi Strategjik I: Përmirësimi i besueshmërisë së sistemit përbën një nga shtyllat themelore të Strategjisë së Energjisë së Kosovës, pasi lidhet drejtpërdrejt me sigurinë e furnizimit, stabilitetin operacional të sistemit elektroenergjetik dhe aftësinë e vendit për të përballuar tranzicionin energjetik në mënyrë të qëndrueshme. Për një sistem që mbështetet ende në masë të madhe në kapacitete të vjetruara gjeneruese dhe përballat me kërkesë në rritje për energji elektrike, besueshmëria nuk është vetëm çështje teknike, por parakusht për stabilitet ekonomik, shëndet publik dhe përmbushje të detyrimeve ndërkombëtare.

Nga të dhënat shihet se në aspektin e sigurisë kibernetike dhe fleksibilitetit të sistemit institucionet përkatëse kanë dhënë rezultat të suksesshëm. Gjithsesi, është shqetësues fakti që në aspektin e rehabilitimit të kapaciteteve ekzistuese të prodhimit të energjisë elektrike me qymyr progresi është vetëm 2.66%. Pavarësisht se objektivat specifike janë llogaritur si të barabarta në përqindjen e realizimit të objektivit strategjik, ky indikator ka rëndësi të veçantë për sigurinë energjetike dhe nuk mund të trajtohet thjesht si një përqindje krahasuese me objektivat e tjerë. Në këtë drejtim, kërkohet vëmendje e shtuar dhe masa të përshpejtuara për të shmangur rrezikun

<sup>7</sup> Të gjitha veprimet e këtij objektivit specifik kanë caqe vjetore dhe nuk kanë afat përfundimtar të realizimit, prandaj në llogaritje janë përfshirë arritjet ndaj vitit 2024. Veprime të tilla nuk hasen në objektiva të tjera specifike apo strategjike.

e cenimit të stabilitetit afatgjatë të sektorit energjetik në Kosovë, teksa rehabilitimi i kapaciteteve ekzistuese është ndër çështjet më me peshë në këtë drejtim.

Termocentralet ekzistuese përfshijnë 77.44% të kapaciteteve për prodhim të energjisë elektrike në Kosovë, kurse kapacitetet e burimeve të ripërtëritshme të energjisë përbëjnë 22.56% të kapaciteteve<sup>8</sup>. Përveç aspektit të kapaciteteve të instaluar, energjia e prodhuar nga termocentralet e qymyrit është energji e prodhuar në mënyrë konstante, kurse burimet e ripërtëritshme të energjisë prodhojnë energji elektrike varësisht nga kushtet klimatike dhe atmosferike. Kjo do të thotë se shumica e energjisë së prodhuar nga termocentralet është edhe më e lartë se energjia e prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë.

Kjo është tejet shqetësuese pasi që këto kapacitete prodhuese me qymyr janë ndërtuar gjatë viteve 1962–1984 dhe operojnë në mënyrë të amortizuar. Operimi i këtyre termocentraleve shkakton ndotje të konsiderueshme të ajrit, pasojat e së cilës i bartin drejtpërdrejt qytetarët e Republikës së Kosovës. Sipas vlerësimeve ndërkombëtare, ndotja e ajrit në Kosovë lidhet me rreth 760 vdekje të parakohshme në vit, ndërsa kostoja ekonomike e dëmeve shëndetësore vlerësohet rreth 240 milionë USD në vit, që përfaqëson afërsisht 3.6% të Prodhimit të Brendshëm Bruto.<sup>9</sup> Vendndodhja e këtyre termocentraleve e përkeqëson më tej situatën, pasi ato ndodhen në afërsi të zonave të banuara dhe të qytetit të Prishtinës, duke rritur ekspozimin e popullsisë ndaj ndotjes.

Mbyllja e Termocentralit Kosova A dhe rehabilitimi i Termocentralit Kosova B duhet të jenë ndër prioritetet kryesore të institucioneve përkatëse. Çdo vonesë në këto procese jo vetëm që pengon zhvillimin e sistemit elektroenergjetik të Kosovës, por gjithashtu shkakton pasojat të rënda për shëndetin e qytetarëve që jetojnë në afërsi të tyre. Këto termocentrale, si kapacitetet më të mëdha të prodhimit të energjisë në vend, operojnë me teknologji të vjetëruar, joefikase dhe me ndikim të lartë ndotës, gjë që e bën ndërhyrjen urgjente dhe të domosdoshme.

---

<sup>8</sup> ZRrE, Raporti vjetor 2024

<sup>9</sup> World Bank (2019). Air Pollution Management in Kosovo. Washington, DC: World Bank Group. <https://documents1.worldbank.org/curated/en/927281579895920533/pdf/Air-Pollution-Management-in-Kosovo.pdf>

## 1.2. Përbushja e veprimeve të objektivave specifike

### 1.2.1 Rritja e fleksibilitetit të sistemit

Indikatori sipas PZSEK: Niveli i kapacitetit rregullues fleksibil:

- 5 MW (2021),
- 5 MW (2025),
- 170 MW (2031).

Në tabelat e mëposhtme janë listuar veprimet për arritjen e objektivit specifik:

1.1.1. Veprimi: Përgatitja e parafizibilitetit, fizibilitetit dhe projekteve teknike për sistemin e ruajtjes së baterive		
Institucioni	Financimi	Afati
MCC, ME, KOSTT	Donatorët	2025
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Aktiviteti nuk ka peshë përqindjeje. Konsulenti për dizajn dhe mbikëqyrje të sistemit BESS është angazhuar në nëntor 2023 dhe ka nisur punën në dizajnin bazë dhe përgatitjen e dokumenteve të tenderit për ndërtim.	Konsulenti për dizajn dhe mbikëqyrje të BESS ka filluar punën në nëntor 2023. Janë përfunduar analizat gjeoteknike, është përgatitur dizajni bazë fillestar dhe raporti i hulumtimit të tregut për teknologjitë e BESS. Po ashtu, ka nisur përgatitja e dokumenteve të tenderit dhe është lansuar kërkesa për informata nga tregu.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
N/A	N/A	N/A
Sfidat dhe Rekomandimet		
Zbatimi i aktiviteteve është duke u vonuar për shkak të kushteve strikte, koordinimit me institucione të ndryshme, dhe mungesës së ekspertizës për sistemet BESS, që ka çuar në anulime prokurimesh. Vendimmarrja është e ndërlikuar dhe e ngadaltë për shkak të strukturës trekëndore të aprovimeve dhe afatit strikt 5-vjeçar të Programit. Përditësimi i rregullt i planeve të punës ndihmon në identifikimin e hershëm të sfidave.		

1.1.2. Veprimi: Mbështetje teknike dhe ligjore për integrimin e baterive - Projekti i MCC		
Institucioni	Financimi	Afati
MCC, ME, KOSTT	Donatorët	2025
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Konsulentët për BESS janë angazhuar në maj 2023 për të hartuar kuadrin ligjor dhe analizuar opsionet e pronësisë për KOSTT. Ata kanë n dihmuar në krijimin e ndërmarrjes publike MFES dhe në plotësimin e kushteve pararendëse. Po ashtu, është planifikuar angazhimi i një konsulenti për asistencë teknike për mbështetje në funksionalizimin e ndërmarrjes.	Konsulentët për BESS janë angazhuar që nga maji 2023 për të hartuar kuadrin ligjor dhe analizuar pronësinë e baterive për KOSTT. Ata kanë mbështetur krijimin e Korporatës së Ruajtjes së Energjisë dhe plotësimin e kushteve pararendëse. Pas themelimit të ndërmarrjes në mars 2024, ka nisur rekrutimi i stafit dhe konsulenca për asistencë teknike, përfshirë hartimin e planit të biznesit dhe rregulloreve teknike. Po ashtu, është shpallur konkursi për Drejtor të Bordit.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
N/A	N/A	N/A
Sfidat dhe Rekomandimet		
Zbatimi i veprimit përballlet me vonesa për shkak të kushteve strikte, koordinimit me aktorë të shumtë dhe mungesës së ekspertizës në treg për BESS, që ka çuar në anulime prokurimesh. Struktura komplekse e vendimmarrjes dhe afati 5-vjeçar kufizojnë fleksibilitetin, por përditësimi i rregullt i planeve ndihmon në identifikimin e hershëm të sfidave.		

1.1.3. Veprimi: Master Plani i Zhvillimit të Gazit dhe Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor (VNM)		
Institucioni	Financimi	Afati
ME, MMPHI, MINT	WBIF/IPF9	2023
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Mos-realizimi i aktivitetit në vitin 2022 ka ardhur si pasojë e mungesës së politikave të qarta për gazin, pasi Strategjia e Energjisë ishte ende në proces të hartimit.	Master Plani i zhvillimit të gazit në Kosovë ka përfunduar dhe me datë 07.11.2023 është pranuar pëlqimi nga MMPHI lidhur me raportin për Vlerësimin Strategjik Mjedisor.	Ka përfunduar.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	100%	100%
Sfidat dhe Rekomandimet		
N/A		

**1.1.4. Veprimi: Studimi i fizibilitetit për Gazsjellësin e Interkoneksionit të Maqedonisë Veriore – Kosovë**

Institucioni	Financimi	Afati
ME, MMPHI, MINT	WBIF/IPF9	2023
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Mos-realizimi i aktivitetit në vitin 2022 ka ardhur si pasojë e mungesës së politikave të qarta për gazin, pasi Strategjia e Energjisë ishte ende në proces të hartimit.	Ky studim ka përfunduar dhe si i tillë është raportuar në TM2 2023.	Ka përfunduar.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	100%	100%
Sfidat dhe Rekomandimet		
N/A		

**1.1.5. Veprimi: Studim për identifikimin e potencialit të energjisë gjeotermale në Kosovë**

Institucioni	Financimi	Afati
ME	Donatorët	2025
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Nuk ka progres	Nuk ka filluar ende
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	0%	0%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment nga institucioni përkatës.		

## 1.2.2 Modernizimi i rrjeteve dhe reduktimi i humbjeve në rrjet

Indikatorët sipas PZSEK:

- Humbjet në shpërndarje:
  - o 18.48% baza (2021) ,
  - o N/A(2025),
  - o 9% (2031).
- Sasia e kapacitetit variabil të BRE-ve që rrjeti është në gjendje të trajtojë/ integrojë:
  - o 147 MW baza (2021),
  - o 500 MW (2025),
  - o 2000 MW (2031).

*Shënim: Në disa veprime, përqindja e realizimit mund të kalojë 100%, pasi institucionet kanë raportuar realizim mbi planifikimin vjetor (p.sh. investime ose numër njëhësorësh më i lartë se objektivi i planifikuar për atë vit). Në këto raste, vlera >100% nënkupton tejkalim të planit vjetor, jo tejkalim të objektivit strategjik afatgjatë.*

Në tabelat e mëposhtme janë listuar veprimet për arritjen e objektivit specifik:

1.2.1. Veprimi: Zhvillimi i sistemit (SCADA & Telekomunikacion)		
Institucioni	Financimi	Afati
KOSTT	KOSTT	Vjetore
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Projekti ka pësuar vonesa dhe ende nuk ka nisur zbatimin. Arsyeja e shtyrjes është vonesa në ratifikimin e marrëveshjes me KfW. Deri tani nuk ka realizim financiar (0€). Projekti është ri-klasifikuar në grupin 16 të projekteve të financuara nga KfW në fazën e VII-të.	Projektet janë përfshirë në fazën VII të financimit nga KfW dhe do të zbatohen në katër LOT-e. Vonesat lidhen me ratifikimin e vonuar të marrëveshjes. Deri tani nuk ka realizim financiar. Është nënshkruar kontrata me kompaninë konsulente për përgatitjen e dokumentacionit teknik dhe tenderit. Zbatimi pritet nga TM1 2026 deri në TM4 2027.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	100%	100%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Vonesat e shkaktuara në ratifikimin e marrëveshjes për kredi.		

1.2.2. Veprimi: Përforcimi dhe rehabilitimi i rrjetit ekzistues të energjisë (OST)		
Institucioni	Financimi	Afati
KOSTT	KOSTT	Vjetore
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Projekti është i përfshirë në paketën e projekteve të planifikuara për financim përmes kredisë KfW, faza VII. Për shkak të vonesave në nënshkrimin dhe ratifikimin e marrëveshjes, realizimi pritet të ndodhë gjatë periudhës 2024-2027.	Projekti ka vonesa dhe ende nuk ka nisur zbatimin. Shtyrja ka ardhur për shkak të vonesës në ratifikimin e marrëveshjes me KfW. Nuk ka realizim financiar (0€). Projekti është ri-ndarë në grupin e projekteve për financim në fazën VII të KfW.	Projektet janë përfshirë në grupin e financimit KfW, faza VII, dhe do të realizohen në katër LOT-e. Vonesat lidhen me ratifikimin e vonuar të marrëveshjes. Realizimi financiar është 0€. Ka filluar përzgjedhja e kompanisë konsulente për përgatitjen e specifikimeve dhe dokumentacionit të tenderit. Projekti pritet të realizohet nga TM1 2026 deri në TM4 2027.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	0%	10%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Vonesat e shkaktuara në ratifikimin e marrëveshjes për kredi.		

1.2.3. Veprimi: Ndërtimi i kapaciteteve të reja të transmetimit dhe kapaciteteve transformuese - Reaktori shunt-variabël (100 MWAr)		
Institucioni	Financimi	Afati
KOSTT	KOSTT	Vjetore
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Projekti ende nuk ka nisur dhe ka vonesa. Shtyrja është pasojë e vonesës në ratifikimin e marrëveshjes me KfW. Realizimi financiar është 0€. Projekti është kaluar në grupin e projekteve për financim në fazën VII të KfW..	Projektet janë përfshirë në fazën VII të financimit nga KfW dhe do të realizohen në katër LOT-e. Për shkak të vonesës në ratifikimin e marrëveshjes, ka pasur vonesa dhe realizimi financiar është 0€. Është nënshkruar kontrata me kompaninë konsulente më 26.11.2024 për përgatitjen e dokumentacionit, ndërsa zbatimi planifikohet nga TM1 2026 deri në TM4 2027.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	0%	10%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment nga institucioni përkatës.		

1.2.4. Veprimi: Mbështetja e ngarkesës/ Nyjet e reja 110/10 (20) kV (OST & OSSH) (SS Katrioti Ferizaj 3 dhe TS Malisheva" (SS Katrioti Ferizaj 3 and TS Malisheva		
Institucioni	Financimi	Afati
KOSTT	KOSTT	Vjetore
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
NS Ferizaj 3: 60% e punimeve të përfunduara deri në fund të 2022; vonesa për shkak të shpronësimeve, përfundimi pritet në TM2 2024. NS Fushë Kosova: 15% e realizuar në 2022, brenda planit; përfundimi pritet në 2024. NS Malishevë: Në fazën e përgatitjes së dokumentacionit ndërtimor, tenderimi pritet në 2024.	NS Ferizaj 3 – Katrioti: Përfunduar në qershor 2023, por nuk është energjizuar për shkak të vonesave në ndërtimin e linjës 110kV si pasojë e ankesave ligjore. NS Fushë Kosova: 90% e punëve të përfunduara deri në fund të 2023; përfundimi planifikohet në 2024. NS Malishevë: Në fazën e përgatitjes së dokumentacionit për leje ndërtimi; shpenzuar rreth 3.93 milion € në 2023.	NS Ferizaj 3 – Katrioti: Përfunduar në qershor 2023, por ende jo i energjizuar për shkak të vonesave në ndërtimin e linjës 110kV, të ndikuara nga pezullime dhe ankesa ligjore. NS Fushë Kosovë: Ndërtimi përfunduar në dhjetor 2024 me instalimin e trafos 40MVA. Energjizimi i plotë pritet në vitin 2025. NS Malishevë: Projekti është në fazë përfundimtare të dizajnit dhe në pritje të lejes ndërtimore. Tenderimi planifikohet në TM1 2025 dhe zbatimimi në TM3 2025 – TM4 2026.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
37.50%	57.50%	85%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Vonesat e shkaktuara në marrjen e lejeve ndërtimore.		

1.2.5. Veprimi: Projektet e Tensionit të Mesëm 35/10(20) kV		
Institucioni	Financimi	Afati
ME	Donatorët	Vjetore
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Në vitin 2022 janë realizuar investime prej 9.2 milionë € në rrjetin e tensionit të mesëm për përforsim dhe shndërrim nga 10 kV në 20 kV, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë dhe sigurisë së furnizimit, reduktimin e humbjeve dhe modernizimin e rrjetit.	Gjatë vitit janë realizuar 11.3 milionë € investime në rrjetin e tensionit të mesëm për përforsim dhe shndërrim nga 10 kV në 20 kV, duke synuar përmirësimin e cilësisë dhe sigurisë së furnizimit, reduktimin e humbjeve dhe modernizimin e rrjetit.	Gjatë vitit 2024 janë realizuar projekte investive në rrjetin e tensionit të mesëm në disa rajone të Kosovës, me vlerë mbi 10.6 milionë euro. Investimet synojnë përforsimin e rrjetit, zëvendësimin e pajisjeve të vjetra dhe përmirësimin e cilësisë së furnizimit me energji elektrike.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
196%	86%	77%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Projektet për zgjerimin dhe modernizimin e rrjetit u përballën me sfida si mungesa e lejeve, fuqisë punëtore, vonesa të materialeve dhe bashkëpunimi me komunitat, por OSSh mbetet e përkushtuar për realizimin me sukses të tyre.		

1.2.6. Veprimi: Projektet e Tensionit të Ulët 0.4 kV		
Institucioni	Financimi	Afati
KEDS	KEDS	Vjetore
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Në vitin 2022 janë realizuar 6,086,381.41 € investime në rrjetin e tensionit të ulët për përfundim dhe zgjerim, me qëllim përmirësimin e furnizimit, sigurisë, qasjes në pikën matëse dhe reduktimit të humbjeve.	Janë investuar 8,746,941.75 € në rrjetin e tensionit të ulët për përfundim dhe zgjerim, me synim përmirësimin e cilësisë dhe sigurisë së furnizimit, lehtësimin e qasjes dhe reduktimin e humbjeve.	Janë investuar 8,699,661.75 € në rrjetin e tensionit të ulët për projekte të përfundimit dhe zgjerimit në rajone të ndryshme të Kosovës. Analiza e investimeve është bazuar në prioritetet për zonat me gjendje të vjetruar dhe kritike.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
66%	125%	63%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Projektet për zgjerimin dhe modernizimin e rrjetit u përballën me sfida si mungesa e lejeve, fuqisë punëtore, vonesa të materialeve dhe bashkëpunimi me komunat, por OSSh mbetet e përkushtuar për realizimin me sukses të tyre.		

1.2.7. Veprimi: Rrjeti i zgjuar (Smart Grid)		
Institucioni	Financimi	Afati
KEDS	KEDS	Vjetore
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Janë realizuar 14,513.93 € investime në rrjetin e zgjuar, me qëllim monitorimin dhe kontrollin në kohë reale, përmirësimin e cilësisë së furnizimit, ofrimin e informacionit të menjëhershëm për rrjetin dhe reagimin e shpejtë ndaj prishjeve.	Janë realizuar 319,420.90 € investime në rrjetin e zgjuar, duke mundësuar monitorimin dhe kontrollin në kohë reale, përmirësimin e cilësisë së furnizimit, ofrimin e informacionit të menjëhershëm dhe reagimin e shpejtë ndaj prishjeve.	Janë realizuar 3,841,450.46 Euro investime në rrjetin e shpërndarjes në vitin 2024, duke përfshirë pajisje të mençura, sistemin SCADA, ndërrimin e transformatorëve dhe projektin GIS. Këto investime kanë përmirësuar efikasitetin, monitorimin dhe performancën e rrjetit, duke rritur cilësinë e energjisë dhe duke ulur kohën e ndërprerjeve.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
2%	13%	92%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Pavarësisht realizimit të suksesshëm të këtyre projekteve, siç ndodh me çdo projekt tjetër, janë hasur disa sfida dhe mangësi, si vështirësitë e hasura gjatë instalimit të sistemeve dhe teknologjive të reja në infrastrukturën ekzistuese të rrjetit shpërndarës. Megjithatë, këto sfida janë menaxhuar në mënyrë të efektshme, duke mundësuar përfundimin e projekteve me vonesa minimale dhe sukses.		

1.2.8. Veprimi: Instalimi i njehësorëve		
Institucioni	Financimi	Afati
KEDS	KEDS	Vjetore
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Në vitin 2022 janë realizuar 1,612,032.6 € për instalimin e njehësorëve, duke ndërruar 20,013 dhe instaluar 25,782 njehësorë të rinj. Projektet do të sjellin saktësi në matje, matje në distancë, faturim të saktë dhe shpejtë, si dhe reduktimin e humbjeve komerciale.	Janë realizuar 4,473,568.6 € për instalimin e njehësorëve, duke ndërruar 27,901 dhe instaluar 24,750 njehësorë të rinj. Këto projekte do të sigurojnë saktësi në matje, matje në distancë, faturim të saktë dhe shpejtë, dhe reduktim të humbjeve komerciale.	Në vitin 2024, OSSh-ja ka realizuar 27,238 ndërrime njehësorësh, përfshirë 4,681 nga mekanik në digjital. Arsytet për ndërrimin përfshijnë modernizimin në njehësorë Smart, vendosjen e njehësorëve PLC sipas projekteve të TU të aprovuara, ndërrimin nga mekanik në elektronik, vlefshmërinë e vulës metrologjike dhe instalimin e njehësorëve për prosumatorët (panelet solare).
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
137%	112%	154%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Projektet e vitit 2024 janë realizuar me sukses, por janë hasur sfida gjatë implementimit, si mungesa e fuqisë punëtore, vështirësitë në qasjen e konsumatorëve (diaspora, migrimi), pengesat gjatë ndërrimeve të njehësorëve nga mekanik në elektronik, dhe lidhjet e reja të konsumatorëve pa autorizim dhe pa njehësorë në përputhje me rregulloret. Ndërhyrjet në njehësorë Përballë sfidave të shumta por përkundër të gjitha sfidave OSSh-ja mbetet e përkushtuar për të kapërcyer këto pengesa dhe për të arritur rezultate të suksesshme.		

1.2.9. Veprimi: Investimet kapitale në teknologjinë informative		
Institucioni	Financimi	Afati
KEDS	KEDS	Vjetore
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Janë realizuar 896,096.3 € investime në Teknologjinë Informative, me qëllim: * Mbrojtjen e të dhënave nga sulmet keqdashëse, * Sigurinë kibernetike, * Thjeshtimin e strukturës së të dhënave dhe proceseve të biznesit, * Rritjen e produktivitetit.	Janë realizuar 1,190,419.8 € investime në Teknologjinë Informative, duke arritur: * Mbrojtjen e të dhënave, * Sigurinë kibernetike, * Thjeshtimin e strukturës së të dhënave dhe proceseve të biznesit, * Rritjen e produktivitetit.	Janë realizuar 1,561,588.43 € investime në Teknologjinë Informative (TI) gjatë vitit 2024, për përmirësimin e sigurisë, modernizimin e infrastrukturës dhe rritjen e efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së sistemeve dhe proceseve teknologjike.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
113%	77%	73%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Gjatë zbatimit të projekteve të IT-së, përballemi me sfida të ndryshme si sigurimi i mjeteve të nevojshme, përshtatja me teknologjitë e reja dhe menaxhimi i risqeve kibernetike. Po ashtu, procesi ka kërkuar koordinim të lartë midis departamenteve për të siguruar një integrim efikas dhe funksional të sistemeve të reja.		

## 1.2.3 Rehabilitimi i kapaciteteve ekzistuese të prodhimit të energjisë elektrike

Indikatorët sipas PZSEK:

- Numri i njësive të rinovuara të linjtit:
  - o 0 (2021),
  - o 2 (2025),
  - o 3 ose 4 (2031).
- Numri i njësive të mbyllura të linjtit:
  - o 0 (2021),
  - o 0 (2025),
  - o 1 ose 2 (2031).

Në tabelat e mëposhtme janë listuar veprimet për arritjen e objektivit specifik:

1.3.1. Veprimi: Rehabilitimi i njësive Kosova B1		
Institucioni	Financimi	Afati
KEK, ME, ZRRE	KEK, BE	2024
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Projekti i KEK është shtyrë disa herë për shkak të pandemisë, dhe më pas në vitin 2022 u shty për shkak të punimeve shtesë në dilatatimet (bojlerët). Në fund, është vendosur që realizimi i tij të bëhet në vitin 2026.	Projekti i DeNOx-it dhe i Filtrave Elektrostatik u shty për vitin 2026 për njësinë B1 dhe për vitin 2027 për njësinë B2. Kështu, u shtynë edhe projektet që KEK/TCB kishte planifikuar të implementonte gjatë kësaj periudhe. Gjatë vitit 2025, do të realizoheshin projekte për modernizimin e turbinës dhe ndërrimin e zbarrave të gjeneratorit në njësinë B2. Kjo nënkupton se gjatë vitit 2024 nuk pati progres në implementimin e projekteve.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	0%	0%
Sfidat dhe Rekomandimet		
<p>Projekti i DeNOx-it dhe i filtrave elektrostatik mbulohet me financim nga Zyra e BE-së në Prishtinë, e cila është autoritet kontraktues. KEK është pala përfituese e projektit, që mbulon njësitë B1 dhe B2 të TC Kosova B. Kontrata e nënshkruar më 2 dhjetor 2019 u vonua për shkak të pandemisë COVID-19 dhe krizës energjetike, si dhe çrregullimeve në tregun e çelikut. Aktualisht, kontrata është në proces amendimi dhe projekti pritet të realizohet në B1 në vitin 2026 dhe në B2 në vitin 2027.</p>		

1.3.2. Veprimi: Rehabilitimi i njësive Kosova B2		
Institucioni	Financimi	Afati
KEK, ME, ZRRE	KEK, BE	2025
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Projekti i KEK fillimisht është shtyrë për shkak të pandemisë dhe më pas në vitin 2022 për shkak të punimeve shtesë në dilatatimet (bojlerët). Sidoqoftë, projekti do të realizohet tani në vitin 2025.	Projekti i DeNOx-it dhe i filtrave elektrostatik u zhvendos për vitet 2026 për njësinë B1 dhe 2027 për B2. Si pasojë e kësaj shtyrjeje, projektet që KEK-i kishte planifikuar të realizonte gjatë periudhës së implementimit të DeNOx-it dhe filtrave elektrostatik u shtynë gjithashtu. Gjatë vitit 2024, nuk pati progres në implementimin e projekteve, por në vitin 2025 planifikohen realizimin e projekteve për modernizimin e turbinës dhe ndërrimin e zbarrave të gjeneratorit në njësinë B2.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	0%	0%
Sfidat dhe Rekomandimet		
<p>Projekti i DeNOx-it dhe i filtrave elektrostatik do të financohet nga Zyra e BE-së në Prishtinë, e cila është gjithashtu Autoriteti Kontraktues. KEK është përfitues i këtij projekti që mbulon njësitë B1 dhe B2 të TC Kosova B. Kontrata, e nënshkruar më 2 dhjetor 2019, u vonua për shkak të pandemisë COVID-19 dhe krizës energjetike, duke shkaktuar shtyrje të projektit. Aktualisht, kontrata është në proces amendamenti dhe projekti pritet të realizohet në B1 në vitin 2026 dhe në B2 në vitin 2027.</p>		

1.3.3. Veprimi: Rehabilitimi i një njësie të Kosova A		
Institucioni	Financimi	Afati
KEK, ME, ZRRE	KEK	2024
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Projekti është në proces të përgatitjes nga viti 2023.	Specifikimi teknik është përfunduar dhe është dorëzuar pranë Menaxhmentit të Lartë dhe Bordit. Në dhjetor të vitit 2024 është miratuar buxheti inicues për projektin e rehabilitimit dhe modernizimit të njësive A3. Inicimi i procesit nga Zyra e Prokurimit (ZP) është bërë më datë 23.01.2025.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	20%	0%
Sfidat dhe Rekomandimet		
<p>Në dhjetor 2024 është miratuar buxheti inicues për projektin e rehabilitimit dhe modernizimit të njësive A3. Inicimi i procesit nga Zyra e prokurimit është bërë më 23.01.2025.</p>		

**1.3.4. Veprimi: Makineri, shirita transportues, shpronësime dhe investime të tjera në shpronësimin e minierave**

Institucioni	Financimi	Afati
KEK, ME, ZRRE	KEK	2024
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Pjesërisht, shpronësimet u realizuan në vitin 2022 si pjesë e këtij projekti, ndërsa përgatitjet për makineri u shtynë në vitin 2023 për shkak të vështirësive në procesin e Prokurimit Publik.	Në kuadër të këtij projekti pjesërisht janë realizuar shpronësimet në vitin 2022 dhe përgatitjet për makineri janë zhvendosur edhe përgjatë vitit 2023 për shkak të vështirësive në Prokurimin Publik.	Nga njësitë inicuese të gjitha kërkesat që kanë arritur në DIP, janë proceduar për trajtim të metutjeshëm në DF dhe ZEP.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
30%	30%	8%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Deri në fund të Qershorit është pritur miratimi i PVZH , në ndërlidhje me shpronësim ,ndërsa aktivitetet tjera gjinden në faza të ndryshme të prokurimit.		

## 1.2.4 Garantimi i sigurisë kibernetike të sektorit të energjisë

Indikator sipas PZSEK: Aftësitë e reagimit kibernetik:

- nuk ka (2021),
- ekzistojnë (2025),
- ekzistojnë (2031).

Në tabelat e mëposhtme janë listuar veprimet për arritjen e objektivit specifik:

1.4.1. Miratimi i Ligjit për Sigurinë e Rrjeteve dhe Sistemeve Informative		
Institucioni	Financimi	Afati
MPB, ME	Buxheti i Kosovës	2025
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Gjatë vitit 2022 është hartuar draft ligji.	Në Programin Legjislativ për vitin 2022, ME kishte planifikuar hartimin e Projektligjit për Masat e Sigurisë së Rrjeteve dhe Sistemeve të Informacionit, ndërsa MPB kishte planifikuar Projektligjin për Sigurinë Kibernetike. Pas konsultimeve, u dakordua që ME të tërhiqet nga hartimi i projektligjit për Sigurinë e Rrjeteve, pasi Ligji nr. 08/L-173 për Sigurinë Kibernetike, i miratuar në shkurt 2023, përfshin të gjitha elementet e nevojshme për sigurimin e rrjeteve dhe sistemeve informative.	Ka përfunduar
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
70%	100%	100%
Sfidat dhe Rekomandimet		
N/A		

#### 1.4.2. Miratimi i akteve nënligjore që rrjedhin nga Ligji për Sigurinë e Rrjeteve dhe Sistemeve Informative

Institucioni	Financimi	Afati
MPB, ME, ZRRE, KOSTT	Buxheti i Kosovës	2025
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	MPB po harton aktet nënligjore për sigurinë kibernetike, që përcaktojnë masat minimale të sigurisë për operatorët e shërbimeve esenciale dhe ofruesit e shërbimeve digjitale.	Nuk ka progres
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	40%	0%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment nga institucionet përkatëse.		

#### 1.4.3. Themelimi i Ekipit Sektorial të Energjisë për Reagim ndaj Emergjencave Kompjuterike (eCERT) në Kosovë

Institucioni	Financimi	Afati
ME, CERTi nacional, MPB, ZRRE, KOSTT, KEK, KEDS	Buxheti i Kosovës, Donatorët	2025
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Termet e Referencës janë përpiluar dhe procesi i prokurimit do të fillojë në muajin shkurt.	Termet e referencës dhe specifikimet teknike për projektin e themelimit të CERT-it sektorial të energjisë janë përfunduar. Tani, pritet që Ministria e Ekonomisë (ME) të shpallë procesin e tenderimit për themelimin e eCERT.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	20%	5%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment nga institucionet përkatëse.		

### 1.3 Sfidat dhe rekomandimet e përgjithshme

Sfidat e përgjithshme në realizimin e përmbushjes së objektivit strategjik 1 dhe objektivave specifike:

- Realizimi i Objektivit Strategjik 1 është përballur me sfida të vazhdueshme strukturore dhe institucionale, të cilat kanë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në besueshmërinë e sistemit energjetik. Një nga sfidat kryesore lidhet me vonesat në ratifikimin e marrëveshjeve financiare, të cilat kanë shkaktuar shtyrje të konsiderueshme në realizimin e investimeve infrastrukturore në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes. Këto vonesa kanë ndikuar negativisht në zbatimin në kohë të projekteve kapitale të planifikuara dhe kanë kufizuar përmirësimin funksional të rrjetit, pavarësisht progresit të raportuar në aspektin procedural.
- Në këtë kontekst, vështirësitë e vazhdueshme të KEDS dhe KOSTT në sigurimin e qasjes në pronat e nevojshme për realizimin e projekteve infrastrukturore kanë përbërë një pengesë shtesë. Problemet pronësore kanë rezultuar në vonesa në energjizimin e linjave dhe nënstationeve të reja, duke kufizuar rritjen reale të kapaciteteve për bartjen dhe shpërndarjen e energjisë elektrike dhe duke zbehur ndikimin e investimeve të realizuara.
- Sfidamëkritike për besueshmërinë e sistemit mbetet procesi i rehabilitimit të kapaciteteve gjeneruese, veçanërisht i Termocentralit Kosova B. Përveç vonesave të shkaktuara nga procedurat e prokurimit dhe kompleksiteti teknik i ndërhyrjeve, gjendja jo-stabile e njësisë gjeneruese ka shkaktuar probleme të vazhdueshme operative dhe ka pamundësuar sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm me energji elektrike. Këto vonesa kanë thelluar gjithashtu ndikimet negative në mjedis dhe shëndet publik, duke rritur kostot ekonomike dhe sociale për vendin.
- Në lidhje me veprimin për hartimin e Master Planit të Zhvillimit të Gazit dhe Vlerësimit Strategjik Mjedisor<sup>10</sup>, sfida kryesore në fazën fillestare ka qenë mungesa e politikave të qarta për gazin, pasi Strategjia e Energjisë ishte ende në proces të hartimit. Edhe pse studimi është përfunduar, mbetet sfida mënyra se si gjetjet e tij do të interpretohen dhe integrohen në politikat energjetike, në një kontekst ku kapacitetet implementuese të institucioneve dhe afatet kohore të tranzicionit energjetik janë të kufizuara.

---

<sup>10</sup> Ministria e Ekonomisë (2023). *Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor*. Prishtinë. [https://me.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/01/Korniza\\_e\\_Investimeve\\_per\\_Ballkanin\\_\\_ALB.pdf](https://me.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/01/Korniza_e_Investimeve_per_Ballkanin__ALB.pdf)

## Rekomandimet e përgjithshme për realizimin e përbushjes së objektivit strategjik 1 dhe objektivave specifike:

- Përtë përmirësuar përbushjen e Objektivit Strategjik 1, rekomandohet forcimi i koordinimit ndërinstucional dhe adresimi i pengesave strukturore që po vonojnë investimet infrastrukturore në rrjet. Përshpejtimi i procedurave të ratifikimit të marrëveshjeve financiare dhe zgjidhja e çështjeve pronësore duhet të trajtohen si prioritete, në mënyrë që investimet në transmetim dhe shpërndarje të reflektohen në përmirësime reale të besueshmërisë së sistemit.
- Rehabilitimi i Termocentralit Kosova B duhet të trajtohet si prioritet strategjik, duke ndërmarrë ndërhyrje të menjëhershme për adresimin e shkëlqeve serioze të kufijve ligjorë të ndotjes (pluhur, NO<sub>x</sub>, SO<sub>2</sub>) dhe për sigurimin e përputhshmërisë së plotë me standardet mjedisore të Bashkimit Evropian. Çdo vazhdim i operimit pa sisteme funksionale të filtrimit dhe monitorimit të ndotjes nuk do të ishte i pranueshëm dhe, në raste të tilla, duhet të shqyrtohet alternativa e mbylljes graduale, por jo zgjatja e jetës operative pa përbushje të standardeve.
- Procesi i mbylljes graduale të Termocentralit Kosova A duhet të trajtohet me planifikim të qartë, transparencë dhe vlerësim të ndikimeve në sigurinë e furnizimit, në mënyrë që të shmangen skenarët që zgjatin varësinë nga qymyri ose krijojnë rrezik për mospërbushje të objektivave të tranzicionit energjetik.
- Në lidhje me studimin për zhvillimin e gazit dhe Vlerësimin Strategjik Mjedisor, Balkan Green Foundation vlerëson se çdo interpretim ose ndjekje e rekomandimeve të tij duhet të shoqërohet me transparencë të plotë, përfshirje të shoqërisë civile dhe informim të drejtë të publikut. Duke marrë parasysh kapacitetet aktuale implementuese të institucioneve dhe sfidat e vazhdueshme në sektorin e energjisë, çdo qasje që e trajton gazin si zgjidhje tranzitore duhet të vlerësohet me kujdes, përmes analizës së skenarëve, kostos totale, afateve të realizimit dhe përputhshmërisë me objektivat e dekarbonizimit, në mënyrë që të shmangët rreziku i “lock-in” në infrastrukturë fosile dhe shtyrja e daljes nga qymyri.

---

**Objektivi Strategjik II:  
Dekarbonizimi dhe promovimi  
i energjisë së ripërtëritshme**

## 2. Objektivi Strategjik II: Dekarbonizimi dhe promovimi i energjisë së ripërtëritshme

Dekarbonizimi i sektorit të energjisë dhe promovimi i burimeve të ripërtëritshme përbëjnë boshtin kryesor të transformimit afatgjatë të sistemit energjetik të Kosovës dhe janë të lidhura drejtpërdrejt me përmbushjen e objektivave klimatike, integrimin evropian dhe konkurrueshmërinë ekonomike të vendit. Për një ekonomi që mbështetet ende në mënyrë dominuese në prodhimin e energjisë nga qymyri, ky objektivi nuk përfaqëson vetëm një angazhim mjedisor, por një domosdoshmëri strategjike për të shmangur rritjen e kostove të karbonit, ekspozimin ndaj mekanizmave si CBAM dhe rrezikun e mbetjes jashtë politikave dhe tregjeve energjetike të Bashkimit Evropian. Në këtë kontekst, zhvillimi i energjisë së ripërtëritshme dhe ulja graduale e varësisë nga lëndët djegëse fosile kërkojnë jo vetëm kornizë të përshtatshme ligjore dhe plane strategjike, por edhe kapacitete reale implementuese, investime të qëndrueshme dhe koordinim të qartë institucional. Vlerësimi i këtij objektivi synon të analizojë nëse progresi i raportuar po përkthehet në rezultate të prekshme në rritjen e kapaciteteve të pastra dhe në uljen e varësisë nga lëndët djegëse fosile, apo nëse mbetet kryesisht i përqendruar në masa procedurale dhe përgatitore.

- Objektivi Strategjik II vlerësohet kryesisht përmes dy treguesve:
- (i) reduktimit të emetimeve të gazeve serrë (GS) në sektorin e energjisë elektrike krahasuar me vitin bazë 2019; dhe
- (ii) rritjes së pjesëmarrjes së burimeve të ripërtëritshme në konsumin e energjisë elektrike.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur caqet që ka vendosur Strategjia e Energjisë për reduktimin e emetimit të GS në sektorin e energjisë dhe pjesëmarrjes së burimeve të ripërtëritshme në konsumin e sektorit të energjisë elektrike.

*Tabela 5. Caqet për reduktimin e emetimit të GS në sektorin e energjisë dhe pjesëmarrjes së burimeve të ripërtëritshme në konsumin e sektorit të energjisë elektrike.*

Nr.	Objektivat strategjike dhe specifike, treguesit dhe veprimet	Vlera bazë	Objektivi afatshkurtër 2025	Objektivi i vitit të fundit 2031
<b>II. OBJEKTIVI STRATEGJIK 2: DEKARBONIZIMI DHE PROMOVIMI I ENERGJISË SË RIPËRTËRITSHME</b>				
1	Reduktimi i emetimit të GS në sektorin e energjisë elektrike krahasuar me 2019	0% [2019] (6316 ktCO <sub>2</sub> )	0%	-32%
2	Pjesëmarrja e burimeve të ripërtëritshme në konsumin e sektorit të energjisë elektrike (BRE E)	6.3% [2021]	Minimum 13%	Minimum 13%

Objektivat specifike për dekarbonizim dhe promovimin e energjisë së ripërtëritshme:


1. Zbatimi gradual i çmimit të karbonit;
2. Promovimi i energjisë së ripërtëritshme në konsumin e energjisë elektrike;
3. Promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të energjisë së ripërtëritshme për ngrohje.

Secili prej këtyre objektivave ka të caktuar veprimet e ndërmarra për përmbushjen e tyre. Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm është paraqitur përmbushja e secilit objektiv specifik, dhe poashtu mesatarja e përmbushjes së objektivit strategjik duke u bazuar në përmbushjen e objektivave specifike.

*Tabela 6. Përqindja totale e realizuar për objektivin strategjik për vitet 2022-2024.*

Nr.	Objektivi Specifik	% e realizimit
1	Zbatimi gradual i çmimit të karbonit	50%
2	Promovimi i energjisë së ripërtëritshme në konsumin e energjisë elektrike	52.2%
3	Promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të energjisë së ripërtëritshme për ngrohje	100%
<b>Përqindja e realizimit të objektivit strategjik</b>		<b>67.4%</b>

**Grafiku 3. Realizimi i objektivave specifike për dekarbonizimin dhe promovimin e energjisë së ripërtëritshme.**



Nga tabela e përqindjeve dhe grafiku shohim se veprimet për promovimin e përdorimit të burimeve të ripërtëritshme për ngrohje kanë rezultuar mirë, por veprimet për aplikimin e çmimit të karbonit dhe promovimin e energjisë së ripërtëritshme kanë rezultuar me përmbushje respektivisht prej 50% dhe 52.2%. Më poshtë gjendet komentimi i realizimit të objektivave specifike duke marrë parasysh rrethanat dhe duke analizuar ngeçjet në realizimin e tyre.

Poashtu në tabelën e mëposhtme është paraqitur niveli i përmbushjes së veprimeve, përfshirë ato të përfunduara tërësisht dhe ato që janë përfunduar mbi 50% për vitin 2024:

**Tabela 7. Niveli i përmbushjes së veprimeve të objektivave specifike deri në vitin 2024.**

Nr.	Objektivi Specifik	Veprime të pazbatuara deri në 2024	Veprimet e realizuara nën 50% deri në 2024	Veprimet e realizuara mbi 50% deri në 2024	Veprime të realizuara 100% deri në 2024	Veprime të planifikuara pas vitit 2024	Gjithsej veprimet 2022-2025
1	Zbatimi gradual i çmimit të karbonit	1	0	0	1	2	4
2	Promovimi i energjisë së ripërtëritshme në konsumin e energjisë elektrike	1	3	1	5	4	14
3	Promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të energjisë së ripërtëritshme për ngrohje	0	0	0	2	1	3
	<b>Gjithsej veprimet e objektivit strategjik II</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>1</b>	<b>8</b>	<b>7</b>	<b>21</b>

## 2.1 Komentim mbi përmbushjen e objektivave specifike

Të tre objektivat specifike nën Objektivin Strategjik II shënojnë realizim mbi 50% deri në fund të vitit 2024, sipas metodologjisë së raportimit të PZSEK. Megjithatë, rëndësia e tyre në dekarbonizim ndryshon ndjeshëm: progresi procedural në disa masa nuk përkthehet domosdoshmërisht në rritje të menjëhershme të kapaciteteve të reja gjeneruese ose në ulje të emetimeve në sektorin e energjisë elektrike.

Ndërkohë që objektivat që lidhen me përdorimin e burimeve të ripërtëritshme për ngrohje rezultojnë me përqindje më të larta realizimi, mungesa e progresit të mjaftueshëm në prodhimin e energjisë elektrike nga burime të ripërtëritshme krijon një mospërputhje me strukturën reale të konsumit në Kosovë, ku një pjesë e madhe e kërkesës për ngrohje mbulohet përmes energjisë elektrike.

Një pengesë strukturore në zbatimin e Objektivit Strategjik II mbetet stagnimi i disa proceseve kyçe që janë thelbësore për përshpejtimin e dekarbonizimit dhe zhvillimin e energjisë së ripërtëritshme. Vonesa të theksuara janë evidentuar në projektet e KEK-ut për energji fotovoltaike, si dhe në projektet për ngrohje diellore termike, të cilat shënojnë progres të ulët gjatë vitit 2024. Këto projekte kanë rëndësi të veçantë strategjike, pasi ndërtimi i kapacitetit prej 100 MW nga energjia solare jo vetëm që do të shtonte një sasi të konsiderueshme të energjisë së ripërtëritshme në miqsin energjetik të Kosovës, por do të përfaqësonte edhe hapin e parë konkret drejt tranzicionit të KEK-ut nga prodhimi me qymyr drejt burimeve të pastra. Në mënyrë të ngjashme, zhvillimi i sistemeve të ngrohjes duke përdorur energjinë solare përbën hapin e parë drejt tranzicionit të Termokos-it drejt energjisë së pastër, ndërkohë që vonesat aktuale rrezikojnë shtyrjen e këtij procesi.

Edhe pse Ligji për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë është miratuar, mungesa e miratimit të plotë të akteve nënligjore që rrjedhin nga ky ligj vazhdon të kufizojë zbatimin praktik të tij. Kjo vonesë ka ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e projekteve të reja të energjisë së ripërtëritshme dhe në demokratizimin e sektorit energjetik, përfshirë zhvillimin e komuniteteve të energjisë dhe rritjen e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve dhe aktorëve lokalë në tranzicionin energjetik.

Një pengesë shtesë lidhet me mungesën e progresit gjatë vitit 2024 në studimin e fizibilitetit për identifikimin e tokave publike të përshtatshme për zhvillimin e projekteve diellore dhe të erës. Kjo vonesë krijon pasoja të drejtpërdrejta në procesin e ankandëve të energjisë, pasi këto ankande mbështeten kryesisht në përdorimin e tokave publike dhe kërkojnë planifikim të qartë hapësinor dhe institucional.

Të gjitha këto ngecje janë të ndërlidhura në mënyrë zinxhimore, ku stagnimi i një procesi ndikon drejtpërdrejt në përmbushjen e proceseve të tjera. Në këtë kuadër, një zhvillim pozitiv dhe i rëndësishëm gjatë vitit 2024 është miratimi i Rregullores për Prosumatorë, e cila krijon mundësi konkrete për konsumatorët rezidencialë dhe komercialë që të investojnë në kapacitete të energjisë së ripërtëritshme për vetë-konsum dhe për shkëmbim të energjisë me rrjetin elektrik. Futja e prosumatorëve në tregun e energjisë fuqizon rolin e konsumatorëve dhe kontribuon në rritjen e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme.

Në fund, mungesa e progresit në zbatimin gradual të çmimit të karbonit, për shkak të mosprocedimit të draftit të Strategjisë Afatgjatë të Dekarbonizimit, mbetet një pengesë strukturore për orientimin afatgjatë të zhvillimit ekonomik të Kosovës. Çmimi i karbonit nuk përfaqëson vetëm një instrument mjedisor, por një mekanizëm kyç për ristrukturimin e ekonomisë, rritjen e konkurrueshmërisë dhe përafrimin me politikat e Bashkimit Evropian. Në mungesë të sinjaleve të qarta ekonomike për emetimet, sektori i energjisë dhe sektori privat vazhdojnë të operojnë pa stimuj të mjaftueshëm për investime në teknologji të pastra, duke rrezikuar përballueshmërinë afatmesme të ekonomisë së Kosovës në kontekstin e tregjeve evropiane dhe mekanizmave si CBAM.

## 2.2. Përbushja e veprimeve të objektivave specifike

### 2.2.1 Zbatimi gradual i çmimit të karbonit

Indikator sipas PZSEK: Futja graduale e çmimit të karbonit:

- Nuk është prezantuar (2021),
- Ka përfunduar përgatitja e një sistemi të caktimit të çmimit të karbonit (2025),
- Integrimi në STE-në e BE-së (2031).

Në tabelat e mëposhtme janë listuar veprimet për arritjen e objektivit specifik:

2.1.1. Veprimi: Hartimi i Strategjisë Afatgjate të dekarbonizimit		
Institucioni	Financimi	Afati
MMPHI	Buxheti i Kosovës	2024
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Është hartuar një draft i Strategjisë Afatgjate të dekarbonizimit.	Nuk ka progres.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	40%	0%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment nga institucioni përkatës		

**2.1.2. Veprimi: Transpozimi dhe zbatimi i MRR (BE) 2018/2066, AVR (EU) 2018/2067, dhe rregulloreve AR (KE) 765/2008**

Institucioni	Financimi	Afati
MMPHI	Buxheti i Kosovës	2025
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Nuk ka progres	Nuk ka progres.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	0%	0%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment nga institucioni përkatës		

**2.1.3. Veprimi: Ngritja e infrastrukturës mbështetëse dhe sistemit të qeverisjes**

Institucioni	Financimi	Afati
ME, MMPHI	Buxheti i Kosovës	2025
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Nuk ka progres	Nuk ka progres.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	0%	0%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment nga institucionet përkatëse		

**2.1.4. Veprimi: Studimi i ndikimit të çmimit të karbonit**

Institucioni	Financimi	Afati
MMPHI	FMN	2024-2025
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Nuk ka progres	Ka përfunduar
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	0%	100%
Sfidat dhe Rekomandimet		
N/A		

## 2.2.2 Promovimi i energjisë së ripërtëritshme në konsumin e energjisë elektrike

Indikatori sipas PZSEK: Futja graduale e çmimit të karbonit:

- Kapacitetet totale të ripërtëritshme në sektorin e energjisë elektrike (përfshirë prodhuesit vetë-konsumues)
  - o 279 MW (2021),
  - o 490 MW (2025),
  - o 1600 MW (2031).
- Kapaciteti i prodhuesve vetë-konsumues (prosumatorët):
  - o 2 MW (2021),
  - o 30 MW (2025),
  - o Minimum 100 MW (2031).

Në tabelat e mëposhtme janë listuar veprimet për arritjen e objektivit specifik:

2.2.1. Veprimi: Hartimi i ligjit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë		
Institucioni	Financimi	Afati
ME	ME, Donatorët	2023
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Grupi punues është formuar dhe ka përgatitur një draft, i cili ka kaluar gjithashtu procedurën e diskutimit publik.	Ligji nr. 01/164 për Promovimin e shfrytëzimit të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë është miratuar nga Qeveria e Kosovës më 9 tetor 2023. Për momentin gjendet në Parlament për shqyrtim dhe miratim (për lexim të dytë).	Ligji Nr. 08/L-258 për Promovimin e Përdorimit të BRE-ve është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe është publikuar në Gazetën Zyrtare (GZ), më datë: 02.05.2024.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
70%	90%	100%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Një sfidë në realizimin e këtij veprimi ka qenë që Ligji për promovimin e përdorimit të BRE-eve është hartuar për herë të parë në Kosovë dhe, si i tillë, ka kërkuar kujdes të veçantë në çdo fazë të draftimit. Për këtë ligj, janë marrë komente nga shumë institucione, të cilat kërkuan kohë të konsiderueshme për shqyrtim dhe diskutim.		

2.2.2. Veprimi: Miratimi i akteve nënligjore lidhur me ligjin për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë		
Institucioni	Financimi	Afati
ME, ZRRE	Donatorët	2024
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Janë miratuar: -Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2023 për promovimin e shfrytëzimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme; -Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2023 për cakun e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë.	Pas miratimit të Ligjit Nr. 08/L-258 për Promovimin e Përdorimit të BRE-ve dhe të Planit Legjislativ të ME-së, janë caktuar zyrtarët përgjegjës për secilin nga tetë (8) draft-aktet nënligjore. Deri tani, është miratuar vetëm Udhëzimi Administrativ (UA) për Procesin e Ofertimit Konkurrues, ndërsa katër (4) Udhëzime Administrative (UA) të tjera janë në fazën e draftimit dhe presin të dërgohen për konsultim paraprak dhe publik. Tre (3) Udhëzime Administrative (UA) ende nuk janë draftuar.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	50%	30%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment nga institucionet përkatëse		

2.2.3. Veprimi: Hartimi i legjislacionit sekondar për prosumatorët		
Institucioni	Financimi	Afati
ZRRE	Donatorët	2023
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Draftti i parë është hartuar në vitin 2022.	Gjatë vitit 2023, kjo rregullore i është nënshtruar konsultimit Publik. Pas marrjes së komenteve dhe shqyrtimit të tyre është miratuar nga Bordi i ZRRE.	Ka përfunduar
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
70%	100%	100%
Sfidat dhe Rekomandimet		
N/A		

2.2.4. Veprimi: Finalizimi i metodologjisë së taksës së kyçjes së OSSH-së		
Institucioni	Financimi	Afati
ZRRE, OSSH	ZRRE	2023
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
KEDS ka dorëzuar metodologjinë në vitin 2022	Në vitin 2023, ZRRE-ja e ka vendosur metodologjinë në konsultim publik. Pas shqyrtimit të komenteve nga palët e interesit, ajo është miratuar nga Bordi i ZRRE-së.	Ka përfunduar
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
70%	100%	100%
Sfidat dhe Rekomandimet		
N/A		

2.2.5. Veprimi: Hartimi i Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë 2025-2030		
Institucioni	Financimi	Afati
MMPHI, ME	GIZ	2024
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Drafti i Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë 2025-2030 është hartuar në 70%. Dokumenti është dërguar për komentim në Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, i cili ka dërguar komentet më 29 dhjetor 2023. Grupi punues është duke i trajtuar komentet dhe finalizuar dimensionet. Po ashtu, është përgatitur edhe Vlerësimi Strategjik Mjedisor për PKEK.	Diskutimi paraprak i dokumentit ka përfunduar, aktualisht është në fazën e shqyrtimit të komenteve dhe pritët të dërgohet për diskutim publik.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	70%	50%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment nga institucionet përkatëse		

2.2.6. Veprimi:Njoftimi për pilot-ankandin e parë		
Institucioni	Financimi	Afati
ME, ZRRE	Buxheti i Kosovës	2023
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Grupi punues është formuar për të hartuar dizajnimin e skemës konkurruese për burimet e ripërtritshme të energjisë. Lokacioni është siguruar në bashkëpunim me institucionet përkatëse dhe Komunën e Rahovecit.	Ankandi është shpallur me 12 maj 2023.	Ka përfunduar
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
100%	100%	100%
Sfidat dhe Rekomandimet		
N/A		

2.2.7. Veprimi:Dhënia dhe kontraktimi i ankandit të parë pilot		
Institucioni	Financimi	Afati
ME, ZRRE	Buxheti i Kosovës	2023
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Shtyrja e ankandit të energjisë solare ka ndodhur për shkak të kërkesave të shumicës së investitorëve për më shumë kohë përgatitjeje, duke e zgjatur afatin për dorëzimin e ofertave deri më 31 janar 2024.	Ka përfunduar
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	0%	100%
Sfidat dhe Rekomandimet		
N/A		

2.2.8. Veprimi: Ndërtimi i kapaciteteve prej 100 MW		
Institucioni	Financimi	Afati
ME, ZRRE	Investime private	2025
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Nuk ka progres	Më 29 mars 2024 u shpall fituesi i ankandit dhe më 31 maj 2024 u nënshkruan marrëveshjet për zhvillimin e projektit. Fituesi do të përmbyllë financimin brenda një viti dhe do ta lëshojë centralin solar në funksion brenda dy viteve.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	0%	40%
Sfidat dhe Rekomandimet		
<p>Si sfidë në realizimin me kohë të këtij veprimi, ka qenë hera e parë që Kosova ka organizuar një proces konkurrues - ankand për blerje të energjisë diellore - Fotovoltaike (FV). Investitorët kanë parashtruar pyetje të ndryshme rreth dosjes së tenderit si dhe kanë kërkuar kohë shtesë në mënyrë që të jenë sa më të përgatitur për procesin konkurrues.</p>		

2.2.9. Veprimi: Themelimi i njësisë për zhvillimin e kapaciteteve të BRE		
Institucioni	Financimi	Afati
ME	Buxheti i Kosovës	2024
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Njësia për Implementimin e Projekteve nga BRE është krijuar si njësi në nivel të Departamentit, në përputhje me Rregulloren Nr. 04/2023 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Ekonomisë (Zyra Ligjore).	Njësia për Implementimin e Projekteve të BRE-ve është themeluar me miratimin e rregullores së brendshme të ME-së në mars 2023 dhe është bartur në njësi nga Departamenti i Energjisë në shkurt 2024. Në dhjetor 2024, është zgjedhur udhëheqësja e Njësisë dhe është rekrutuar udhëheqësi i Divizionit për Mbështetje Administrative të Projekteve të BRE-ve. Rekrutimi i udhëheqësit të Divizionit për Mbështetje Teknike është ende në proces.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	100%	22%
Sfidat dhe Rekomandimet		
<p>Sfidë është përcaktimi jo adekuat i pozitave profesionale ne kuadër te rregullores së brendshme te Ministrisë, të cilat pritet të rregullohen me ndryshim-plotësim të rregullores.</p>		

2.2.10. Veprimi: Ndërtimi i centralit diellor 100 MW në KEK		
Institucioni	Financimi	Afati
KEK	10,000,000 EUR KEK, Donacion nga KfW, EIB	2025
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Në vitin 2023, është realizuar procesi i tenderimit për zgjedhjen e kompanisë që do të përgatisë dosjen e tenderit për ndërtimin e parkut solar.	Marrëveshja për nën huazim të kreditit dhe grantit me Ministrinë e Financave është nënshkruar në gusht 2024. Në tetor 2024, është përzgjedhur kompania konsulente për përgatitjen e dosjes së tenderit dhe mbikëqyrjen e implementimit të projektit.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	20%	10%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Sipas planifikimit të raportuar, inicimi i tenderimit pritet në prill 2025, ndërsa vënia në operim është planifikuar për tetor 2027. Kjo krijon mospërputhje me afatin e PZSEK (2025) dhe sugjeron nevojë për rishikim të planit të zbatimit ose për përcaktim të qartë të fazave (tenderim/ndërtim/operim) në raportimin institucional.		

2.2.11. Veprimi: Studimi i fizibilitetit për identifikimin e tokave publike të përshtatshme për FV dhe erë (faza e tretë)		
Institucioni	Financimi	Afati
ME, MMPHI	Komisioni Evropian	2023
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Afati për finalizimin e projektit është shtyrë deri në vitin 2024, për shkak të vonesave në mbledhjen e të dhënave nga institucionet relevante, duke rezultuar në shtyrjen e survejimit me dronë të lokacioneve të studiuara.	Nuk ka progres
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	0%	0%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment nga institucionet përkatëse.		

2.2.12. Veprimi: Puna përgatitore për fillimin e ankandit të dytë specifik teknologjik		
Institucioni	Financimi	Afati
ME	ME, Donatorët	2023-2024
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Ministria e Ekonomisë, me mbështetje nga USAID, ka nisur përgatitjen e propozimit për ankandin e energjisë nga era, duke shqyrtuar mundësinë e përdorimit të fondeve nga FMN për të bashkëinvestuar në këtë projekt përmes partneriteteve publiko-private (PPP).	Qeveria, me mbështetjen e IFC dhe USAID, ka nisur në 2024 dy ankande konkurruese për 150 MW kapacitet erë (rreth 75 MW secili) nën skemën PPP. Pas kërkesës së ME-së më 23.04.2024, ZRrE vendosi më 31.05.2024 të mos aplikojë procedurën standard të autorizimit. Më 10.07.2024 u autorizua fillimi i tenderimit, e më 21.11.2024 u miratua procesi konkurrues. Në dhjetor 2024 u hap ankandi i parë për 100 MW, dhe tani po pranohen ofertat: 15 kompani kanë akses në dhomën virtuale të të dhënave dhe pyetjet e tyre po trajtohen me mbështetje të IFC-së.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	20%	20%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment nga institucioni përkatës.		

2.2.13. Veprimi: Mbështetje për kapacitetet gjeneruese të erës, përfshirë përgatitjen teknike të projekteve specifike		
Institucioni	Financimi	Afati
Donatorët	Donatorët	2025
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Banka Botërore ka aplikuar pa sukses për fonde asistence teknike nga Trust Fund, ndaj aktualisht vetëm eksperti individual i erës i Bankës Botërore asiston Ministrinë e Ekonomisë në zhvillimin e ankandëve në toka publike.	Në dhjetor 2024, ME me mbështetje të IFC dhe USAID lançoi ankandin e parë të erës 100 MW. Gjatë 2024, eksperti i Bankës Botërore analizoi katër lokacione për studim të mëtejshëm - Gjakovë, Kukavicë, Koshutovë dhe Kamenicë. Për Gjakovën u identifikuan parcelat publike bazuar në të dhënat kadastrale të komunës dhe AKK, poligoni u verifikua nga Agjencia e Pyjeve për mungesë kontratash me investitorë privatë, dhe KPMM-ja u njoftua për planet e ME-së.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	0%	40%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Sfida kryesore gjatë këtij studimi ka qenë pagesa të AKK për marrjen e ortofotove dhe të dhënave grafike të lokacionit, si dhe përfshirja e shumë aktorëve për sigurimin e informacionit pronësor. Një vështirësi shtesë ishte identifikimi i pronësisë për disa parcela specifike me numra unikë, që kërkoj bashkëpunim intensiv dhe hulumtim të detajuar me AKK-në dhe Kadastrin e Gjakovës.		

**2.2.14. Veprimi: Promovimi dhe lehtësimi i integrimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe praktikave të efikasitetit të energjisë**

Institucioni	Financimi	Afati
ME,FKEE,MMPHI	Lux Dev	2026
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Marrëveshja dypalëshe ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut për projektin e bashkëpunimit "KSV/024: Tranzicioni i Energjisë dhe Zbutja e Ndryshimeve Klimatike në Kosovë" është nënshkruar më 10 nëntor 2023.	Nëntor 2023, u nënshkrua Marrëveshja Bilaterale për projektin "KSV/024: Tranzicioni Energjetik dhe Zbutja e Klimës në Kosovë" ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut, i zbatuar nga Lux Dev. Gjatë vitit 2024, janë arritur disa rezultate kryesore: 1. Forcimi Institucional dhe Korniza Rregullative: Ofrimi i ekspertizës teknike dhe ligjore për krijimin e Njesisë së Zbatimit të Projektit (PIU) dhe mbështetje për zhvillimin e kornizës ligjore, duke tejkaluar objektivin për kapacitetin e energjisë së ripërtëritshme; Lehtësimi i krijimit të dhomës së inxhinierëve dhe licencimi i mbi 800 inxhinierëve deri në fund të vitit 2024. 2. Zhvillimi i Fondit Kosovar për Efiçencën e Energjisë (FKEE): Hartimi i Planit të Biznesit për FKEE për periudhën 2025-2027, duke përcaktuar prioritetet strategjike për zgjerimin dhe integrimin e digjitalizimit.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	20%	60%

**Sfidat dhe Rekomandimet**

Sfidat e konsideruara nga institucioni përkatës përfshijnë:  
 Vonesat në Zbatimin e Skemës: Disa masa për efiçencën e energjisë kanë pasur vonesa për shkak të kompleksitetit të mjedisit rregullator dhe koordinimit ndërmjet aktorëve, duke kërkuar përpjekje të vazhdueshme për përmirësim. Qëndrueshmëria Financiare e FKEE: FKEE ka sfida në arritjen e qëndrueshmërisë financiare për shkak të kapacitetit të kufizuar të gjenerimit të të ardhurave dhe rreziqeve për ruajtjen e kapitalit, duke u fokusuar në funksionimin pa financim të jashtëm në vitin 2025.  
 Përshtatjet Legjislative dhe Rregullatore: Disa përpjekje janë bërë për të harmonizuar ligjin me standardet e BE-së, por ndryshimet e mundshme mund të ndikojnë në shpejtësinë e zbatimit.  
 Sfidat e Tregut për Energjinë e Ripërtëritshme: Angazhimi i sektorit privat dhe investimet në energjinë e ripërtëritshme mbeten sfida, duke u ndikuar nga çmimet globale dhe kushtet ekonomike.  
 Sfidat e Ngritjes së Kapaciteteve dhe Trajnimit: Sigurimi i profesionistëve të aftë për energjinë e rinovueshme dhe efiçencën e energjisë është kyç, por ka sfida në shkallëzimin e trajnimeve dhe certifikimeve.

## 2.2.3 Promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të energjisë së ripërtëritshme për ngrohje

Indikator sipas PZSEK: Kapaciteti i instaluar i BRE-ve në sistemet e ngrohjes qendrore: baza 15 MWth, (2025) minimum 65 MWth, (2031) të pëtcaktohet nga studimi i fizibilitetit.

Në tabelat e mëposhtme janë listuar veprimet për arritjen e objektivit specifik:

2.3.1. Veprimi: Studimi i fizibilitetit & Vlerësimi i ndikimit mjedisor dhe social (VNMS) për sistemet e ngrohjesqendrore në 9 komuna të Kosovës (Gjilan, Ferizaj, Prizren, Pejë, Drenas, Obiliq, Mitrovicë Veriore dhe Jugore & Zveçan)		
Institucioni	Financimi	Afati
ME, MMPHI, Komunat, MFPT	WBIF/IPF10	2023
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nga tetori 2021 deri në shkurt 2024, për shkak të zgjedhjeve lokale, vizitat në terren u shtynë deri në vitin 2022, duke përfshirë 7 komuna, përveç Mitrovicës së Veriut dhe Zveçanit. Për mbledhjen e të dhënave për ndërtesat banimi në 9 komuna, asistenca teknike hap tender, por raundi i parë nuk kishte kompani të paraqitura. Tenderi u rilansua në janar 2022 dhe në mars u shpall fituesi, por puna filloi në qershor 2022 për shkak të formaliteteve. Vështirësitë në komunikim me komunat veriore dhe ndërrimi i shpejtë i situatës në ndërtim kërkuan rishikime të detajuara dhe korrigjime për 74,000 ndërtesa. Aktiviteti vazhdon dhe raportet janë dorëzuar, me përfundimin e studimit dhe vlerësimin të pritur deri në K2 2024.	Studimi dhe VNMS pritet të përfundojnë deri në K2 2024	Më 30 maj 2024, u mbajt takimi i 5-të i Komitetit Drejtues, ku u prezantua puna finale e konsulencës lidhur me studimin dhe u zhvilluan diskutime. Jemi në pritje të pranimit të studimit të finalizuar me përkthimet e kërkuara, ndërkohë që Studimi dhe Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) është finalizuar.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
30%	30%	100%
Sfidat dhe Rekomandimet		
N/A		

**2.3.2. Veprimi: Solar4Kosovo – Studimi i fizibilitetit për zhvillimin e Projektit për ngrohje qendrore diellore**

Institucioni	Financimi	Afati
Termokos	KfW, EBRD	2024
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Studimi i fizibilitetit ka përfunduar. Projekti VNMS (Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social) është në fazën finale. Është përcaktuar dhe miratuar lokacioni prej 25 ha tokë për projektin, i cili ndodhet në zonën Hade e Re. Ka nisur procedura për parakualifikim për zgjedhjen e kompanisë konsulente për projektin.	Gjatë vitit 2023, për projektin "Solar4 Kosova II" për ndërtimin e impiantit të energjisë diellore për ngrohje qendrore, janë realizuar këto aktivitete: Ka përfunduar studimi i fizibilitetit dhe projekti VNMS (Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social). Është përzgjedhur kompania konsulente "iC consulenten" nga Vjena. Është nënshkruar marrëveshja ndërmjet Termokosit dhe Ministrisë së Financave, duke krijuar kushtet për nënshkrimin e kontratës me kompaninë konsulente në janar 2024. Kanë vazhduar konsultimet për përgatitjen e dokumentacionit për lejen mjedisore dhe shpronësim.	Projekti për ndërtimin e impiantit termik diellor dhe integrimin në sistemin ekzistues të ngrohjes qendrore (deri në 50 MWTH) ka shënuar këto zhvillime kryesore: Ka përfunduar studimi i fizibilitetit dhe projekti VNMS. Është përcaktuar lokacioni prej 25 ha në Hade e Re. Është nënshkruar kontrata me kompaninë konsulente iC-CES në janar 2024. Është aplikuar për pëlqime teknike nga KEDS dhe KRU Prishtina. Është aprovuar PPR dhe masterplani për zgjerimin e rrjetit. Janë aplikuar kushtet për shpronësim dhe identifikimin e parcelave. KfW ka aprovuar Termat e Referencës për tenderin e parakualifikimit. Është angazhuar kompani për elaboratin e shpronësimit, i dorëzuar në MFPT.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
70%	80%	100%
Sfidat dhe Rekomandimet		
<p>Sfidat kryesore:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kompletimi i dokumentacionit për shpronësim të trasesë në koridorët A dhe B;</li> <li>2. Prania e linjave të tensionit të lartë në lokacionin e impiantit;</li> <li>3. Nevoja për zhvendosjen e 9 varrezave në një lokacion të ri;</li> <li>4. Marrja e pëlqimit mjedisor dhe lejes ndërtimore;</li> <li>5. Ndërtimi i unazës së Prishtinës afër impiantit;</li> <li>6. Ndryshime në kadastër dhe investime të reja në Obiliq përgjatë koridorit B.</li> </ol> <p>Rekomandime: Theksohet nevoja për bashkëpunim të ngushtë me KEK, MFPT, MMPHI, KRU Prishtina, KOSTT/KEDS dhe komunat e Prishtinës dhe Obiliqit për çështjet teknike, mjedisore dhe pronësore.</p>		

**2.3.3. Veprimi: Ndërtimi i Projektit për ngrohje qendrore diellore – Solar4Kosovo**

Institucioni	Financimi	Afati
Termokos	KfW, EBRD, WBIF, Kontributi Kombëtar	2027
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Nuk ka progres	Nuk ka progres
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	0%	0%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka filluar ende realizimi i projektit.		

## 2.3. Sfidat dhe rekomandimet e përgjithshme

Sfidat e përgjithshme në realizimin e përmbushjes së objektivit strategjik 2 dhe objektivave specifike:

- Realizimi i Objektivit Strategjik 2 për dekarbonizimin dhe promovimin e energjisë së ripërtëritshme është përballur me një sërë sfidash strukturore dhe institucionale, të cilat kanë kufizuar përkthimin e progresit procedural në rezultate konkrete në terren. Një nga sfidat kryesore mbetet mungesa e progresit në implementimin e çmimit të karbonit, si pasojë e mosfinalizimit të Strategjisë Afatgjatë për Dekarbonizim. Mungesa e këtij instrumenti ekonomik ka kufizuar krijimin e sinjaleve të qarta të tregut për orientimin e investimeve drejt teknologjive të pastra dhe ka dobësuar lidhjen ndërmjet politikave klimatike dhe zhvillimit ekonomik.
- Një pengesë tjetër e rëndësishme lidhet me mungesën e miratimit të plotë të akteve nënligjore për promovimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë. Kjo ka ndikuar negativisht jo vetëm në zhvillimin e projekteve të reja të energjisë së ripërtëritshme, por edhe në krijimin e komuniteteve të energjisë, të cilat përfaqësojnë një mekanizëm kyç për demokratizimin e sektorit energjetik dhe tashmë janë praktikë e aplikuar në disa vende të Ballkanit Perëndimor. Në mungesë të një kornize funksionale nënligjore, pjesëmarrja aktive e qytetarëve, bizneseve të vogla dhe komunave në tranzicionin energjetik mbetet e kufizuar.
- Strategjia e Energjisë ka përcaktuar ankandet e energjisë si mekanizmin kryesor për rritjen e gjenerimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme. Megjithatë, realizimi i këtyre ankandeve është përballur me sfida të konsiderueshme, veçanërisht për shkak të vonesave procedurale dhe mungesës së përgatitjes së tokave publike të përshtatshme për implementimin e projekteve. Këto vonesa kanë ndikuar drejtpërdrejt në ritmin e shtimit të kapaciteteve të reja të energjisë së ripërtëritshme.
- Në këtë kontekst, projekti fotovoltaik prej 100 MW në kuadër të Korporatës Energjetike të Kosovës shënon progres të ulët, pavarësisht se viti 2025 është përcaktuar si afat i fundit për realizimin e tij. Deri në periudhën e monitoruar, procesi i tenderimit për ndërtimin e këtij sistemi fotovoltaik nuk ka filluar, duke rritur rrezikun që projekti të mos realizohet brenda afateve të përcaktuara dhe të humbasë rolin e tij strategjik në tranzicionin e KEK-ut drejt burimeve të ripërtëritshme.

## Rekomandimet për realizimin e përmbushjes së objektivit strategjik 2 dhe objektivave specifike:

- Finalizimi i Strategjisë Afatgjate për Dekarbonizim, me fokus në çmimin e karbonit.
- Në mënyrë që konsumatorët e energjisë elektrike të kenë më shumë incentiva për t'u bërë prosumatorë, duhet të zbatohet legjislacioni sekondar që derivohet nga Ligji për Promovimin e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë.
- Rekomandohet përsheptimi i miratimit të akteve nënligjore në përputhje me direktivat e BE-së, duke krijuar një kornizë të qartë për funksionimin e komuniteteve të energjisë. Ky proces duhet të shoqërohet me masa mbështetëse dhe projekte pilot që promovojnë qasje nga poshtë-lart (bottom-up) ndaj dekarbonizimit, duke përfshirë komunat, sektorin privat, institucionet akademike dhe shoqërinë civile, me qëllim fuqizimin e qytetarëve si aktorë aktivë në tranzicionin energjetik. Krijimi i modeleve praktike dhe të replikueshme për zbatim në nivel kombëtar duhet të mbështetet edhe përmes mekanizmave të informimit dhe asistencës teknike për qytetarët dhe bizneset e vogla, përfshirë funksionalizimin e qendrave “one-stop shop” për informacion mbi burimet e ripërtëritshme të energjisë. Edhe pse këto mekanizma nuk janë të parashikuara drejtpërdrejt në Planin e Veprimit të Strategjisë së Energjisë, mungesa e tyre përbën një boshllëk të rëndësishëm në përpjekjet për demokratizimin e energjisë dhe përsheptimin e dekarbonizimit.
- Të thjeshtohen procedurat për përgatitjen e dokumentacioneve për zhvillimin e projekteve krahas ankandeve të energjisë së ripërtëritshme, duke përfshirë edhe procedurat komunale.

---

**Objektivi Strategjik III:  
Rritja e Efiçencës së Energjisë**

### 3. Objektiv i Strategjik III: Rritja e Eficiencës së Energjisë

Eficienca e energjisë paraqet potencialin më të madh dhe më kosto-efektiv për uljen e konsumit të energjisë në Kosovë, duke pasur parasysh se sektori i ndërtesave përbën mbi 40% të konsumit final të energjisë, ndërsa një pjesë e madhe e këtij konsumi lidhet me ngrohjen jo-eficiente. Investimet në masa të eficiencës së energjisë në ndërtesa rezidenciale dhe publike mund të reduktojnë konsumin e energjisë deri në 30–50%, duke ulur njëkohësisht kërkesën për energji elektrike, varësinë nga importi dhe presionin mbi kapacitetet ekzistuese prodhuese. Në këtë kontekst, eficientia e energjisë përfaqëson jo vetëm një masë klimatike, por edhe një instrument kyç ekonomik dhe social për adresimin e varfërisë energjetike dhe përmirësimin e sigurisë së furnizimit, duke krijuar ndikim të menjëhershëm pa nevojë për investime të mëdha në kapacitete të reja prodhuese.

Indikatorët e objektivit strategjik 3 për rritjen e eficiencës së energjisë janë:

- Niveli i konsumit final të energjisë
- Kursimet kumulative të energjisë të arritura në sektorin e ndërtimit

*Tabela 8. Caqet e strategjisë së energjisë për eficiencën e energjisë dhe rritjen e performancës energjetike në ndërtesa.*

Nr.	Objektivat strategjike dhe specifike, treguesit dhe veprimet	Vlera bazë	Objektivi afatshkurtër 2025	Objektivi i vitit të fundit 2031
III.	<b>OBJEKTIVI STRATEGJIK 3: RITJA E EFIÇIENCËS SË ENERGJISË</b>			
1	Indikator: Niveli i konsumit final të energjisë	1516 ktoe [2017]	1709 ktoe	1877 ktoe
2	Indikator: Kursimet kumulative të energjisë të arritura në sektorin e ndërtimit	2.7 ktoe [2021]	17.76 ktoe	266.4 ktoe

Objektivat specifike për rritjen e eficiencës së energjisë:


1. Përmirësimi i eficiencës së energjisë në ndërtesa
2. Promovimi i kogjenerimit efikas dhe sistemeve eficiente të ngrohjes qendrore

Secili prej këtyre objektivave ka të caktuar veprimet e ndërmarra për përmbushjen e tyre. Në tabelën dhe grafën e mëposhtëm është paraqitur përmbushja e secilit objektiv specifik, gjithashtu dhe mesatarja e përmbushjes së objektivit strategjik duke u bazuar në përmbushjen e objektivave specifike.

**Tabela 9. Përqindja totale e realizuar për objektivin strategjik për vitet 2022-2024.**

Objektivi Specifik	% e realizimit
Përmirësimi i efijencës së energjisë në ndërtesa	60.42%
Promovimi i kogjenerimit efikas dhe sistemeve efijente të ngrohjes qëndrore	95%
<b>Përqindja e realizimit të objektivit strategjik</b>	<b>77.71%</b>

**Grafiku 4. Realizimi i objektivave specifike për rritjen e efijencës së energjisë.**



Nga tabela e përqindjeve dhe grafiku shohim se dy objektivat specifike janë përmbushur mbi 60%. Përmirësimi i efijencës së energjisë në ndërtesa ka përqindje më të ulët të përmbushjes së veprimeve të parapara se sa promovimi i kogjenerimit efikas dhe sistemeve efijente të ngrohjes.

Më poshtë gjendet komentimi i realizimit të objektivave specifike dhe analizimi i ndikimit të veprimeve të marra në fushën e efijencës së energjisë.

Poashtu në tabelën e mëposhtme është paraqitur niveli i përmbushjes së veprimeve, përfshire ato të përfunduara tërësisht dhe ato që janë përfunduar mbi 50% për vitin 2024:

**Tabela 10. Niveli i përmbushjes së veprimeve të objektivave specifike për vitin 2024.**

Nr.	Objektivi Specifik	Veprime të pazbatuara deri në 2024	Veprimet e realizuara nën 50% deri në 2024	Veprimet e realizuara mbi 50% deri në 2024	Veprime të realizuara 100% deri në 2024	Veprime të planifikuara pas vitit 2024	Gjithsej veprimet 2022-2025
1	Përmirësimi i efijencës së energjisë në ndërtesa	2	3	5	5	6	21
2	Promovimi i kogjenerimit efikas dhe sistemeve efijente të ngrohjes qëndrore	0	0	2	1	3	6
	<b>Gjithsej veprimet e objektivit strategjik III</b>	2	3	7	6	9	27

### 3.1. Komentim mbi përmbushjen e objektivave specifike

Përmbushja e objektivave specifike në kuadër të Objektivit Strategjik III për rritjen e efijencës së energjisë paraqet një pasqyrë të përzier, ku progresi në zbatimin e masave konkrete në terren është më i theksuar sesa avancimi i kornizës ligjore dhe strategjike. Në aspektin e rafinimit dhe zhvillimit të kornizës ligjore, vërehen ngecje të konsiderueshme, veçanërisht në rishikimin e Ligjit për Efijencë të Energjisë, i cili sipas afatit kohor është paraparë të miratohej në vitin 2023. Si pasojë, veprimi për miratimin e akteve nënligjore që rrjedhin nga ky ligj rezulton me **0% progres**, pasi këto akte nuk mund të miratohen pa u aprovuar legjislacioni primar. Po ashtu, progres i ulët është shënuar edhe në draftimin dhe miratimin e Strategjisë për Renovimin e Ndërtesave.

Në anën tjetër, rezultatet në zbatimin e masave për efijencë të energjisë janë më pozitive, veçanërisht në sektorin e ndërtesave publike, ndërtesave rezidenciale dhe tek bizneset, përkatësisht NMVM-të. Masat e ndërmarra përmes skemave të subvencionimit të financuara nga buxheti shtetëror kanë qenë të përsëritshme që nga viti 2022 dhe janë zgjeruar gradualisht në kategori të reja të subvencionimit në kuadër të efijencës së energjisë. Përveç përfitimit direkt në uljen e konsumit të energjisë, këto masa kanë kontribuar edhe në rritjen e vetëdijes dhe zhvillimin e një kulture të aplikimit të masave të efijencës së energjisë tek qytetarët dhe NMVM-të.

Megjithatë, shkalla e ndërhyrjeve mbetet e kufizuar në raport me potencialin real të kursimeve të energjisë dhe nevojat ekzistuese në terren. Kjo vërehet veçanërisht në sektorin e ndërtesave rezidenciale shumëbanesore në pronësi të komunave, ku progresi për vitin 2024 rezulton vetëm **2.4%**, duke reflektuar sfida të vazhdueshme në kapacitetet komunale, bashkëfinancimin dhe menaxhimin e projekteve të rehabilitimit energjetik në këtë segment. Ky kontrast tregon se mekanizmat ekzistues të financimit dhe zbatimit

funksionojnë më mirë në segmentet me kapacitete institucionale të konsoliduara (KEEF, projekte qendrore), ndërsa dështojnë të adresojnë segmentet më komplekse dhe më të ndjeshme socialisht, si ndërtesat shumëbanesore në pronësi komunale.

Një zhvillim pozitiv në kuadër të këtij objektivi është lëshimi i **dy certifikatave të performancës energjetike** për ndërtesa administrative, nga të cilat njëra është në pronësi të Republikës së Kosovës. Ky hap përfaqëson një avancim drejt përmirësimit të performancës energjetike në ndërtesat e institucioneve publike, të cilat financohet Rekomandimet për realizimin e përmbushjes së objektivit strategjik 3 dhe objektivave specifike: buxheti shtetëror dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në shpenzimet operative, përfshirë kostot e energjisë. Reduktimi i përdorimit të panevojshëm të energjisë në ndërtesat publike përbën jo vetëm masë ekonomike, por edhe një obligim etik ndaj qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Mospërputhja ndërmjet ngecjes në avancimin e kornizës ligjore dhe progresit relativisht më të mirë në zbatimin e masave për efikasitet të energjisë mund të shpjegohet, në masë të konsiderueshme, me ekzistencën dhe funksionalitetin e mekanizmave të dedikuara për zbatim, në veçanti Fondit për Efikasitet të Energjisë (KEEF). Prania e një institucioni operacional me mandat të qartë për financimin dhe implementimin e masave ka mundësuar vazhdimësi në zbatim dhe rezultate konkrete në terren, pavarësisht vonësive në reformën ligjore dhe strategjike. Në të njëjtën kohë, proceset e rishikimit të legjislativës primare dhe miratimit të akteve nënligjore kanë mbetur të ekspozuara ndaj sfidave institucionale dhe prioritizimit politik. Megjithatë, mbështetja kryesisht në instrumente ekzistuese financiare, pa përditësim të plotë të kornizës ligjore, rrezikon të kufizojë shkallëzimin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të masave për efikasitet të energjisë.

## 3.2. Përbushja e veprimeve të objektivave specifike

### 3.2.1. Përmirësimi i efijencës së energjisë në ndërtesa

Indikatorët sipas PZSEK:

- Kursimet totale kumulative të energjisë në ndërtesa publike:
  - o 2.6 ktoe (2021),
  - o 3.3 ktoe (2025),
  - o 33.9 ktoe (2031).
- Kursimet totale të energjisë në ndërtesat rezidenciale dhe komerciale:
  - o 0.1 ktoe (2021),
  - o 14.46 ktoe (2025),
  - o 232.5ktoe (2031).
- Numri i ndërtesave me konsum zero të energjisë:
  - o 0 (2021),
  - o 10 (2025),
  - o 150 (2031).

Në tabelat e mëposhtme janë listuar veprimet për arritjen e objektivit specifik:

3.1.1. Veprimi: Rishikimi i Ligjit për Efijencë të Energjisë		
Institucioni	Financimi	Afati
ME, MMPHI, FKEE	Buxheti i Kosovës, donatorët	2023
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Në vitin 2023 është hartuar drafti i parë i Projektligjit për Efijencë të Energjisë	Drafti i fundit, i përgatitur nga konsulenca dhe Grupi Punues, është pranuar dhe dërguar përsëri te Grupi Punues për shqyrtim dhe komente. Pas përfshirjes dhe trajtimit të komenteve, është përgatitur versioni përfundimtar i draftit, i cili tashmë është gati për diskutim paraprak dhe konsultim publik.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	40%	60%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Drafti final është dorëzuar për shqyrtim fillestar në kabinet, por deri më tani nuk janë marrë komente apo udhëzime lidhur me hapat e mëtejshëm. Nuk ka ndonjë zhvillim të ri për këtë aktivitet.		

3.1.2. Veprimi: Miratimi i akteve nënligjore lidhur me Ligjin për Eficiencën e Energjisë		
Institucioni	Financimi	Afati
ME, MMPHI, FKEE	Buxheti i Kosovës, donatorët	2024
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Nuk ka progres	Sipas planifikimit, aktivitetet pritet të fillojnë pas aprovimit të ligjit për Eficiencën e Energjisë (EE).
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	0%	0%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment nga institucionet përkatëse.		

3.1.3. Veprimi: Rishikimi i Ligjit për Performancën Energjetike të Ndërtesave		
Institucioni	Financimi	Afati
ME, MMPHI, FKEE	Buxheti i Kosovës, donatorët	2023
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Gjatë vitit 2022 është hartuar dhe miratuar Koncept Dokumenti për performancën energjetike në ndërtesa, i cili u aprovua nga Qeveria më 30 prill 2022, me rekomandimin për ndryshimin e Ligjit Nr. 05/L-101	Projektligji është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e saj të 148-të më 29 qershor 2023 dhe më pas është votuar në parim nga Kuvendi i Kosovës më 15 dhjetor 2023 si Projektligji nr. 08/L-242 për performancën energjetike të ndërtesave.	Ka përfunduar
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
20%	90%	100%
Sfidat dhe Rekomandimet		
N/A		

3.1.4. Veprimi: Miratimi i akteve nënligjore lidhur me Performancën Energjetike të Ndërtesave		
Institucioni	Financimi	Afati
MMPHI	Buxheti i Kosovës, donatorët	2024
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Projektligji nr. 08/L-242 për performancën energjetike të ndërtesave është miratuar nga Qeveria më 29.06.2023 dhe është votuar në parim nga Kuvendi më 15.12.2023. Aktet nënligjore do të hartohen pas hyrjes në fuqi të ligjit.	Nuk ka pasur progres	Është hartuar drafti i rregullores për Metodologjinë Kombëtare të Performancës Energjetike në ndërtesa sipas standardeve EN dhe është punuar në përcaktimin e kostos optimale gjatë ciklit jetësor të ndërtesave.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	0%	0%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment nga institucioni përkatës		

3.1.5. Veprimi: Zhvillimi i Regjistrit Kombëtar për performancën energjetike në ndërtesa		
Institucioni	Financimi	Afati
MMPHI, ME	Buxheti i Kosovës, donatorët	2023
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
AKEE dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me mbështetjen e GIZ, kanë ridizajnuar komponentën e Auditimit Energjetik në Softuerin e Regjistrit Kombëtar për Certifikim Energjetik. Softueri është instaluar në ASHI dhe auditorët e energjisë janë informuar përmes një trajnimit njëditor mbi funksionalitetet e reja të sistemit.	Sipas nenit 13, paragrafi 5 të Ligjit Nr. 05/L-101 për Performancën Energjetike në Ndërtesa, AKEE është përgjegjëse për hartimin e Regjistrit Kombëtar për Certifikim Energjetik, ndërsa MMPHI merr pjesë vetëm në komponentën e performancës energjetike në ndërtesa, e cila është në fazën përfundimtare. Regjistri është hartuar, funksional në serverët e ASHI-së dhe menaxhohet nga ME për pjesën e auditorëve të energjisë. Me mbështetjen e GIZ (projekti KEP), është bërë ridizajnimi i softuerit për komponentën e auditimit energjetik dhe janë trajnuar auditorët. Në vitin 2023, platforma është ndërlidhur me e-Kosova dhe sistemet tjera digjitale.	Projekt-platforma për centralizimin e të dhënave në fushën e Efiçencës së Energjisë, "Regjistri Kombëtar për Efiçencën e Energjisë në ndërtesa", e instaluar në serverët e ASHI-së, është testuar me lëshimin e dy certifikatave të performancës energjetike për ndërtesa.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
80%	90%	90%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Kontributi i shumë aktereve në këtë proces dhe mundësia e vështirë në priorizim të aktiviteteve.		

3.1.6. Veprimi: Hartimi dhe miratimi i Strategjisë së Rinovimit të Ndërtesave		
Institucioni	Financimi	Afati
MMPHI	Donatorët	2024
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres.	Nuk ka progres	Është ndërmarrë iniciativë drejt donatorëve për mbështetje në hartimin e Strategjisë së Rinovimit të Ndërtesave, ndërsa LUX-DEV ka shpallur interesim për përgatitjen e këtij dokumenti.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	0%	0%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment nga institucioni përkatës		

3.1.7. Veprimi: Fushata për ndërgjegjësimin e publikut		
Institucioni	Financimi	Afati
ME, FKEE, MMPHI	Buxheti i Kosovës, donatorët	Vjetore
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Është realizuar organizimi i fushatave informuese për masat e Eficiencës së Energjisë, duke përfshirë shpalljen dhe publikimin e Thirrjes Publike për Masat e Eficiencës së Energjisë, si dhe krijimin e videove promovionale dhe broshurave.	Janë organizuar fushata promovuese për Thirrjet Publike që kanë për qëllim subvencionimin e masave të Eficiencës së Energjisë, përmes intervistave, spoteve informuese, materialeve promovuese si broshura, reklama dhe elemente vizuale.	Ka pasur një fushatë vetëdijësimi gjatë periudhës së thirrjeve për aplikim të subvencioneve.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
90%	90%	100%
Sfidat dhe Rekomandimet		
N/A		

3.1.8. Veprimi: Zbatimi i masave të efijencës së energjisë në ndërtesa publike (niveli qendror)		
Institucioni	Financimi	Afati
ME	Buxheti i Kosovës, Donatorët (BB)	2023
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Renovimi i objekteve të përfshira në LOT 1 ka arritur një progres prej 60%, ndërsa për LOT 2, kontrata është nënshkruar në janar dhe punimet kanë nisur në muajin shkurt.	Janë zbatuar masa të efijencës së energjisë në 12 objekte publike (6 në QKUK, 3 spitale dhe 3 objekte administrative). Punimet në LOT 1 kanë përfunduar në gusht 2024, ndërsa pranimit teknik në shtator. LOT 2 është në fazën përfundimtare dhe përfundon në nëntor, me pranimit teknik në dhjetor. Garancia e punimeve zgjat 12 muaj pas përfundimit.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	60%	100%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Ka pasur pengesa dhe vonesa në realizimin e punimeve, veçanërisht në objektet spitalore të LOT 1, për shkak të pranisë së vazhdueshme të pacientëve. Janë ndërmarrë masa dhe veprime për menaxhimin dhe adresimin e këtyre vonesave.		

3.1.9. Veprimi: Zbatimi i masave të efijencës së energjisë në ndërtesat publike (në niveli komunal)		
Institucioni	Financimi	Afati
FKEE	Buxheti i Kosovës, Donatorët (BE, BB-KEEREP)	Vjetore
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Në kuadër të projektit MEEP, FKEE ka shpallur dy thirrje publike në vitet 2020 dhe 2021 për rritjen e efijencës së energjisë në ndërtesa publike dhe ndriçim rrugësh. Janë nënshkruar 150 marrëveshje për fillimin e projekteve, dhe për 86 objekte janë lidhur marrëveshje për shërbime të energjisë. Në vitin 2022, për 41 objekte kanë përfunduar shumica e punimeve, me kursim energjie prej 0.78 ktoe/vit. Vlera totale e kontratave ishte mbi 5.1 milionë euro.	Në kuadër të projektit MEEP, FKEE ka shpallur dy thirrje publike në vitet 2020 dhe 2021 për rritjen e efijencës së energjisë në ndërtesa publike dhe ndriçim rrugësh. Janë nënshkruar 150 marrëveshje për fillimin e projekteve dhe 86 për shërbime të energjisë. Deri në vitin 2023 janë përfunduar 83 projekte me kursim energjie prej 1.67 ktoe/vit dhe buxhet të shpenzuar prej 5.96 milionë euro. Po ashtu, janë kontraktuar shërbime konsulence për 34 objekte të reja.	Fondi i Kosovës për Efijencë të Energjisë (FKEE), në kuadër të projektit MEEP, ka publikuar dy thirrje publike në vitet 2020 dhe 2021 për të përmirësuar efijencën e energjisë në ndërtesa publike dhe ndriçim rrugësh. Janë nënshkruar 150 marrëveshje për fillim projekti dhe 86 marrëveshje për shërbime energjetike. Deri në mesin e vitit 2024 janë përfunduar 83 projekte me kursim energjie prej 1.67 ktoe/vit, ndërsa buxheti i shpenzuar ka arritur 15.33 milionë euro. Janë përgatitur edhe 34 projekte të reja për zbatim.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
79%	60%	86%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Sfida kryesore për masat e Efijencës së Energjisë (EE) përfshinë mungesën e një sistemi të unifikuar, kapacitete të kufizuara profesionale, sfida në digjitalizim, mungesë të materialeve vendore dhe të qëndrueshme, si dhe pengesa ligjore dhe menaxhimin e mbeturinave. Rekomandohet zhvillimi i prodhimeve vendore, certifikimi i laboratorëve për testim, dhe aftësimi profesional i ofruesve të shërbimeve në fushën e EE.		

3.1.10. Veprimi: Zbatimi i masave të efijencës së energjisë në ndërtesat publike (në nivel komunal)		
Institucioni	Financimi	Afati
ME	Buxheti i Kosovës, KfW, WBIF	2023
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Nuk ka progres	Është themeluar njësia për implementimin e projektit.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	0%	0%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment nga institucioni përkatës.		

3.1.11. Veprimi: Korniza e qyteteve të gjelbërta 2 dritarja 2 - Efijenca e energjisë në ndërtesa publike në Prishtinë		
Institucioni	Financimi	Afati
Komuna e Prishtinës	Kredi nga EBRD	2025
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Është kryer tenderimi për përzgjedhjen e Konsulentit për dizajnin detaj. Në mars pritet faza tjetër.	Nuk ka progres
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
N/A	30%	N/A
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment nga institucioni përkatës.		

3.1.12. Veprimi: Zbatimi i masave të Efijencës së Energjisë në Ndërtesat Publike në Prizren		
Institucioni	Financimi	Afati
Komuna e Prizrenit	Kredi nga EBRD	2025
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Eshtë bërë vetëm vlerësimi. Pritet tenderimi.	Nuk ka progres
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
N/A	10%	N/A
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment nga institucioni përkatës.		

**3.1.13. Veprimi: Zbatimi i masave të efijencës së energjisë në sektorin rezidencial (26 ndërtesa shumëbanesore)**

Institucioni	Financimi	Afati
MFK,ME, Komuna	MMC-Millennium Foundation Kosovo	2022
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Projektet e MCC-së për masat e efijencës së energjisë janë përfunduar deri më 30 shtator 2022, ndërsa disa projekte me afat të zgjatur janë përfunduar më 29 nëntor 2022. Janë përfshirë: renovimi i 1200 shtëpive individuale, 26 ndërtesave shumëbanesore, instalimi i matësve për 17,500 konsumatorë të ngrohjes qëndrore dhe pajisje efijente për 410 biznese të udhëhequra nga gratë.	Nuk ka progres	Ka përfunduar
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
100%	N/A	100%
Sfidat dhe Rekomandimet		
N/A		

**3.1.14. Veprimi: Studimi i fizibilitetit për zbatimin e masave të efijencës së energjisë në sektorin rezidencial dhe privat**

Institucioni	Financimi	Afati
FKEE	Donatorët (WBIF)	2024
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Nuk ka progres	Është përfunduar analiza e mungesave (GAP analysis) dhe janë realizuar studimet përfundimtare për skemat në sektorin rezidencial, të cilat janë prezantuar bashkë me planin e veprimit (roadmap), duke u konsideruar si proces i përmbyllur.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	0%	100%
Sfidat dhe Rekomandimet		
N/A		

**3.1.15. Veprimi: Zbatimi i masave të efijencës së energjisë në sektorin rezidencial (shtëpi individuale)**

Institucioni	Financimi	Afati
FKEE	Donatorët (WBIF)	2024
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Në vitin 2023, FKEE publikoi Thirrjen Publike për Masat e Efijencës së Energjisë për Shtëpitë Individuale të Banimit, mbështetur nga Bashkimi Evropian dhe Qeveria e Kosovës. Nga 3321 aplikime, 2150 janë para-aprovuar me një vlerë prej 8,230,050 €. 1010 aplikime janë në listë pritjeje dhe 161 janë anuluar. Rreth 700 aplikime për disbursim janë në proces verifikimi nga 9 kompani të angazhuara, dhe marrëveshjet e para janë nënshkruar. Buxheti i shpenzuar ka arritur në 41,137.61 €.	Në vitin 2023, FKEE publikoi thirrjen publike për zbatimin e masave të Efijencës së Energjisë (EE) për shtëpitë individuale të banimit, mbështetur nga BE dhe Qeveria e Kosovës. Nga 3321 aplikime, 2148 janë para-aprovuar me një fond prej 8.23 milion euro, dhe 1811 aplikime kanë pranuar disbursimin me vlerë 6.7 milion euro. 1010 aplikime janë në listën e pritjes, ndërsa 267 aplikime të tjera janë verifikuar nga 9 kompani dhe janë nënshkruar 1789 marrëveshje. Buxheti i shpenzuar ka arritur në 6,347,438.91 €. FKEE ka nisur një thirrje të dytë me një buxhet prej 5 milionë euro, dhe deri tani janë nënshkruar 806 marrëveshje me një vlerë prej 2,836,510.70 €. Vlera e kursimit të energjisë nga ky projekt është 4.4 ktoe/vit.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	1%	93%
Sfidat dhe Rekomandimet		
<p>Sfida kryesore identifikohen si: numri i lartë i aplikimeve brenda një kohe të shkurtër, procesimi manual i aplikimeve, burimet njerëzore të kufizuara, kërkesat urgjente dhe mangësitë në dokumentacionin për disbursim, dhe kapacitetet e kufizuara profesionale në verifikimin e masave EE. Rekomandimet përfshijnë angazhimin e stafit me orë shtesë, përdorimin e praktikantëve, komunikimin direkt me qytetarët dhe përmes rrjeteve sociale, si dhe organizimin e trajnimeve për kompanitë e angazhuara në procesin e verifikimit.</p>		

3.1.16. Veprimi: Zbatimi i masave të efikasitës së energjisë në sektorin rezidencial (ndërtesa shumë-banesore sociale në pronësi të komunave)		
Institucioni	Financimi	Afati
FKEE	Komisioni Evropian / Fondet IPA	2024
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Në vitin 2023, FKEE ka publikuar Thirrjen Publike për zbatimin e Projektit Emergjent për Masat e Efikasitës së Energjisë për Ndërtesat Shumë Banesore Sociale në Pronësi të Komunave, me mbështetje nga BE dhe Qeveria e Kosovës. Janë nënshkruar marrëveshje për 29 ndërtesa në 13 komuna, ndërsa janë kontraktuar 3 kontrata për konsulentë për 22 ndërtesa, të cilat kanë përfunduar deri në fazën e tenderimit për punët. Buxheti i shpenzuar ka qenë 55,200.00 €.	Në vitin 2023, FKEE ka publikuar Thirrjen Publike për Masat e Efikasitës së Energjisë për Ndërtesat Shumë Banesore Sociale në Pronësi të Komunave, me mbështetje nga BE dhe Qeveria e Kosovës. Janë nënshkruar marrëveshje për 29 ndërtesa në 13 komuna. Për 22 ndërtesa është realizuar tenderimi për kontrata zbatuese, ndërsa për 6 ndërtesa është në përfundim dizajni. Buxheti i shpenzuar për këtë proces ka qenë 240,763.80 €.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	1%	2.40%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Proceset e gjata në lidhje me ankesat përmes prokurimit publik të Kosovës kanë shkaktuar bllokimin e 25 ndërtesave në OSHP. Për 7 prej tyre, ka pasur përgjigje pas 7 muajsh, ndërsa për një tjetër përgjigje ende është në pritje. Duke qenë se projekti është në fazën e nisjes, nuk janë identifikuar sfida të tjera deri tani.		

3.1.17. Veprimi: Zbatimi i Masave të efikasitës së energjisë në sektorin rezidencial dhe NMVM-të		
Institucioni	Financimi	Afati
FKEE	Donatorët (WBIF)	2025
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Nuk ka progres	Nuk ka filluar ende
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	0%	0%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment nga institucioni përkatës.		

3.1.18. Veprimi: Zbatimi i masave të efijencës së energjisë në sektorin rezidencial		
Institucioni	Financimi	Afati
ME	Buxheti i Kosovës, Donatorët	2022/2023
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Ministria e Ekonomisë, përmes ish-AKEE-së, ka shpallur Thirrjen Publike për subvencione për masat e efijencës së energjisë në sistemet e ngrohjes, duke përfshirë pompat termike, inverterët e nxehtësisë, dhe kaldajat me biomasë. Një shumë prej 6 milionë eurosh është shpërndarë për 9514 qytetarë që kanë investuar në këto sisteme, me një vlerë totale të subvencioneve prej 4,910,000 euro.	Ministria e Ekonomisë ka lansuar tri thirrje publike për mbështetje të konsumatorëve familjarë, veçanërisht atyre në nevojë, për subvencionim në investime në pajisje elektro-shtëpiake efijente, sisteme diellore për ngrohjen e ujit dhe pajisje efijente për ngrohje (pompa termike, kondicionerë efijentë, kaldaja me biomasë). Vlera e përgjithshme e subvencionimit për këtë vit ka qenë 5 milionë euro, ndërsa 5 milionë euro të tjera janë bartur për vitin 2024.	Nuk ka progres
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
98.20%	50%	N/A
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment nga institucioni përkatës.		

3.1.19. Veprimi: Zbatimi i masave të efijencës së energjisë në sektorin rezidencial (Ndërmarrjet Mikro, të Vogla, dhe të Mesme - NMVM)		
Institucioni	Financimi	Afati
ME	Komisioni Evropian / Fondet IPA	2023
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Ministria e Ekonomisë ka hapur një thirrje publike për mbështetje të NMVM-ve në instalimin e pajisjeve efijente për ngrohje, e cila është ende në proces vlerësimi. Rimbursimi ende nuk ka filluar, dhe 5 milionë eurot janë bartur për vitin 2024. Aplikimet për fazën e parë janë të hapura deri në janar 2024. Pagesat janë ekzekutuar gjatë vitit 2024.	Nuk ka progres
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
N/A	20%	N/A
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment nga institucioni përkatës.		

3.1.20. Veprimi: Instalimi i sistemeve solare FV në kompanitë rajonale të ujit (KRU)		
Institucioni	Financimi	Afati
ME	KfW	2024
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Studimi i fizibilitetit për projektin, i realizuar nga SRP – Hidroing dhe CES, ka përfunduar dhe është dërguar për komente në Kabinet dhe Departamentin e Energjisë. Projekti, me vlerë 15 milionë euro, është donacion nga KfW dhe zhvillohet sipas Ligjeve të Prokurimit Gjerman. Ai parasheh instalimin e paneleve solare në kompanitë rajonale të ujësjellësit në Pejë, Gjakovë, Prizren dhe Prishtinë. Në vitin 2023 janë realizuar pagesa për studimin e fizibilitetit në shumën totale prej 99,655 euro, me 40% të shumës paguar në vitin 2023 dhe 50% në vitin 2024, ndërsa mbetet të realizohet 10% e fundit.	Është bërë rishikimi i termave të referencës së projektit nga ME-ja dhe KfW.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	99.60%	0%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment nga institucioni përkatës.		

3.1.21. Veprimi: Zhvillimi i tregut ESCO		
Institucioni	Financimi	Afati
ME	Buxheti i Kosovës, donatorët	2024 /2025
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Nuk ka progres	Nuk ka progres
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	0%	0%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka pasur zhvillime për arsye se Projekligji për Eficiencë të Energjisë ende nuk është miratuar dhe Udhëzimi administrativ është në draftim e sipër.		

### 3.2.2. Promovimi i kogjenerimit efikas dhe sistemeve eficiente të ngrohjes qendrore

Indikatorët sipas PZSEK:

- Rritja e kapaciteti të kogjenerimit në “Termokos” (Prishtinë): baza 140 MWth, (2025) 140 MWth, (2031) 280 MWth.
- Numri i konsumatorëve të lidhur në sistemet e ngrohjes qendrore (Prishtinë & Gjakovë): baza 17,791, (2021) 24,560, (2031) 38,240 në Prishtinë dhe Gjakovë. Për komunat e tjera do të vendoset në bazë të studimit të fizibilitetit.

Në tabelat e mëposhtme janë listuar veprimet për arritjen e objektivit specifik:

3.2.1. Veprimi: Zgjerimi dhe rehabilitimi i rrjetit të ngrohjes qendrore të Prishtinës		
Institucioni	Financimi	Afati
Termokos	KfW, Termokos	Vjetore
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Rehabilitimi i rrjetit të ngrohjes: 8,726 m tub paraizoluar. Zgjerimi i rrjetit të ngrohjes: 3,810 m tub paraizoluar. Densifikimi i rrjetit të ngrohjes: 5,298 m tub paraizoluar. Totali: 17,834 m tub paraizoluar.	Në vitin 2023, janë realizuar: Rehabilitimi i rrjetit të ngrohjes: 2,348 m tub paraizoluar. Zgjerimi i rrjetit të ngrohjes: 5,816 m tub paraizoluar. Densifikimi i rrjetit të ngrohjes: 512 m tub paraizoluar. Totali: 17,834 m tub paraizoluar. Për instalimin e nënstacioneve: 153 nënstacione të reja për zgjerim dhe densifikim të rrjetit. 118 nënstacione të reja për rehabilitim. Automatizim i 22 nënstacioneve. Po ashtu, janë ndërtuar dhe instaluar dy rezervoarë të nxehtësisë me kapacitet 2 x 400m <sup>3</sup> , për akumulimin e energjisë termike, në oborr të Termokosit. Ky projekt përfundon në vitin 2024, me buxhetin përkatës që do të përmbillet atë vit.	Projekti për Zgjerimin dhe Rehabilitimin e Rrjetit të Ngrhjes Qendrore në Prishtinë, financuar nga KfW dhe NP "Termokos", është ndarë në dy pako tenderuese: Kontrata T-1 (nënshkruar në dhjetor 2021): 325 nënstacione të reja, 225 të rehabilituara, 31 të automatizuara, dhe Dy rezervuarë të nxehtësisë (800m <sup>3</sup> ) dhe integrimi në SCADA, Funkcionalizimi i sistemit të zbutjes së ujit. Kontrata T-2 (nënshkruar në dhjetor 2020): 13 km gyp për rehabilitim dhe 32 km për zgjerim dhe densifikim të rrjetit të ngrohjes. Ky projekt ka lidhur 13,030 konsumatorë, me 7,966 konsumatorë aktivë dhe 5,064 pasivë.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
70%	99%	100%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Sfidat: Mungesa e hapësirave për nënstacione, problemet pronësore, vonesa në përgatitjen e rrjetit sekondar, vështirësitë për kyçjen e nënstacioneve në sistemin elektrik për shkak të mungesës së hapësirës për orët elektrike, presioni nga konsumatorët për kyçje në rrjetin e ngrohjes dhe problemet teknike gjatë procesit të punës. Rekomandimet: Të gjitha problemet e përmendura janë zgjidhur përmes bashkëpunimit me ndërtuesit e objekteve dhe konsumatorët, duke u gjetur alternativa lehtësuese. Sistemet janë funksionale.		

**3.2.2. Veprimi: Studimi i fizibilitetit për rritjen e kapacitetit termik në Kogjenerimin TC Kosova B nga 140 MWth në 280 MWth**

Institucioni	Financimi	Afati
Termokos,KEK	IPA 2020, Komuna e Prishtinës, Termokos	2023
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Marrëveshja ndërmjet Bankës Europiane për Investime (EIB) dhe Termokosit është nënshkruar më 17.06.2022 për projektin që synon dyfishimin e kapacitetit të energjisë termike nga Termokos/KEK. Ky projekt është bazuar në studimin e fizibilitetit të finalizuar, Strategjinë e Energjisë 2022-2031 dhe Planin Zhvillimor të Termokosit 2022-2031. BEI ka ndarë një grant prej 1,5 milionë euro për financimin e studimeve paraprake të projektit.	Nga kompania ndërkombëtare konsulente, konzorciumi "ERIITA" ka vazhduar përgaditja Studimit fizibilitetit Planit dekarbonizim.	Ky projekt është pjesë e studimit për zgjerimin e rrjetit dhe dyfishimin e kapacitetit gjenerues të energjisë termike nga 140 në 280 MWTH nga TC "Kosova B". Për zhvillimin e tij janë realizuar disa hapa, përfshirë: Miratimi i projektit për dekarbonizim në janar 2024. Prezantimi i dizajnit për instalimin e gypave dhe zgjerimin e rrjetit. Definimi i lokacionit për HRS-2 dhe përgatitja e vlerësimit financiar. Puna vazhdon për plotësimin e dokumenteve për leje dhe shpronësim. Prezantimi i planit të financimit që ende nuk është miratuar. Takim me Ministrinë e Financave dhe EIB për modalitetet e financimit. Miratimi i masterplanit të ri për zgjerimin e rrjetit.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
20%	30%	90%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Sfidat e cekura nga institucioni përkatës: Përfundimi i dokumentacionit për identifikimin dhe shpronësimin e trasesë, Marrja e lejes për shfrytëzimin e objektit ku ndodhet "Termokosi" për vendosjen e stacionit të HRS, Sigurimi i pëlqimit mjedisor, Sigurimi i grantit nga BE për shkak të masave, dhe Sigurimi i kredisë për këtë investim. Rekomandimet: Bashkëpunimi i ngushtë me drejtorinë e kadastrit të komunës së Prishtinës dhe Obiliqit për identifikimin e parcelave për shpronësim, si dhe bashkëpunim me Ministrinë e Financave për vlerësimin e parcelave për shpronësim (servitut).		

**3.2.3. Veprimi: Dyfishimi i kapacitetit të prodhimit të kogjenerimit nga 140 MWth në 280 MWth dhe zgjerimi i rrjetit të transmisionit**

Institucioni	Financimi	Afati
Termokos/KEK	Donatorët, Komuna e Prishtinës, Termokos	2025
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Gjatë vitit 2023, kompania konsulente "ERI ITA" ka zhvilluar aktivitetet e mëposhtme për këtë projekt: ka prezantuar dizajnin inicial për instalimin e gypave në TUH dhe HES1&HES2; po punon në përditësimin e Masterplanit të ri; ka propozuar trasenë për rrjetin Termoelektrane Kosova B-Termokos; po bashkëpunon me komunën e Prishtinës për sigurimin e lokacionit për HRS 2; dhe projekti i Dekarbonizimit është dërguar si i përfunduar dhe pritet të prezantohet para Bordit të ndërmarrjes dhe përfaqësuesve të komunës së Prishtinës.	Nuk ka filluar ende realizimi i projektit.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	60%	0%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment nga institucionet përkatëse.		

3.2.4. Veprimi: Instalimi i pajisjeve matëse për konsumatorët e Termokos		
Institucioni	Financimi	Afati
FMK/Termokos	FMK	2023
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Kontrata për këtë projekt, e nënshkruar në prill 2022 mes MFK dhe kontraktorit "ENERCO LLC", ka filluar në 27.07.2022. Gjatë vitit 2022, janë realizuar: 78% e objekteve të planifikuara, 10,117 valvola termostatike, 44,631 alokatorë, 36,302 matës të energjisë termike dhe 9 pompa qarkulluese.	Kontrata për këtë projekt, nënshkruar në prill 2022 mes MFK dhe "ENERCO LLC", ka filluar më 27.07.2022. Gjatë vitit 2022 janë realizuar: 10,117 objekte, 44,631 valvola termostatike, 36,302 alokatorë, 451 matës të energjisë termike dhe 9 pompa qarkulluese. Në vitin 2023 janë realizuar: 7,092 objekte, 32,724 valvola termostatike, 8,388 alokatorë, 2,711 matës të energjisë termike, 164 pompa qarkulluese dhe 18 valvola balancuese.	Pjesa e parë e projektit ka përfunduar dhe janë realizuar instalime si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• 77,632 valvola termostatike</li> <li>• 56,144 alokatorë</li> <li>• 4,202 matës të energjisë termike</li> <li>• 233 pompa qarkulluese</li> <li>• 18 valvola balancuese</li> </ul> Instalimi i valvulave termostatike dhe alokatorëve është kryer në 17,469 njësi banesore. Gjithashtu, 16,221 njësi banesore janë përfunduar 100%
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
58%	78%	95%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Sfidat e adresuara nga institucioni përkatës: Qasja në banesa të konsumatorëve, mungesa e pronarëve të banesave, pasi ata nuk jetojnë në Kosovë, dhe problemet teknike pas instalimit të valvulave termostatike Rekomandimet: Bashkëpunim i ngushtë mes Termokosit, kompanisë punëkryese dhe konsumatorëve.		

3.2.5. Veprimi: Përmirësimi i performancës së ngrohjes qendrore në Gjakovë		
Institucioni	Financimi	Afati
NQ Gjakova	Swiss State Secretariat for Economic Affairs (SECO), Komuna e Gjakovës	2023
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Projekti përfshin zvogëlimin e humbjeve të ujit në rrjetin primar të termofikimit përmes rehabilitimit të rrjetit të shpërndarjes dhe nënstacioneve, rinovimin e degës veriore të rrjetit dhe riparimet në degën jugore, si dhe instalimin e orematesve për faturimin sipas harxhimeve. Po ashtu, do të realizohet rehabilitimi i 355 nënstacioneve dhe zhvillimi i një koncepti të ri biznesi me fokus në treg dhe shërbimin ndaj konsumatorëve. Përmirësimi i rrjetit të ngrohjes në Spitalin Rajonal të Gjakovës do të përfshijë rinovimin e rrjetit dhe nënstacioneve, si dhe kyçjen e ndërtesave publike të reja.	Projekti përfshin modernizimin dhe digjitalizimin e sistemit të ngrohjes në qytetin e Gjakovës, duke implementuar një sistem monitorimi dhe kontrolli nga distanca ("Scada system"). Ky optimizim do të mundësojë faturim sipas harxhimeve dhe kursim energjie për qytetarët. Gjithashtu, janë realizuar rinovime në rrjetin sekondar të Spitalit Rajonal të Gjakovës dhe janë bërë kyçje të reja të ndërtesave publike, duke përfshirë instalimin e segmenteve të reja të rrjetit nga tubacioni kryesor deri tek nënstacionet.	Nuk ka aktivitete të parapara për vitin 2024
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
75%	15%	N/A
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment nga institucioni përkatës		

3.2.6 Subvencionimi për konsumatorët familjarë dhe NMVM-të		
Institucioni	Financimi	Afati
ME	Fondet BE	2024
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka pasur aktivitete të parapara për këtë vit	Nuk ka pasur aktivitete të parapara për këtë vit.	Janë realizuar gjithësej katër thirrje publike, për mbështetje të konsumatorëve familjarë dhe NMVM-ve, në investimin e pajisjeve eficiente për ngrohje, si dhe sistemeve të energjisë së ripërtëritshme. Gjithsej kanë marrur subvencione 32937 përfitues.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
		N/A
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment nga institucioni përkatës		

### 3.3. Sfidat dhe rekomandimet e përgjithshme

Sfidat e përgjithshme në realizimin e përmbushjes së objektivit strategjik 3 dhe objektivave specifike:

Ngecjet në rishikimin e ligjit për efikasitet të energjisë kanë rezultuar jo vetëm në mosrealizimin e këtij objekti specifike, por kanë bërë të pamundur progresin në draftimin e plotë dhe miratimin e akteve nënligjore që derivohen nga ky ligj.

- Kapaciteti administrativ i kufizuar ka shkaktuar ngecje në zbatimin e Planit Kombëtar për Efikasitet të Energjisë.
- Ekziston diskrepancë në progresin e masave për efikasitet të energjisë në sektorin rezidencial privat dhe atë publik. Masat e efikasitetit për shtëpitë individuale janë zbatuar në nivel prej 93%, kurse masat e efikasitetit për ndërtesat shumë-banesore në pronësi të komunave janë zbatuar vetëm 2.4%.

### Rekomandimet për realizimin e përmbushjes së objektivit strategjik 3 dhe objektivave specifike:

- Përshpejtimi i procedurave për rishikimin e Ligjit për Eficiencë të Energjisë dhe akteve nënligjore.
- Të vendoset një plan i qartë tranzitor që mundëson zbatimin e disa instrumenteve ekzistuese të eficiencës së energjisë (p.sh. skema financimi, standarde teknike minimale) edhe para miratimit përfundimtar të Ligjit për Eficiencë të Energjisë, për të shmangur vakumin rregullativ.
- Rekomandohet forcimi i rolit të Fondit për Eficiencë të Energjisë (KEEF) si mekanizëm qendror për zbatim, duke siguruar stabilitet financiar dhe zgjerim të instrumenteve të mbështetjes, në veçanti për sektorët me progres të ulët, si ndërtesat shumëbanesore në pronësi të komunave. Kjo duhet të shoqërohet me rritje të kapaciteteve teknike dhe administrative në nivel komunal, përfshirë asistencë teknike për përgatitjen dhe menaxhimin e projekteve.
- Organizimi i trajnimeve për stafin institucional dhe komunal mbi implementimin e masave të eficiencës së energjisë.
- Ndërlidhja e masave sociale me masat për eficiencë të energjisë.
- Heqja e barrierave administrative dhe përpilimi i një plani për thjeshtësimin e zbatimit të masave të eficiencës së energjisë në ndërtesat shumëbanesore në pronësi të komunave.
- Realizimi i masave të eficiencës në kuadër të dimensionit të eficiencës së energjisë brenda PKEK, si dhe përkufizimi sa më i shpejtë i varfërisë energjetike në menyrë që të targetohet drejtperdrejtë si grup.
- Implementimi i projekteve pilot që aplikojnë qasje nga poshtë-lart në fushën e eficiencës së energjisë, përfshirë modelet ESCO, me qëllim testimin dhe shkallëzimin e mekanizmave inovativë të financimit dhe zbatimit të bazuar në performancë. Modelet ESCO nënkuptojnë angazhimin e kompanive të specializuara që investojnë në masa për kursimin e energjisë në ndërtesa publike ose rezidenciale, ndërsa investimi fshihet përmes kursimeve të arritura në faturat e energjisë, pa kërkuar kosto të larta fillestare nga institucionet apo qytetarët. Këto projekte duhet të fokusohen veçanërisht në ndërtesat publike dhe ndërtesat rezidenciale shumëbanesore, duke reduktuar barrën

---

financiare për sektorin publik dhe duke krijuar modele praktike dhe të replikueshme. Në këtë kuadër, institucionet përgjegjëse duhet të eksplorojnë burime të ndryshme financimi, përfshirë fondet publike ekzistuese, instrumentet e donatorëve dhe institucioneve financiare ndërkombëtare, si dhe partneritetet me sektorin privat.

---

**Objektivi Strategjik IV:  
Forcimi i bashkëpunimit rajonal  
dhe funksionimi i tregut**

## 4. Objektivi Strategjik IV: Forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe funksionimi i tregut

Forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe funksionimi efektiv i tregut të energjisë janë parakushte për rritjen e sigurisë së furnizimit, uljen e kostove për konsumatorët dhe integrimin gradual të Kosovës në tregun evropian të energjisë. Për një sistem energjetik të vogël dhe të ekspozuar ndaj variacioneve sezonale, bashkëpunimi rajonal dhe tregtia ndërkufitare përbëjnë instrumente kyçe për menaxhimin e balancës, integrimin e burimeve të ripërtëritshme dhe reduktimin e varësisë nga prodhimi jo-eficient vendor. Në këtë kontekst, funksionimi i tregut nuk është vetëm çështje teknike, por edhe institucionale dhe rregullative, e lidhur drejtpërdrejt me përmbushjen e obligimeve ndaj Komunitetit të Energjisë dhe përafrimin me *acquis* të Bashkimit Evropian.

Objektivi strategjik 4 për forcimin e bashkëpunimit dhe funksionimit të tregut ka indikator kyç integrimin e tregut energjetik të Kosovës në tregjet pan-evropiane të energjisë elektrike.

*Tabela 11. Indikatorët dhe caqet për forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe funksionimit të tregut.*

Nr.	Objektivat strategjike dhe specifike, treguesit dhe veprimet	Vlera bazë	Objektivi afatshkurtër 2025	Objektivi i vitit të fundit 2031
IV.	<b>OBJEKTIVI STRATEGJIK 4: FORCIMI I BASHKËPUNIMIT RAJONAL DHE FUNKSIONIMIT TË TREGUT</b>			
1	Integrimi i tregut me tregjet pan evropiane të energjisë elektrike	Jo në vend	Integrimi i tregut me Shqipërinë (2023)	Anëtarësimi në zonën e tregut pan-Evropiane Shqipërinë (2023)

Objektivat specifike për forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe funksionimin e tregut:

1. Forcimi i bashkëpunimit rajonal
2. Heqja e barrierave për funksionimin efektiv të tregut
3. Aftësimi në fushat e lidhura me energjinë dhe përfshirja e grave


Secili prej këtyre objektivave ka të caktuar veprimet e ndërmarra për përmbushjen e tyre. Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm është paraqitur përmbushja e secilit objektiv specifik, dhe poashtu mesatarja e përmbushjes së objektivit strategjik duke u bazuar në përmbushjen e objektivave specifike.

*Tabela 12. Përqindja totale e realizuar për objektivin strategjik për vitet 2022-2024.*

Nr.	Objektivi Specifik	% e realizimit
1	Forcimi i bashkëpunimit rajonal	66.66%
2	Heqja e barrierave për funksionimin efektiv të tregut	36.66%
3	Aftësimi në fushat e lidhura me energjinë dhe përfshirja e grave	100%
	<b>Përqindja e realizimit të objektivit strategjik</b>	<b>67.77%</b>

Këtu, edhe pse realizimi i objektivit “Aftësimi në fushat e lidhura me energjinë dhe përfshirja e grave” figuron 100%, ky rezultat është pasojë e faktit se për vitin 2024 ishte planifikuar vetëm një aktivitet dhe ai është përmbushur. Megjithatë, një qasje e tillë nuk ofron bazë të mjaftueshme për të vlerësuar realisht progresin në këtë fushë, pasi vetë dimensionin e përfshirjes gjinore dhe ngritjes së kapaciteteve kërkon objektiva më të shumëfishtë, të vazhdueshëm dhe të matshëm. Kufizimi i planifikimit në një aktivitet të vetëm krijon përshtypjen e plotësimit formal, por jo të avancimit substancial, duke nxjerrë në pah nevojën për rishikim më rigoroz të objektivave në këtë drejtim.

*Grafiku 5. Realizimi i objektivave specifike për forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe funksionimit të tregut.*



Tek objektivi strategjik për forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe funksionimin e tregut, ka ngecje të përmbushjes së veprimeve pikërisht në këta dy objektiva specifike, por veprimet për aftësimin në fushat e lidhura me energjinë dhe përfshirja e grave kanë rezultuar me përmbushje të plotë. Poashtu në tabelën e mëposhtme është paraqitur niveli i përmbushjes së veprimeve, përfshirë ato të përfunduara tërësisht dhe ato që janë përfunduar mbi 50% për vitin 2024:

**Tabela 13.** Niveli i përmbushjes së veprimeve të objektivave specifike për vitin 2024.

Nr.	Objektivi Specifik	Veprime të pazbatuara deri në 2024	Veprimet e realizuara nën 50% deri në 2024	Veprimet e realizuara mbi 50% deri në 2024	Veprime të realizuara 100% deri në 2024	Veprime të planifikuara pas vitit 2024	Gjithsej veprimet 2022-2025
1	Forcimi i bashkëpunimit rajonal	1	0	0	2	0	3
2	Heqja e barrierave për funksionimin efektiv të tregut	3	0	3	0	1	7
3	Aftësimi në fushat e lidhura me energjinë dhe përfshirja e grave	2	0	0	1	2	3
	<b>Gjithsej veprimet e objektivit strategjik IV</b>	4	0	3	3	3	13

#### 4.1 Komentim mbi përmbushjen e objektivave specifike

Sipas të dhënave të paraqitura në Tabelën 12 dhe 13, Objektivi Strategjik IV shënon një nivel mesatar të realizimit prej **67.77%** deri në vitin 2024. Megjithatë, një lexim analitik i këtyre përqindjeve tregon se progresi i raportuar reflekton kryesisht përmbushje procedurale të veprimeve të planifikuara, ndërsa avancimi substancial drejt një tregu funksional dhe të integruar rajonalisht mbetet i kufizuar. Kjo diferencë ndërmjet përmbushjes formale dhe funksionimit real të tregut është karakteristike për fazat tranzitore të reformës së tregut të energjisë në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe kërkon vlerësim përtej vetë përqindjeve.

Objektivi specifik për **forcimin e bashkëpunimit rajonal**, me nivel realizimi prej **66.66%**, tregon se Kosova ka ndërmarrë hapa drejt integritimit rajonal, por ende mbetet në një fazë përgatitore. Në krahasim me praktikat e vendeve të rajonit që kanë avancuar drejt funksionimit të tregut ditore dhe bashkimit të tregjeve (market coupling), progresi i Kosovës mbështetet më shumë në koordinim institucional sesa në integrim funksional të tregut. Mungesa e fillimit të studimit të fizibilitetit për integrimin në tregun rajonal dhe pan-evropian përbën një boshllëk kritik, duke pasur parasysh se integrimi në

tregjet evropiane deri në vitin 2031 është një objektiv strategjik i përcaktuar në Strategjinë e Energjisë. Pa një bazë analitike të tillë, veprimet aktuale mbeten fragmentare dhe nuk krijojnë një rrugë të qartë drejt integritit të plotë.

Objektivi specifik për heqjen e barrierave për funksionimin efektiv të tregut, i cili shënon vetëm 36.66% realizim, përfaqëson pikën më të dobët të këtij objektivit strategjik. Ky nivel i ulët është tregues i drejtpërdrejtë i mungesës së reformës ligjore dhe rregullative, veçanërisht vonesave në miratimin e Ligjit për Energjinë, Ligjit për Energjinë Elektrike dhe Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Në mungesë të këtyre bazave ligjore, tregu mbetet i kufizuar në funksionim administrativ dhe nuk arrin të sigurojë konkurrencë reale, transparencë të çmimeve dhe likuiditet, elemente këto që janë standard në tregjet e liberalizuara të energjisë në rajon dhe në Bashkimin Evropian.

Ndërkohë, objektivi specifik për aftësimin në fushat e lidhura me energjinë dhe përfshirjen e grave figuron me 100% realizim, por ky rezultat duhet analizuar në raport me përmbajtjen dhe shtrirjen e veprimeve të planifikuara. Duke qenë se për vitin 2024 ishte paraparë vetëm një aktivitet i vetëm, realizimi i plotë i tij nuk përbën domosdoshmërisht avancim substancial në këtë fushë. Në krahasim me qasjet rajonale dhe evropiane, ku ngritja e kapaciteteve dhe përfshirja gjinore trajtohen përmes programeve afatgjata dhe të shumëfishta, ky rezultat reflekton më tepër një përmbushje formale sesa një ndryshim strukturor.

Në tërësi, analiza e objektivave specifike tregon se, pavarësisht një niveli mesatar të realizimit prej **67.77%**, Objektivi Strategjik IV mbetet i kufizuar në aspektin e ndikimit real në funksionimin e tregut të energjisë. Progresi aktual nuk përkthehet ende në një treg konkurrues dhe të integruar rajonalisht, por reflekton një fazë tranzitore ku reformat ligjore, institucionale dhe analitike nuk kanë ecur në të njëjtin ritëm me përmbushjen procedurale të veprimeve të planifikuara.

## 4.2. Përmbushja e veprimeve të objektivave specifike

### 4.2.1. Forcimi i bashkëpunimit rajonal

Indikator sipas PZSEK: Kapaciteti i ofruar ndërkufitar/Kapaciteti nominal ndërkombëtar:

- Eksporti 22-24% importi 24-26% (2021),
- Secili drejtim minimum 28-30% (2025),
- Secili drejtim 70% (2031).

Në tabelat e mëposhtme janë listuar veprimet për arritjen e objektivit specifik:

4.1.1. Veprimi: Bashkimi me tregun një ditë- para me Shqipërinë përmes bursës së energjisë ALPEX		
Institucioni	Financimi	Afati
ALPEX, KOSTT, ZRRE, ME	ALPEX	2023
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Më 10 shkurt 2022, ALPEX nënshkroi marrëveshje me Ofruesin e Shërbimit të përbërë nga Hellenic Exchanges - Athens Stock Exchange (ATHEX), Hellenic Energy Exchange S.A. (HEEx S.A.) dhe EnEx Clearing House S.A. (EnExClear S.A.), për krijimin e një platforme për tregun "një ditë përpara" dhe "brenda ditës". Pas aprovimit të dokumenteve rregullative nga ERE dhe ZRrE më 27 dhjetor 2022, dhe transferimit të kompetencave nga KOSTT tek ALPEX më 16 dhjetor 2022, ALPEX filloi operimin e bursës me mbështetje nga USAID, përfshirë trajnime për anëtarët e ardhshëm të tregut mbi funksionimin e platformës së tregtimit.	Pas funksionalizimit të Bursës së Energjisë në Shqipëri në prill 2023, ALPEX ka udhëhequr operacionalizimin e bursës edhe për zonën tregtare të Kosovës dhe bashkimin e tregut me Shqipërinë. Më 21.06.2023, ALPEX aplikoi në ZRrE për t'u nominuar si Operator i Emëruar i Tregut (NEMO), dhe më 17.07.2023, ZRrE dhe ERE e emëruan ALPEX-in si NEMO për Kosovë dhe Shqipëri. ALPEX organizoi trajnime me bankat për proceset e klerimit dhe shlyerjes, duke arritur marrëveshje me ProCredit Bank si banka e shlyerjes për Kosovën. Deri më tani, ALPEX ka anëtarësuar kompani publike dhe private si KOSTT, KEK dhe Iber Lepenc, ndërsa disa si KESCO, Future Energy Trading dhe Enerco janë në fazën përfundimtare të anëtarësimit. Më 31 janar 2024, ALPEX filloi operimin në Kosovë dhe u realizua bashkimi i tregut Kosovë-Shqipëri.	Më 31.01.2024, "ALPEX" ShA ka nisur operimin në zonën tregtare të Kosovës, dhe po atë ditë ka filluar edhe bashkimi i tregut Kosovë-Shqipëri (Market Coupling).
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
80%	90%	100%
Sfidat dhe Rekomandimet		
N/A		

4.1.2. Veprimi: Bashkimi me tregun një brenda-ditës me Shqipërinë përmes bursës së energjisë ALPEX		
Institucioni	Financimi	Afati
ALPEX, KOSTT, ZRRE, ME	ALPEX	2024
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	ZRrE ka miratuar Rregullat dhe Procedurat e ALPEX-it për Tregtim dhe Shlyerje. Planifikohet që tregu brenda-ditës të funksionalizohet gjatë tremujorit të parë ose të dytë të vitit 2024.	ZRrE-ja ka hartuar dhe miratuar Rregullat e ALPEX-it, Procedurat për Tregtim dhe Shlyerje, Vendimet Teknike dhe Tarifat përkatëse. Parashikohet që tregu brenda-ditës të bëhet funksional gjatë tremujorit të tretë ose të katërt të vitit 2024.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	60%	100%
Sfidat dhe Rekomandimet		
N/A		

4.1.3. Veprimi: Studimi i fizibilitetit mbi bashkimin e tregut rajonal/evropian (SDAC, SIDC)		
Institucioni	Financimi	Afati
KOSTT, ZRRE, ME	Donatorët, Buxheti i Kosovës	2024
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Nuk ka progres	Në nëntor 2023, në Athinë, është firmosur një memorandum bashkëpunimi për bashkimin e tregjeve, ndërmjet bursave, operatorëve të sistemeve të transmetimit (TSO) dhe rregullatorëve të Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë dhe Greqisë.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	0%	0%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment nga institucionet përkatëse.		

## 4.2.2. Heqja e barrierave për funksionimin efektiv të tregut

Indikatorët sipas PZSEK:

- Statusi i tërheqjes së MFSH-së:
  - o MFSH-ja ekziston (2021),
  - o Fillon heqja e MFSH (2025),
  - o MFSH nuk ekziston (2031).
- Numri i ofertave të disponueshme për konsumatorët jo-shtëpiak:
  - o 1 (2021),
  - o 6 (2025),
  - o Më shumë se 6 (2031).

Në tabelat e mëposhtme janë listuar veprimet për arritjen e objektivit specifik:

4.2.1. Veprimi: Hartimi dhe Miratimi i Ligjit për Energjinë		
Institucioni	Financimi	Afati
ME, ZRRE, KOSTT, KEK	Buxheti i Kosovës	2023
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Më 22 dhjetor 2023, drafti i projektligjit për Energjinë është shpërndarë te palët e interesit për shqyrtim fillestar, me një afat 15-ditor të punës, sipas kërkesave ligjore, i cili përfundon më 17 janar 2024.	Projektligji për energjinë ka përfunduar fazat e diskutimit paraprak dhe publik, dhe është përcjellë për komentim në SKE. Të gjitha komentet e marra nga këto diskutime, përfshirë ato të SKE-së, janë shqyrtuar dhe adresuar. Është siguruar opinioni mbi ndikimin financiar nga MFPT dhe është marrë vlerësimi për përputhshmërinë me legjislacionin e BE-së nga DDB/ZKM. Projektligji tani është i gatshëm për t'u dërguar në Qeverinë e Republikës së Kosovës për miratim.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	50%	85%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Hartimi i këtyre projektligjeve bëhet në kuadër të procesit të transpozimit të direktivave të BE-së për energjinë e pastër. Një ndër arsytet pse përfundimi i tyre nuk është realizuar sipas planit është prania e shumë elementeve të reja që lidhen me tregun e energjisë elektrike, të cilat kërkojnë trajtim më të kujdesshëm dhe konsultime të vazhdueshme me palët e interesit.		

4.2.2. Veprimi: Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore bazuar në Ligjin për Energjinë		
Institucioni	Financimi	Afati
ME, ZRRE, KOSTT	Buxheti i Kosovës	2024
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Nuk ka progres	Hartimi i akteve nënligjore bëhet pas aprovimit të Ligjit për Energjinë
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	0%	0%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment nga institucionet përkatëse.		

4.2.3. Veprimi: Hartimi dhe Miratimi i Ligjit për Energjinë Elektrike		
Institucioni	Financimi	Afati
ME, ZRRE, KOSTT	Buxheti i Kosovës	2023
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Janë mbajtur takime pune të grupit punues ndërinstitucional dhe me ekspertët e angazhuar nga Tetra Tech. Është përgatitur nje draft i konsoliduar I Ligjit për Energjinë Elektrike.	Projektligji për Energjinë Elektrike ka kaluar diskutimin paraprak dhe publik, është dërguar për komentim në SKE, dhe janë adresuar të gjitha komentet, përfshirë ato nga SKE. Është marrë opinioni për vlerësimin e ndikimit financiar nga MFPT dhe përputhshmëria me legjislacionin e BE-së nga DDB/ZKM. Projektligji është tani i gatshëm për t'u dërguar në Qeverinë e Kosovës për miratim.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	50%	85%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Hartimi i këtyre projektligjeve është pjesë e procesit të transpozimit të direktivave të BE-së për një sektor të energjisë i cili është miqësor me ambientin. Një nga sfidat kryesore për mos arritjen e përfundimit sipas afateve është prania e shumë elementeve të reja që lidhen me tregun e energjisë elektrike, për të cilat është nevojta të bëhen konsultime të vazhdueshme dhe kujdes i shtuar.		

4.2.4. Veprimi: Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore bazuar në Ligjin për Energjinë Elektrike		
Institucioni	Financimi	Afati
ME, ZRRE, KOSTT, KEK	Buxheti i Kosovës	2024
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Nuk ka progres	Hartimi i akteve nënligjore bëhet pas aprovimit të Ligjit për Energjinë Elektrike.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	0%	0%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment nga institucionet përkatëse		

4.2.5. Veprimi: Hartimi dhe Miratimi i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë		
Institucioni	Financimi	Afati
ME, ZRRE	Buxheti i Kosovës	2023
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Takime pune janë mbajtur me grupin punues ndërinstitucional dhe ekspertët e angazhuar nga Tetra Tech. Një draft i konsoliduar është përgatitur.	Drafti i projektligjit është hartuar nga Grupi Punues ndërinstitucional me ndihmën e konsulentëve dhe tani është në pritje për t'u dërguar për diskutim paraprak.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	50%	50%
Sfidat dhe Rekomandimet		
<p>Përgatitja e projektligjeve është pjesë e procesit të transpozimit të direktivave të BE-së për energjinë e pastër. Një nga sfidat kryesore për mos arritjen e përfundimit sipas afateve të planifikuara është se ka shumë elemente të reja që lidhen me tregun e energjisë elektrike, të cilat kërkojnë vëmendje të shtuar dhe konsultime të vazhdueshme me palët. Gjithashtu, një nga arsyet e vonësës është edhe trajtimi i ZRRE-së në kuadër të programit për optimizimin e agjencive.</p>		

**4.2.6. Veprimi: Hartimi dhe Miratimi i akteve nënligjore bazuar në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë**

Institucioni	Financimi	Afati
ME, ZRRE	Buxheti i Kosovës	2024
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Nuk ka progres	Hartimi i akteve nënligjore bëhet pas aprovimit të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	0%	0%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment nga institucionet përkatëse		

**4.2.7. Veprimi: Fillimi i studimeve mbi barrierat e tregut konkurrues të energjisë elektrike dhe për metodën më të përshtatshme të heqjes graduale të MFSH**

Institucioni	Financimi	Afati
ME, ZRRE	Buxheti i Kosovës, Donatorët	2025
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Nuk ka progres	Nuk ka filluar ende.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
N/A	N/A	N/A
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment nga institucionet përkatëse		

### 4.2.3. Aftësimi në fushat e lidhura me energjinë dhe përfshirja e grave

Indikatorët sipas PZSEK:

- Numri i të diplomuarve të ri në vit që marrin diplomë akademike ose kualifikim profesional në programe të reja në fushën e energjisë dhe fushat e ndërlidhura:
  - o J/A (2021),
  - o Të përcaktohet (2025),
  - o Të përcaktohet (2031).
- Përqindja e grave të punësuar në sektorin e energjisë:
  - o 9% (2021),
  - o 11% (2025),
  - o 25% (2031).

Në tabelat e mëposhtme janë listuar veprimet për arritjen e objektivit specifik:

4.3.1. Veprimi: Zhvillimi i programeve të reja të trajnimit teknik		
Institucioni	Financimi	Afati
MCAK	Donatorët	2024-2025
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Nuk ka progres	Realizimi i këtij projekti do të filloj në vitin 2025.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
N/A	N/A	0%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment nga institucioni përkatës.		

4.3.2. Veprimi: Përgatitja e infrastrukturës gjithëpërfshirëse gjinore dhe planifikimi i politikave		
Institucioni	Financimi	Afati
MCAK	Donatorët	2024-2025
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Nuk ka progres	Realizimi i këtij projekti do të filloj në vitin 2025.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
N/A	N/A	0%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment nga institucioni përkatës		

4.3.3. Veprimi: Hartimi i standardeve dhe kurrikulave të reja profesionale sipas kërkesave të tregut të punës		
Institucioni	Financimi	Afati
MASHT	Buxheti i Kosovës	2024
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Nuk ka progres	Janë zhvilluar katër standarde të reja profesionale në fushën e energjisë, të bazuara në kërkesat e tregut të punës: 1. Teknik i energjisë fotovoltaike, 2. Teknik i energjisë efikase në ndërtim, 3. Teknik i energjisë eolike, dhe 4. Teknik i energjisë nga biomasa. Këto standarde janë dërguar për validim në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve, ndërkohë që janë përgatitur gjithashtu kurrikulat dhe materialet mësimore përkatëse.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
N/A	N/A	100%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Këto kurrikula pritet të zbatohen përmes Arsimit Dual, posa të validohen standardet nga AKK.		

### 4.3. Sfidat dhe rekomandimet e përgjithshme

#### Sfidat e përgjithshme në realizimin e përmbushjes së objektivit strategjik 4 dhe objektivave specifike:

Indikatorët sipas PZSEK:

- Vonesat dhe mosrealizimi i miratimeve të Ligjeve për Energjinë, Energjinë elektrike dhe Rregullatorin e Energjisë kanë sjellë pamundësinë e draftimit dhe miratimit të akteve nënligjore që derivojnë nga këto ligje. Kjo ka shkaktuar probleme zingjirore në zhvillimin e një tregu të mirëfillt të energjisë elektrike. Dy nga këto ligje pritet të aprovohen nga QRK, kështu që institucionet përgjegjëse duhet të prioritojnë këto procedura në mënyrë që të vazhdohet me miratimin e këtyre ligjeve dhe hartimin e akteve nënligjore.
- Vonesat me miratimin e ligjeve kanë rezultuar edhe në mos harmonizimin me rregullat e BE-së për tregun e energjisë.
- Kosova ende nuk ka arritur të bëhet anëtare e plotë në platformat kyçe të tregut rajonal të energjisë.

#### Rekomandimet për realizimin e përmbushjes së objektivave strategjike dhe specifike të Strategjisë së Energjisë:

- Prioritizimi i QRK për aprovimin dhe miratimin e ligjeve relevante me energji, me qëllim harmonizimin e legjislacionit me direktivat Evropiane për sektorin e energjisë.
- Hartimi dhe zbatimi i një studimi të fizibilitetit për integrimin e tregut të Kosovës në tregun rajonal dhe pan-evropian të energjisë, i cili duhet të vlerësojë përfitimet ekonomike, ndikimin në çmime, kapacitetet institucionale dhe implikimet rregullative. Ky studim duhet të shërbejë si bazë për vendimmarrje të informuar dhe për një qasje graduale drejt market coupling.
- Finalizimi i projektit SCADA dhe aktivizimi i plotë i kontrollit digjital të rrjetit të transmetimit, si parakusht për monitorim në kohë reale, rritje të sigurisë së sistemit dhe funksionim më efikas të tregut të energjisë elektrike.
- Forcimi i kapaciteteve institucionale për funksionimin e tregut të lirë të energjisë, përfshirë ngritjen e kapaciteteve rregullative dhe mbikëqyrëse të ZRRE-së, si dhe kapaciteteve operacionale dhe teknike të KOSTT-it për operimin e tregut, balancimin e sistemit dhe menaxhimin e flukseve ndërkufitare të energjisë.

---

**Objektivi Strategjik V:  
Mbrojtja dhe fuqizimi i konsumatorëve**

## 5. Objektiv Strategjik V: Mbrojtja dhe fuqizimi i konsumatorëve

Objektivi strategjik 5 për mbrojtjen dhe fuqizimin e konsumatorëve mbështetet në skemat sociale për konsumatorët në nevojë dhe programet që mbështesin projektet e komuniteteve të energjisë në efikasitet dhe vetkonsum.

**Tabela 14.** Indikatorët dhe caqet për mbrojtjen dhe fuqizimin e konsumatorëve

Nr.	Objektivat strategjike dhe specifike, treguesit dhe veprimet	Vlera bazë	Objektivi afatshkurtër 2025	Objektivi i vitit të fundit 2031
<b>V.</b>	<b>OBJEKTIVI STRATEGJIK 5: MBROJTJA DHE FUQIZIMI I KONSUMATORËVE</b>			
1	Numri i skemave të reja dedikuara konsumatorëve në nevojë	J/A	2	4
2	Numri i programeve që Mbështesin projektet e komuniteteve të energjisë në efikasitet dhe vetë konsum	1	>2	>5

Objektivat specifike për mbrojtjen dhe fuqizimin e konsumatorëve:


1. Mbrojtja e konsumatorëve në nevojë
2. Fuqizimi i konsumatorëve
3. Ruajtja e shëndetit të njeriut dhe mjedisit

Secili prej këtyre objektivave ka të caktuar veprimet e ndërmarra për përmbushjen e tyre. Në tabelën dhe grafën e mëposhtëm është paraqitur përmbushja e secilit objektivi specifik, dhe poashtu mesatarja e përmbushjes së objektivit strategjik duke u bazuar në përmbushjen e objektivave specifike.

**Tabela 15.** Përqindja totale e realizuar për objektivin strategjik për vitet 2022-2024.

Objektivi Specifik	% e realizimit
Mbrojtja e konsumatorëve në nevojë	<b>98.33%</b>
Fuqizimi i konsumatorëve	<b>75%</b>
Ruajtja e shëndetit të njeriut dhe mjedisit	<b>75%</b>
<b>Përqindja e realizimit të objektivit strategjik</b>	<b>82.77%</b>

**Grafiku 6. Realizimi i objektivave specifike për mbrojtjen dhe fuqizimin e konsumatorëve**



Nga përqindja e realizimit shohim se veprimet për mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë kanë rezultuar mire, kurse veprimet për fuqizimin e konsumatorëve dhe ruajtjes së shëndetit të njeriut dhe mjedisit kanë rezultuar më dobët. Më poshtë është shënuar një komentim mbi vlerën e veprimeve të përfshira për këtë objektiv specifik dhe mangësitë e tyre.

Poashtu në tabelën e mëposhtme është paraqitur niveli i përmbushjes së veprimeve, përfshirë ato të përfunduara tërësisht dhe ato që janë përfunduar mbi 50% për vitin 2024:

**Tabela 16. Niveli i përmbushjes së veprimeve të objektivave specifike për vitin 2024.**

Nr.	Objektivi Specifik	Veprime të pazbatuara deri në 2024	Veprimet e realizuara nën 50% deri në 2024	Veprimet e realizuara mbi 50% deri në 2024	Veprime të realizuara 100% deri në 2024	Veprime të planifikuara pas vitit 2024	Gjithsej veprimet 2022-2025
1	Mbrojtja e konsumatorëve në nevojë	0	0	1	4	2	7
2	Fuqizimi i konsumatorëve	0	0	1	1	0	2
3	Ruajtja e shëndetit të njeriut dhe mjedisit	0	0	1	0	0	1
	<b>Gjithsej veprimet e objektivit strategjik V</b>	0	0	3	5	5	10

## 5.1. Komentim mbi përmbushjen e objektivave specifike

Sipas Tabelës 15, Objektiv i Strategjik V shënon nivel të lartë të realizimit në vitet 2022–2024 (82.77%), me realizim shumë të lartë të “Mbrojtja e konsumatorëve në nevojë” (98.33%) dhe realizim më të ulët të “Fuqizimi i konsumatorëve” dhe “Ruajtja e shëndetit të njeriut dhe mjedisit” (nga 75% secila). Këto përqindje sugjerojnë se një pjesë e madhe e veprimeve të planifikuara janë zbatuar ose kanë avancuar (Tabela 16 tregon se në total, deri në 2024 ka 5 veprime të përfunduara 100% dhe 3 veprime mbi 50%, pa veprime të pazbatuara). Megjithatë, interpretimi i këtij progresi duhet të jetë më kritik: realizimi i lartë reflekton kryesisht vazhdimësinë e skemave ekzistuese të subvencionimit dhe jo domosdoshmërisht ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm, të targetuar mirë dhe të bazuar në të dhëna për mbrojtjen e konsumatorëve në rrezik.

Në këtë kontekst, vlen të theksohet se draft-PKEK DHE PZSEK e identifikon varfërinë energjetike si fushë ku Kosova ende ka boshllëqe strukturore: mungon definicioni ligjor i varfërisë energjetike dhe mungojnë të dhënat e nevojshme për të kuptuar shtrirjen e problemit, ndërsa skema ekzistuese jep mbështetje direkte vetëm për dy kategori relativisht të kufizuara të qytetarëve (përfitues të asistencës sociale dhe të benefiteve të luftës), duke lënë të pambrojtur një pjesë të konsiderueshme të familjeve që mund të jenë në rrezik. Mungesa e këtij definicioni kufizon edhe aftësinë e Strategjisë së Energjisë për të kaluar nga masa reaktive drejt politikave strukturore të mbrojtjes sociale në sektorin e energjisë.

Prandaj, edhe pse “Mbrojtja e konsumatorëve në nevojë” rezulton me 98.33%, ky rezultat duhet të lexohet si performancë e mirë administrative e një skeme ekzistuese, por jo si garanci se mbrojtja është e drejtë, e mjaftueshme dhe e përshtatur me rritjet e mundshme të çmimeve në procesin e hapjes së tregut.

Sa i përket “Fuqizimit të konsumatorëve”, të dhënat e veprimeve (2 veprime gjithsej për 2022–2025; 1 mbi 50% dhe 1 i përfunduar 100%) tregojnë progres, por raporti duhet të evidentojë se fuqizimi nuk kufizohet vetëm te nxitja e prosumatorëve; ai kërkon edhe informim, mekanizma ankese/mbrojtjeje, transparencë në të dhëna, dhe lehtësim të qasjes së qytetarëve në skema e investime. Në linjë me këtë, PKEK propozon një masë të dedikuar për skemë mbështetëse “consumption-independent” për konsumatorët vulnerabël, e bazuar në të dhëna të përmirësuar dhe në një definicion ligjor të konsumatorit vulnerabël, si parakusht për targetim më të mirë dhe mbulim më të gjerë.

Në fund, “Ruajtja e shëndetit të njeriut dhe mjedisit” duhet të trajtohet jo vetëm si çështje teknike e operimit të termocentraleve, por si pjesë e kontratës sociale të sektorit të energjisë. Qytetarët bartin kosto shëndetësore dhe ekonomike nga ndotja, prandaj masat e monitorimit, transparencës dhe përputhshmërisë me standardet mjedisore duhet të jenë më të matshme dhe të raportueshme publikisht, jo vetëm të deklaruara.

## 5.2. Përbushja e veprimeve të objektivave specifike

### 5.2.1. Mbrojtja e konsumatorëve në nevojë

Indikator sipas PZSEK: Skema për mbështetjen e çmimeve për konsumatorët në nevojë:

- Skema mbështetëse ekzistuese (e pashënjestëruar si duhet) (2021) ,
- Themelimi i programit të ri për konsumatorët në nevojë (2025),
- Skemë e bazuar në testin e varfërisë, e lidhur me skemën e reformuar të asistencës sociale (2031).

Në tabelat e mëposhtme janë listuar veprimet për arritjen e objektivit specifik:

5.1.1. Veprimi: Mbështetja e konsumatorëve në nevojë përmes skemave ekzistuese të mbështetjes		
Institucioni	Financimi	Afati
MFPT	Buxheti i Kosovës	Vjetore
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Përmes marrëveshjes nr. 2945 të nënshkruar mes MFPT dhe KESCO, gjatë vitit 2022 janë subvencionuar 35,495 familje që përfitojnë nga skemat e ndihmës, si më poshtë: 21,897 familje nga Skema e Ndihmës Sociale (SNS), 9,984 familje nga Skema e Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës (FDIL), 1,260 familje nga Skema për Personat e Verbër (SPV), dhe 2,354 familje nga Skema për Personat Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë (SPPT).	Praktika e viteve të kaluara nuk është zbatuar, pasi që në shtator 2023 është miratuar Programi për mbështetje të konsumatorëve të cenueshëm nga Qeveria e Kosovës dhe është hapur periudha e aplikimit për subvencione për të gjitha kategoritë.	Kjo skemë është zëvendësuar me Pilot programin për Konsumatorë të Cenueshëm që është shpjeguar në V.1.4.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
98%	0%	N/A
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment nga institucioni përkatës		

5.1.2. Veprimi: Krijimi i një skeme të re mbështetëse për konsumatorët në nevojë		
Institucioni	Financimi	Afati
MFPT	Buxheti i Kosovës	Vjetore
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Nuk ka progres	Nuk do të krijohet një "skemë" e re. Qeveria ka miratuar Programin për Mbrojtjen e Konsumatorëve të Cenueshëm të Energjisë Elektrike për vitin 2023/2024. Sipas këtij programi, gjatë vitit 2023/2024 janë subvencionuar gjithsej 61,247 familje, për të cilat janë shpenzuar 15,025,732.73 euro.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
N/A	N/A	100%
Sfidat dhe Rekomandimet		
N/A		

5.1.3. Veprimi: Hartimi i një programi pesë vjeçar për mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë		
Institucioni	Financimi	Afati
MFPT	Donatorët	2023-2024
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Programi është hartuar nga Grupi Punues i MFPT-së, ndërsa Qeveria e Kosovës e ka miratuar atë në shtator të vitit 2023 për pagesat e vitit 2023, me qëllim mbështetjen e konsumatorëve të cenueshëm.	Programi për Mbështetje të Konsumatorëve të Cenueshëm të Energjisë Elektrike për vitin 2024/2025 është finalizuar dhe miratuar. Ky program është duke u zbatuar, dhe pritet që deri në muajin prill të realizohet 100% i tij.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
N/A	80%	100%
Sfidat dhe Rekomandimet		
N/A		

5.1.4. Veprimi: Hartimi dhe miratimi i programit një (1) vjeçar për zbatimin e masave për mbështetjen e konsumatorëve në nevojë		
Institucioni	Financimi	Afati
MFPT	EU – Fondet IPA	2023
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Programi është hartuar nga Grupi Punues i MFPT-së, ndërsa Programi për Mbështetje të Konsumatorëve të Cenueshëm është miratuar nga Qeveria e Kosovës në shtator 2023.	Programi për periudhën 2023-2024 ka filluar të implementohet në janar 2024, dhe deri tani kanë përfituar 61,069 familje. Subvencioni është disbursuar në gjashtë transhe gjatë periudhës janar-korrik 2024, si një formë pagesë direkte për një pjesë të faturës së energjisë.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	80%	90%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Sfida kryesore ka qenë cilësia e të dhënave nga aplikuesit gjatë aplikimit, përfshirë mungesën e numrit personal për anëtarët e familjes, duplikimet e anëtarëve të familjes dhe mungesën e numrave të njëjësorëve elektrikë. Për të zgjidhur këtë, u hap një rund i dytë aplikimesh, ku u lidhën direkt të dhënat e aplikuesve me ato të ARC për familjarët dhe për njëjësorët elektrikë.		

5.1.5. Veprimi: Mbështetja përmes subvencionimit të një pjese të faturës për përfituesit e skemave sociale dhe pensionale si dhe familjet që përzgjidhen përmes një skeme formale të testuar		
Institucioni	Financimi	Afati
MFPT	EU – Fondet IPA	2023
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Procesi i aplikimeve për subvencionimin e energjisë, në bazë të programit të miratuar nga Qeveria e Kosovës në shtator, ka nisur në dy faza: Faza I dhe Faza II në janar 2024. Pagesa e kështit të parë për aplikimet e shtatorit 2023 është realizuar nga Departamenti i Skemave Sociale, ndërsa mbeten edhe 5 këste për të përfunduar pagesën e plotë për vitin 2023.	Është përfshirë në kuader të Veprimit 1.4
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	20%	N/A
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment nga institucioni përkatës		

5.1.6. Veprimi: Mbështetje përmes subvencionimit të metodave alternative (dru dhe pelet) për qëllime ngrohjeje për grupet e cënueshme		
Institucioni	Financimi	Afati
MFPT	EU – Fondet IPA	2023
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres.	Në bazë të vlerësimit të Komisionit Zbatues. 41,204 familje në shumën 1,682,799.29 për kestin e parë të pageses. Kanë mbetur dhe 5 pesë keste të tjera për tu paguar.	Është finalizuar në vitin 2023 kanë përfituar rreth 20,000 familje në asistencë sociale subvencionim.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	33.65%	100%
Sfidat dhe Rekomandimet		
N/A		

5.1.7. Veprimi: Mbështetja e familjeve përmes subvencionimit të faturës së muajit aktual të energjisë elektrike bazuar në përqindjen e kursimeve të energjisë që kanë bërë në krahasim me të njëjtin muaj të një viti më parë		
Institucioni	Financimi	Afati
MFPT	EU – Fondet IPA	2023
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Në bazë të vlerësimit të Komisionit Zbatues. 41,204 familje në shumën 1,682,799.29 për kestin e parë të pageses. Kanë mbetur dhe 5 pesë keste të tjera për tu paguar.	Ka qenë aktive mes muajve tetor 2022-prill 2023 ku kanë përfituar rreth 300,000 familje.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
N/A	11.21%	100%
Sfidat dhe Rekomandimet		
N/A		

## 5.2.2. Fuqizimi i konsumatorëve

Indikatorët sipas PZSEK:

- Zbatimi i fushatave vetëdisuese dhe informuese për energjinë:
  - o 6 (2021),
  - o 9 çdo vit (2025),
  - o 9 çdo vit (2031).
- Diversiteti dhe krahasueshmëria e shërbimeve të ofruara për konsumatorët:
  - o Nuk ka oferta të disponueshme (2021),
  - o Lansimi i mjetit për krahasimin e çmimeve (2025),
  - o Oferta alternative të disponueshme për të gjithë konsumatorët (2031).

Në tabelat e mëposhtme janë listuar veprimet për arritjen e objektivit specifik:

5.2.1. Veprimi: Krijimi i legjislacionit për Mjetin e Krahasimit të Çmimeve, me udhëzime të detajuara mbi informacionin që do të jepet në Mjet		
Institucioni	Financimi	Afati
ZRRE	Donatorët	2023
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Rregulla me udhëzimet përkatëse është e draftuar pritet të funksionalizohet në vitin 2024	Ka përfunduar Procedura me udhëzimet e duhura.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	50%	100%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment		

5.2.2. Veprimi: Zhvillimi i Mjetit të Krahasimit të Çmimeve		
Institucioni	Financimi	Afati
ZRRE	ZRRE	2023
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Aplikacioni, i nevojshëm për përgatitjen e platformës për publikimin e të dhënave të krahasimit të çmimeve, pritet të përfundojë gjatë çerekut të parë të vitit 2024.	Aplikacioni duhet të azhurnohet për t'u përshtatur me sistemin operativ më të fundit të Windows dhe për të siguruar funksionimin e tij të plotë.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
0%	50%	50%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka koment		

### 5.2.3. Ruajtja e shëndetit të njeriut dhe mjedisit

Indikatori: Emetimet e pluhurit, Nox dhe SO<sub>2</sub> të termocentraleve të linjitet:

Vlera Bazë (2021)	Objektivi Afatshkurtër (2025)	Objektivi Afatgjatë (2031)
<p><b>TC Kosova B:</b> Pluhuri: mbi 300 mg/ Nm<sup>3</sup>, NOx: mbi 500 mg/ Nm<sup>3</sup>, SO<sub>2</sub>: mbi 600 mg/ Nm<sup>3</sup></p> <p><b>TC Kosova A:</b> Pluhuri: mbi 50 mg/ Nm<sup>3</sup>, NOx: mbi 600 mg/ Nm<sup>3</sup>, SO<sub>2</sub>: mbi 600 mg/ Nm<sup>3</sup></p>	<p><b>TC Kosova B2:</b> Pluhurit: 20 mg/ Nm<sup>3</sup>, NOx: 200 mg/ Nm<sup>3</sup>, SO<sub>2</sub>: 600 mg/ Nm<sup>3</sup></p> <p><b>TC Kosova B1:</b> Pluhuri: mbi 300 mg/ Nm<sup>3</sup>, NOx: mbi 500 mg/ Nm<sup>3</sup>, SO<sub>2</sub>: mbi 600 mg/ Nm<sup>3</sup></p> <p><b>TC Kosova A3:</b> Pluhuri: 20 mg/ Nm<sup>3</sup>, NOx: mbi 200 mg/ Nm<sup>3</sup>, SO<sub>2</sub>: mbi 200 mg/ Nm<sup>3</sup></p> <p><b>TC Kosova A4 &amp; A5:</b> Pluhuri: mbi 50 mg/ Nm<sup>3</sup>, NOx: mbi 600 mg/ Nm<sup>3</sup>, SO<sub>2</sub>: mbi 600 mg/ Nm<sup>3</sup></p>	<p><b>TC Kosova B:</b> Pluhuri: 20 mg/ Nm<sup>3</sup>, NOx: 200 mg/ Nm<sup>3</sup>, SO<sub>2</sub>: 200 mg/ Nm<sup>3</sup></p> <p><b>TC Kosova A:</b> Pluhuri: 20 mg/ Nm<sup>3</sup>, NOx: 200 mg/ Nm<sup>3</sup>, SO<sub>2</sub>: 200 mg/ Nm<sup>3</sup></p>

Në tabelën e mëposhtme janë listuar veprimet për arritjen e objektivit specifik:

5.3.1. Veprimi: Zhvillimi i Mjetit të Krahasimit të Çmimeve		
Institucioni	Financimi	Afati
MMPHI, Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK)	Buxheti i Kosovës	2025
Progresi 2022	Progresi 2023	Progresi 2024
Nuk ka progres	Në vitin 2023, në kuadër të projektit të mbështetur nga JICA, 5 zyrtarë të AMMK janë trajnuar për monitorimin dhe raportimin e emetimeve nga impiantet e mëdha me djegie. Të dhënat e emetimeve janë raportuar në Agjencinë e Mjedisit të Evropës si pjesë e obligimeve të Energy Community.	Në vitin 2024, në kuadër të projektit të mbështetur nga JICA, u organizuan 4 trajnime për zyrtarët e AMMK për monitorimin dhe raportimin e emetimeve nga impiantet e mëdha me djegie. Shtatë zyrtarë morën pjesë në një vizitë studimore në Japoni dhe në konferencën e CLRTAP në Bruksel. Të dhënat e emetimeve u raportuan në Agjencinë e Mjedisit të Evropës dhe përfshinë inventarin e emisioneve dhe raportet për gjendjen e ajrit për vitin 2023.
[%] në vitin 2022	[%] në vitin 2023	[%] në vitin 2024
N/A	80%	75%
Sfidat dhe Rekomandimet		
Nuk ka pasur sfida dhe mangësi gjatë zbatimit. Aktivitetet janë zbatuar sipas planifikimit.		

### 5.3. Sfidat dhe rekomandimet e përgjithshme

#### Sfidat e përgjithshme në realizimin e përmbushjes së objektivit strategjik 5 dhe objektivave specifike:

- Mungesa e interaktivitetit mes konsumatorëve dhe akterëve të sektorit të energjisë. Konsumatorët shpesh nuk kanë informacione të mjaftueshme mbi sektorin e energjisë dhe të drejtat e tyre.
- Vonesat në rehabilitimin e njësive gjeneruese nga linjiti TC A dhe TC B kanë shkaktuar që mos të ulen nivelet e ndotjes nga këto termocentrale pasi që ende operohet duke përdorë teknologji të vjetra dhe të amortizuara.
- Mungesa e definicionit ligjor dhe e të dhënave për varfërinë energjetike: siç theksohet edhe në PKEK, pa definim dhe pa të dhëna të strukturuar, mbrojtja mbetet e fragmentuar dhe e vështirë për t'u targetuar drejt, veçanërisht në kushtet e rritjeve të çmimeve dhe reformave të tregut.
- Targetim i ngushtë i skemave ekzistuese: Skema aktuale mbulon vetëm dy kategori (asistencë sociale dhe benefite të luftës), ndërsa me rritjen e vazhdueshme të cmimit të energjisë elektrike shumë familje rrezikojnë të mbesin jashtë mbrojtjes.

#### Rekomandimet për realizimin e përmbushjes së objektivit strategjik 5 dhe objektivave specifike:

- Hartimi i një plani për komunikim dhe edukim të konsumatorëve për sektorin e energjisë.
- Hartimi i definicionit ligjor të konsumatorit vulnerabël dhe varfërisë energjetike, si dhe ndërtimi i një baze të dhënash (regjistër dhe metodologji), si parakusht për targetim të drejtë, transparent dhe të bazuar në të dhëna reale mbi nevojat e familjeve në rrezik.
- Kalimi gradual nga subvencionimi “i ngushtë” drejt një programi më gjithëpërfshirës dhe të drejtë, që mbulon edhe familjet në rrezik që aktualisht nuk përfshihen në kategoritë ekzistuese të përfituesve, duke reflektuar më mirë realitetin socio-ekonomik dhe ekspozimin ndaj kostove të energjisë.
- Fuqizimi aktiv i konsumatorëve përmes qasjeve bottom-up, duke zhvilluar masa dhe projekte pilot në bashkëpunim me komunitat, sektorin privat, akademinë dhe shoqërinë civile. Këto masa mund të

përfshijnë qendra informimi për efikasitet të energjisë dhe burime të ripërtëritshme, këshillim praktik për aplikim në skema mbështetëse dhe orientim për vetë-konsum dhe komunitete të energjisë, me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në tranzicionin energjetik.

- Rritja e transparencës publike në lidhje me skemat mbështetëse, përmes raportimit periodik dhe të hapur mbi kriteret e përfitimit, shtrirjen e skemave dhe mekanizmat për përditësimin e listave të përfituesve, veçanërisht në kontekstin e ndryshimeve në çmimet e energjisë dhe reformave të tregut.
- Angazhimi i shoqërisë civile dhe OJQ-ve për të përfaqësuar konsumatorët e cënueshëm në konsultime publike.

---

## Kreu 3

Kreu III përfshin: Përfundime dhe rekomandime të ndara në: Kritike dhe të menjëhershme; Sistematike afatmesme; Ndërsektoriale dhe transformuese.

## 1. Përfundime dhe rekomandime

Përgjatë raportit është analizuar detajisht përmbushja e veprimeve të PZSEK për vitin 2022, 2023 dhe me fokus në vitin 2024. Këto veprime janë caktuar për arritjen e objektivave specifike dhe strategjike të Strategjisë së Energjisë së Republikës së Kosovës 2022-2031. Në vazhdim janë paraqitur të gjeturat kryesore të këtij raporti në formë të tabelës dhe në formë narrative, duke ofruar gjithashtu sfidat dhe rekomandimet për përmbushjen e objektivave të PZSEK dhe Strategjisë së Energjisë.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur niveli i përmbushjes së veprimeve, përfshirë:

- Veprimet e pazbatuara deri në vitin 2024;
- Veprimet e realizuara në nivel nën 50% deri në vitin 2024;
- Veprimet e realizuara në nivel mbi 50% deri në vitin 2024;
- Veprimet e realizuara 100% deri në vitin 2024;
- Përqindja e realizimit të veprimeve deri në vitin 2024.

**Tabela 17. Niveli i veprimeve të përfunduara deri në vitin 2024.**

Objektivi Specifik	Veprime të pazbatuara deri në 2024	Veprimet e realizuara nën 50% deri në 2024	Veprimet e realizuara mbi 50% deri në 2024	Veprime të realizuara 100% deri në 2024	Përqindja e realizimit të veprimeve deri në vitin 2024
<b>OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: PËRMIRËSIMI I BESUESHMËRISË SË SISTEMIT</b>					
Rritja e fleksibilitetit të sistemit	0	0	0	2	100%
Modernizimi i rrjeteve dhe reduktimi i humbjeve në rrjet	0	3	1	5	70.50%
Rehabilitimi i kapaciteteve ekzistuese të prodhimit të energjisë elektrike	2	1	0	0	2.66%
Garantimi i sigurisë kibernetike të sektorit të energjisë	0	0	0	1	100%
<b>OBJEKTIVI STRATEGJIK 2: DEKARBONIZIMI DHE PROMOVIMI I ENERGJISË SË RIPËRTËRITSHME</b>					
Zbatimi gradual i çmimit të karbonit	1	0	0	1	50%
Promovimi i energjisë së ripërtëritshme në konsumin e energjisë elektrike	1	3	1	5	52.20%
Promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të energjisë së ripërtëritshme për ngrohje	0	0	0	2	100%
<b>OBJEKTIVI STRATEGJIK 3: RITJIA E EFIÇIENCËS SË ENERGJISË</b>					
Përmirësimi i efiçencës së energjisë në ndërtesa	2	3	5	5	60.42%
Promovimi i kogjenerimit efikas dhe sistemeve efiçiente të ngrohjes qendrore	0	0	2	5	95%
<b>OBJEKTIVI STRATEGJIK 4: FORCIMI I BASHKËPUNIMIT RAJONAL DHE FUNKSIONIMIT TË TREGUT</b>					
Zbatimi gradual i çmimit të karbonit	1	0	0	2	66.66%
Heqja e barrierave për funksionimin efektiv të tregut	3	0	3	0	36.66%
Aftësimi në fushat e lidhura me energjinë dhe përfshirja e grave	0	0	0	1	100%
<b>OBJEKTIVI STRATEGJIK 5: MBROJTJA DHE FUQIZIMI I KONSUMATORËVE</b>					
Mbrojtja e konsumatorëve në nevojë	0	0	1	4	98.33%
Fuqizimi i konsumatorëve	0	0	1	1	75%
Ruajtja e shëndetit të njeriut dhe mjedisit	0	0	1	0	75%

## **Rekomandimet Kryesore:**

### **Prioritete kritike dhe të menjëhershme**

- Marrja e vendimeve të qarta politike për kapacitetet ekzistuese me qymyr, duke shmangur zgjidhje që zgjasin varësinë nga qymyri pa përmirësime reale mjedisore dhe duke garantuar sigurinë e furnizimit në afat të shkurtër.
- Eliminimi i barrierave administrative dhe pronësore që po bllokojnë ankandet e energjisë dhe projektet e burimeve të ripërtëritshme, përfshirë çështjet e tokave publike, procedurat e prokurimit dhe vonesat në ratifikimin e marrëveshjeve financiare.
- Përsheptimi i koordinimit ndër-institucional për ratifikim, prokurim dhe zbatim të projekteve energjetike, në mënyrë që planet dhe fondet e aprovuara të përkthehen në investime reale në terren.

### **Prioritete sistematike afatmesme**

- Finalizimi dhe zbatimi i Strategjisë Afatgjatë për Dekarbonizim, duke përfshirë aplikimin gradual të çmimit të karbonit si instrument orientues për investime dhe reformë strukturore të sektorit. Kjo masë duhet të përcjelllet me masa adekuate për informim të drejtë dhe ndërtim të kapaciteteve për kategoritë e prekura.
- Vendosja e efikasitetit të energjisë si prioritet real zbatimi, duke kaluar nga masa të shpërndara subvencionimi drejt programeve të strukturuar, të shkallëzueshme dhe të koordinuara, veçanërisht në ndërtesa publike, rezidenciale dhe sektorin e NMVM-ve.
- Përfundimi i investimeve në rrjetin e transmetimit dhe distribucionit brenda afateve të planifikuara, për të rritur besueshmërinë e furnizimit dhe kapacitetin për integrimin e burimeve të ripërtëritshme si gjenerim i shpërndarë.
- Miratimi në kohë i legjislacionit primar në sektorin e energjisë, si parakusht për nxjerrjen e akteve nënligjore dhe funksionalizimin e reformave të planifikuara.

### **Prioritete ndërsektoriale dhe transformuese**

- Vendosja e qytetarit në qendër të tranzicionit energjetik, përmes rritjes së transparencës, përfshirjes së konsumatorëve dhe mbrojtjes së grupeve të cenueshme nga ndikimet sociale të reformave të tregut.
- Zhvillimi i mëtejshëm i decentralizimit të sektorit të energjisë, duke

---

mbështetur formimin e komuniteteve të energjisë, vetë-konsumin dhe investimet e qëndrueshme në sektorin rezidencial dhe privat.

- Përfshirja aktive e shoqërisë civile në proceset e zhvillimit, monitorimit dhe vlerësimit të politikave energjetike, si mekanizëm për llogaridhënie publike dhe përmirësim të cilësisë së vendimmarrjes.

## Referencat

Ministria e Ekonomisë. Raporti i progresit për vitin 2022 & 2023 i PZSEK 2022–2025. Prishtinë: Ministria e Ekonomisë, 2023. Raporti i progresit për vitin 2022&2023 i PZSEK 2022-2025 nga Ministria e Ekonomisë;

Ministria e Ekonomisë. Raporti i progresit për vitin 2024 i PZSEK 2022–2025. Prishtinë: Ministria e Ekonomisë, 2024. Raporti i progresit për vitin 2024 i PZSEK 2022-2025 nga Ministria e Ekonomisë;

Ministria e Ekonomisë. (2023). Master Plani për Zhvillimin e Gazit në Republikën e Kosovës. Përgatitur me mbështetje të WBIF / IPF 9.

Qeveria e Republikës së Kosovës. Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës 2022–2031. Prishtinë: Qeveria e Kosovës, 2022. Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës 2022-2031;

Qeveria e Republikës së Kosovës. Plani i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës 2022–2025. Prishtinë: Qeveria e Kosovës, 2022. Plani i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës 2022-2025;

World Bank. (2019). Kosovo: Country Environmental Analysis – Air Pollution and Human Health. World Bank Group, Washington, DC.

ZRrE (Zyra e Rregullatorit për Energji). Raportet vjetore. Prishtinë: ZRrE - Raportet vjetore të ZRrE.

Balkan Green Foundation, Dhjetor, 2025



